


**ME EMRIN E ALL'LLAHUT**
**TË GJITHËMËSHIRSHMIT, MËSHIRËPLOTIT**

FONDACIONI I KUR'ANIT
SHQIPËRI

# DRITA E KUR'ANIT

**REVISTË SHKENCORE E HULUMTIMEVE
DHE E STUDIMEVE KUR'ANORE**

TIRANË, 2013

**DRITA E KUR'ANIT**

**Drejtor:** H. Vullnet MERJA

**REDAKSIA:**

Prof. dr. Hajri SHEHU ***(kryeredaktor)***

H. Jetmir ÇELA ***(sekretar i redaksisë)***

Prof. dr. Bedri BYLYKU ***(anëtar)***

Prof. dr. Feti MEHDIU ***(anëtar)***

H. Sulejman efendi REXHEPI ***(anëtar)***

H. Selim STAFA ***(anëtar)***

**Redaktore letrare:** Liseda RAMAJ

**Korrektura teknike:** Vjollca KARAJ

**Përkthyes nga gjuha angleze dhe në gjuhën angleze:** Mentor ÇADRI, Bledar SHEHU

**Përkthyes nga gjuha arabe dhe në gjuhën arabe:** Jetmir ÇELA, Vullnet MERJA

©: Fondacioni i Kur'anit

Del katër herë në vit

Viti VI, 2013, Nr. 2, (25)

Shtypur në Shqipëri, në shtypshkronjën "LILO"

**Adresa e redaksisë:**
Fondacioni i Kur'anit
Rruga "Hoxha Tahsin", Nr.168, Kutia Postare: 8272
Tel & Fax: 00355 4 2377311 Tirana – Albania
Website: www.fqurani.com   E_mail: f_quran114@yahoo.com

**ISSN 2309-3668**

**THE LIGHT OF THE QUR'AN**

QUARTERLY SCIENTIFIC JOURNAL OF QUR'ANIC RESEARCHES AND STUDIES

**Director:** Haji Vullnet MERJA

**Editorial Board:**

Prof. Dr. Hajri Shehu - **Editor-in-chief**

Haji Jetmir ÇELA - **Secretary**

Prof. Dr. Bedri BYLYKU - **Member**

Prof. Dr. Feti MEHDIU - **Member**

Haji Sulejman ef. REXHEPI - **Member**

Haji Selim STAFA - **Member**

**Literary editor:** Liseda RAMAJ

**Technical correction:** Vjollca KARAJ

**Summaries translators from english:** Mentor ÇADRI, Bledar SHEHU

**Summaries translators from arabic:** Jetmir ÇELA, Vullnet MERJA

©: Foundation of the Qur'an – Albania

No. 2, 2013 (25)

Printed in Albania by "LILO" Printing House

**ISSN 2309-3668**

**Address of the Editorial Board:**

Fondacioni i Kur'anit

Rruga "Hoxha Tahsin", Nr.168, Kutia Postare: 8272

Tel & Fax: 00355 4 2377311 Tirana – Albania

Website: www.fqurani.com E_mail: f_quran114@yahoo.com

# PASQYRA E LËNDËS

*HYTBJA E LAMTUMIRËS*......................................................**9**

**VULLNET MERJA**

*FEJA E VËRTETË TEK ALLAHU ËSHTË VETËM ISLAMI*....**19**

**SEJJID EBUL A'LA MAUDUDI**

*BESIMI NË LIBRAT E ALLAHUT*........................................**24**

*KARAKTERI I PROFETIT*.....................................................**30**

**ALI KAJA**

*ZGJERIMI I UNIVERSIT DHE SHPËRTHIMI I MADH*......**36**

**XHEMAL ABDEL NASER**

*YLLI QË SHPON ERRËSIRËN DHE VRIMAT E ZEZA*.....**44**

**MUSAVIJ LARI**

*BESIMI NË PAVDEKSHMËRINË*..........................................**52**

**ADULDAEM AL-KAHIIL**

*ARGUMENTE SHKENCORE NGA KUR'ANI*.....................**61**

**ADULDAEM AL-KAHIIL**

*NJERIU DHE PËRGJEGJËSIA NË KUR'AN*.........................**84**

*POZITA E PRINDËRVE NË KUR'AN*..................................**91**

**ALI MUHAMED ALI DUHAJJIL – DEHILI**

*PROFETI SULEJMAN*...........................................................**99**

**AJETULLAH XHA'FAR SUKHANI**

*SHQYRTIMI I KONTEKSTIT TË AJETEVE TË KUR'ANIT*...**109**

**MUHSIN KERAETI**

*MËSIME KUR'ANORE NGA SURJA "BEKARE"*..............**116**

**HAFIZ ALI KORÇA**

*TEFSIRI I SURES "FATIHA"*.................................................**125**

*VEPRIMTARI KUR'ANORE*...................................................**132**

*PËRMBLEDHJE NË GJUHËN ANGLEZE*..........................**138**

*PËRMBLEDHJE NË GJUHËN ARABE*................................**146**

# TABLE OF CONTENTS

*FAREWELL KHUTBAH*..........................................................**9**

**VULLNET MERJA**
*THE TRUE AND GENUINE RELIGION OF ALLAH IS ISLAM*.**19**

**SAYYID ABUL A'LA MAWDUDI**
*FAITH IN ALLAH'S BOOKS*...................................................**24**

*THE CHARACTER OF THE PROPHET*...............................**30**

**ALI KAJA**
*UNIVERSE EXPANSION AND THE BIG EXPLOSION*.....**36**

**JAMAL ABDEL NASER**
*THE PIERCING STAR AND BLACK HOLES*.......................**44**

**MUSAVIJ LARI**
*BELIEF IN IMMORTALITY*....................................................**52**

**ADULDAEM AL-KAHIIL**
*SCIENTIFIC STUDIES ON QUR'AN*....................................**61**

*MAN AND RESPONSIBILITY IN THE HOLY QUR'AN*....**84**

*THE POSITION OF THE PARENTS IN THE HOLY QUR'AN*.....**91**

**ALI MOHAMMED ALI DUHAYYIL - DEHILI**
*PROPHET SOLEYMAN*..........................................................**99**

**AYATOLLAH JA'FAR SUKHANI**
*THE REVIEW OF THE CONTEXT OF THE QUR'AN'S VERSES*...**109**

**MUHSIN KERAETI**
*QUR'ANIC TEACHINGS FROM THE SURAH "AL-BAQARAH"*.**116**

**HAFIZ ALI KORÇA**
*QUR'AN TAFSEER OF SURAH "AL-FATIHAH"*.............**125**

*QUR'ANIC ACTIVITIES*...............................................**132**

*SUMMARIES IN ENGLISH*...........................................**138**

*SUMMARIES IN ARABIC*..........................................**146**

# قائمة المحتويات


خطبة الوداع.......................................................٩

إنّ الدين عند الله الإسلام وُلْنَتْ مَرْيا.............................١٩

الإيمان بكتب الله السيد أبو الأعلى المودودي.........................٢٤

شخصية النبي (صلى الله عليه وآله)....................................٣٠

توسع الكون و الإنفجار الكبير علي كايا...............................٣٦

النجم الثاقب للظلمة و الثغرات السوداء جمال عبد الناصر..............٤٤

الإيمان بالخلود موسوي اللاري.........................................٥٢

أدلة علمية من القرآن عبد الدائم الكحيل...............................٦١

الإنسان والمسؤولية في القرآن..........................................٨٤

مكانة الوالدَيْن في القرآن...............................................٩١

النبي سليمان (عليه السلام) علي محمد علي دحيل........................٩٩

التعاطي بمضمون آيات القرآن آية الله جعفر سبحاني....................١٠٩

دروس قرآنية من سورة البقرة محسن قرائتي.............................١١٦

تفسير سورة الفاتحة الحافظ علي كورچا.................................١٢٥

نشاطات علمية و قرآنية................................................١٣٢

ملخص باللغة الانجليزية ................................................١٣٨

ملخص باللغة العربية ...................................................١٤٦

# Hytbja e Lamtumirës[1]

"O njerëz, dëgjoni se çfarë do t'ju them, se nuk e di a do t'ju takoj më në këtë vend pas këtij viti! O njerëz, frikësojuni Zotit dhe respektojeni Atë, bëhuni të njerëzishëm dhe të drejtë ndaj të tjerëve! Kjo është dita e kurbaneve, me emrin e All'llahut. Vërtet, gjaku, nderi dhe pasuria janë të shenjta për ju, derisa të takoheni me Krijuesin tuaj, ashtu siç është e shenjtë kjo ditë në këtë muaj dhe në këtë vend. Ruajuni, respektoni dhe nderoni vlerën e personalitetit! Njeriu është vepër madhështore e All'llahut. Mjerë ai që e përçmon nderin dhe dinjitetin e veprës së Tij! O njerëz, ju sigurisht do të ktheheni tek All'llahu i Madhëruar dhe Ai do t'ju thërrasë të përgjigjeni për veprat dhe punën tuaj.

O njerëz, dijeni se ka përfunduar koha e padijes dhe e traditave të këqija, të cilat i kane sjellë aq fatkeqësi gjinisë njerëzore. Unë ju kam treguar rrugën e shpëtimit, drejt së cilës duhet ecur. Sendet që ju janë dhënë amanet ruajini si të ishin tuajat dhe kthejuani ato besnikërisht dhe me kohë atij që i përkasin. Gjakmarrja është e ndaluar. Të gjitha të këqijat, të cilat rrjedhin nga koha e injorancës, anulohen. Akuza e parë, e cila anulohet, është gjakmarrja e ungjit tim, Ibn Abdul-Muttalibit, të cilin, e vranë njerëzit nga fi si Hudhejl. Kjo gjakmarrje le të harrohet dhe të gjitha te tjerat në të ardhmen le të falen! Kamata është e ndaluar. Huadhënësi duhet të marrë nga huamarrësi vetëm atë, që ai ia ka huajtuar. Huatë e para që i nënshtrohen këtij vendimi, janë huatë e ungjit tim Abbasit, i cili ka pasur

1. *Është Hytbja që profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) e ka mbajtur në Arafat, në Haxhin e Lamtumirës, në vitin 633. (Shih al-Bukhariu, hadithet 1623, 1626, 6361. Edhe imam Muslimi e përmend Hytben në hadithin 98. Imam al-Tirmidhiu e përmend këtë Hytbe në hadithet 1628, 2046, 2085. Imam Ahmed bin Hanbeli ka sjellë versionin më të gjatë dhe ndoshta, më të plotin e kësaj Hytbeje në hadithin 19774.)*

mjaft borxhlinj. O njerëz, ua falni kamatat borxhlinjve! Dëgjojeni këshillën time dhe pasuria juaj do të shtohet, sepse ju mbetët kryegjëja për tregti dhe punë tw ndershme. Nëse këtë nuk e bëni, dijeni se e keni zemëruar shumë All'llahun dhe të Dërguarin e Tij. Nëse borxhliu juaj është në vështirësi, shtyjani afatin e pagimit; ndërsa, nëse mund t'ia falni borxhin, atëherë kjo është edhe më e mirë për ju. O njerëz! Frikësojuni Ditës, e cila, vërtet do të vijë, kur të gjithë do të paraqiteni para All'llahut, Gjykatësit të Vetëm Suprem, Ditën kur ju pret drejtësia absolute! Kur të keni një borxh, paguajeni në kohë dhe, kur ta bëni marrëveshjen, bëjeni atë me shkrim, saktë dhe theksojeni besnikërisht afatin e pagesës... O ju që do të vdisni! Duajeni dhe dëgjojeni Zotin, Krijuesin e materies dhe asaj që është shpirtërore, i Cili krijoi mashkullin dhe femrën, prej të cilëve u zhvillua e tërë gjinia njerëzore! Frikësojuni All'llahut, me ndihmën, prehjen dhe mëshirën e të Cilit të gjithë jemi udhëzuar! Ne jemi të vdekshëm dhe në çdo moment jemi më afër vdekjes dhe takimit me Të, me All'llahun e Madhëruar, Gjykatësin e Drejtë. Respektojeni farefi sninë. Përmbushni besnikërisht detyrat dhe detyrimet ndaj burrit dhe gruas, si dhe ndaj prindërve dhe fëmijëve! Ruhuni nga imoraliteti, tradhëtia bashkëshortore dhe xhelozia. Imoraliteti dhe tradhtia bashkëshortore janë gjynahe të rënda, ndërsa xhelozia sjell përçarje në martesë.

Martohuni me ato të cilat i doni, e kur Zoti, me vullnetin e Vet do t'ju bashkojë, atëherë respektojeni dhe duajeni njëri-tjetrin dhe jetoni në dashuri e harmoni! O bashkëshortë, silluni ndaj grave tuaja me shumë mirësi dhe dashuri! O njerëz, iu largoni ngatërresave dhe përgojimit! Le të jenë të mallkuar në të dyja botët ata që u bëjnë shpifje grave të ndershme! Ata që i akuzojnë gratë e ndershme për tradhti në martesë ose për imoralitet, e për këtë nuk mund të sjellin katër dëshmitarë të besueshëm, dënojini me tetëdhjetë goditje (shkopinj) dhe mos u besoni më

asnjëherë, sepse janë të ulët dhe të këqinj! Nëse e ndjeni se ndaj grave tuaja ju është dobësuar dashuria, mos nxitoni (në shkurorëzim) por mendohuni mirë, sepse nëpërmjet këtij sprovimi, All'llahu ju udhëzon në rrugët e së ardhmes së re dhe të madhe me të cilën dëshiron t'ju përgëzojë. Mos kërkoni shkurorëzim pa shkaqe të arsyeshme, sepse prej të gjitha gjërave që ka ndaluar All'llahu është shkurorëzimi. Gratë tuaja janë dorëzuar në besë të Zotit; pra respektojeni këtë amanet të Zotit! O njerëz, sot, Djalli i mallkuar është i dëshpëruar, sepse ka pësuar humbje dhe nuk mundet të ndikojë te ju.

Megjithatë, gjithnjë bëhuni të kujdesshëm, që ai i mallkuari të mos ju largojë as në gjërat më të vogla! O njerëz, kur e caktoni dhe e ndani ndërmjet vetes trashëgiminë, bëhuni të drejtë dhe përmbajuni Librit të Zotit (Kur'anit)! Ruajeni pasurinë e të miturve, të të paaftëve dhe të të marrëve. Zoti ia ka dhënë gjithkujt të drejtën e vet; prandaj nuk ka nevojë t'u lihen trashëgimtarëve testamente, ndërsa si testament. Si testament mund të lihet një e treta e pasurisë.

Fëmija i takon atij, në shtratin të cilit është lindur. Kush pohon se i takon tjetërkujt përveç prindit, atë do ta zërë mallkimi i All'llahut. Nuk i lejohet gruas të japë nga pasuria e burrit të vet pa lejen e tij. Borxhi duhet paguar, ndërsa sendi i huajtuar duhet kthyer. Dhurata duhet kthyer me dhuratë. Kush hyn dorëzanë për dikë, detyrohet me përgjegjësi për dorëzani. Me robërit dhe shërbëtorët silluni njerëzisht! Ushqejini ata sikurse ushqeheni vetë, dhe vishini ata sikurse visheni vetë. Mos guxoni t'u bëni keq e t'i keqtrajtoni. Edhe ata janë njerëz, edhe ata janë shërbëtorë të Zotit. O njerëz, dijeni dhe mos harroni se të gjithë myslimanët janë vëllezër. Ju jeni plotësisht të barabartë në të drejta dhe në detyra. Arabi ndaj joarabit nuk ka kurrfarë përparësie e kjo vlen edhe për të ziun ndaj të bardhit, përveçse në devotshmëri. Të gjithë ju jeni pasardhësit e Ademit e Ademi është krijuar nga dheu. O njerëz, kujdesuni për njëri-tjetrin, duajeni dhe

ndihmojeni njëri-tjetrin! Mos guxoni ta fyeni apo ta grabitni njëri-tjetrin. Këto janë gjynahe të rënda. Merrni vetëm atë që ju jepet me dëshirë! Respektojeni pacënueshmërinë e pasurive tuaja, derisa të jeni në frymën e Ligjeve të Zotit. Islami dhe interesi i përgjithshëm le të jetë mbi ju dhe mbi interesin tuaj! Përkushtojani Islamit jetën tuaj dhe në punën për Islamin jepni prej vetes gjithçka që mundeni! Kurrë mos e shkelni të drejtën dhe nderin e tjetrit! Mos i bëni dhunë vetes! Mos harroni se mëshira është një ndër themelet e Islamit! O njerëz, dëgjoni se ç'po ju them dhe mbajeni mend mirë! Po ju lë Librin e Zotit, Kur'anin, të cilit nëse i përmbaheni, gjithnjë do t'ju ruajë që të mos e humbni rrugën e drejtësisë dhe të së vërtetës.

Kur'ani është libër i qartë dhe i shenjtë, vepër e vërtetë e All'llahut dhe fjala e Tij, në vërtetësinë e të cilit nuk ka asnjë dyshim. Para vetes e keni tërë jetën time, të gjitha fjalët dhe veprat e mia, gjithçka që kam folur dhe punuar. Jam përpjekur të jenë në përputhje të plotë me urdhrat e All'llahut. , vërtet nuk do të gaboni, nëse i përmbaheni Kur'anit (Librit të Zotit) dhe synetit (traditës sime). O njerëz, pas meje nuk do të vijë më i Dërguar tjetër nga Zoti dhe pas jush populli nuk do të ketë më Pejgamber! Pra, bëni ibadet dhe adhuroni Zotin; agjëroni muajin e Ramazanit; jepni zekatin me zemër të plotë dhe të kënaqur dhe kryejeni haxhin.

Kështu, do të hyni në Xhennetin e Zotit të Madhëruar! O njerëz, thoni gjithnjë të vërtetën e pastër! Asnjëherë të mos ju largojë urrejtja nga rruga e drejtë. Drejtësia është motra e devotshmërisë. Frikësojuni All'llahut se Ai i sheh mirë veprimet tuaja! O njerëz, e dëgjuat porosinë time. Atëherë, futeni atë në zemrën tuaj dhe në jetën tuaj! Të gjithë ata që i dëgjuan fjalët e mia, le t'ua përcjellin atyre që nuk i kanë dëgjuar se ndodh që ata i kuptojnë më mirë.

O Zoti im, a e përmbusha detyrën dhe misionin e besuar?" Mbi njëqind mijë haxhinj folën njëzëri:

O i Dërguari i Zotit, ti e përmbushe misionin tënd besnikërisht dhe na e komunikove atë që të urdhëroi Zoti... Atëherë, Muhammedi (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!) tha: "O Zot, dëshmo! O Zot, dëshmo! O Zot, dëshmo!" Atë ditë iu shpall ajeti nga Zoti i Lartësuar: «Sot kam përsosur fenë tuaj, plotësova dhuntinë time për ju dhe jam i kënaqur që Islami të jetë feja juaj.» (Sure El-Maide, ajeti 3)

# Farewell Khutbah

Prophet Muhammad (SAWS) delivered his last Khutbah (sermon) on the ninth of Dhul Hijjah (12th and last month of the Islamic year), 10 years after Hijrah (migration from Makkah to Madinah) in the Uranah Valley of mount Arafat. His words were quite clear and concise and were directed to the entire humanity. After praising, and thanking Allah he said: «**O People, lend me an attentive ear, for I know not whether after this year, I shall ever be amongst you again. Therefore listen to what I am saying to you very carefully and TAKE THESE WORDS TO THOSE WHO COULD NOT BE PRESENT HERE TODAY.**

**O People, just as you regard this month, this day, this city as Sacred, so regard the life and property of every Muslim as a sacred trust. Return the goods entrusted to you to their rightful owners. Hurt no one so that no one may hurt you. Remember that you will indeed meet your LORD, and that HE will indeed reckon your deeds. ALLAH has forbidden you to take usury (interest), therefore all interest obligation shall henceforth be waived. Your capital, however, is yours to keep. You will neither infl ict nor suffer any inequity. Allah has Judged that there shall be no interest and that all the interest due to Abbas ibn 'Abd'al Muttalib (Prophet's uncle) shall henceforth be waived... Beware of Satan, for the safety of your religion. He has lost all hope that he will ever be able to lead you astray in big things, so beware of following him in small things. O People, it is true that you have certain rights with regard to your women, but they also have rights over you. Remember that you have taken them as your wives only under Allah's trust and with His permission.**

**If they abide by your right then to them belongs the right to be fed and clothed in kindness. Do treat your women well and be kind to them for they are your partners and committed helpers. And it is your right that they do not make friends with any one of whom you do not approve, as well as never to be unchaste.**

**O People, listen to me in earnest, worship ALLAH, say your fi ve daily prayers (Salah), fast during the month of Ramadan, and give your wealth in Zakat. Perform Hajj if you can afford to. All mankind is from Adam and Eve, an Arab has no superiority over a non-Arab nor a non-Arab has any superiority over an Arab; also a white has no superiority over black nor a black has any superiority over white except by piety and good action. Learn that every Muslim is a brother to every Muslim and that the Muslims constitute one brotherhood. Nothing shall be legitimate to a Muslim which belongs to a fellow Muslim unless it was given freely and willingly. Do not, therefore, do injustice to yourselves. Remember, one day you will appear before ALLAH and answer your deeds. So beware, do not stray from the path of righteousness after I am gone.**

**O People, NO PROPHET OR APOSTLE WILL COME AFTER ME AND NO NEW FAITH WILL BE BORN. Reason well, therefore, O People, and understand words which I convey to you. I leave behind me two things, the QURAN and my example, the SUNNAH and if you follow these you will never go astray.**

**All those who listen to me shall pass on my words to others and those to others again; and may the last ones understand my words better than those who listen to me directly. Be my witness, O ALLAH, that I have conveyed your message to your people».**

# خطبة الوداع

«الحمد لله ونستعينه ونستغفره ونتوب إليه ونعوذ بالله من شرور أنفسنا ومن سيئات أعمالنا، من يهد اللهُ فلا مضلّ له ومن يضلل فلا هادى له، وأشهد أن لا إله إلا الله وحده لا شريك له، وأشهد أن محمدا عبده ورسوله. أوصيكم عباد الله بتقوى الله، وأحثكم على طاعته وأستفتح بالذى هو خير، أما بعدُ أيها الناسُ اسمعوا منى أبين لكم فإنى لا أدرى لعلى لا ألقاكم بعد عامى هذا فى موقفى هذا. أيها الناسُ: إن دماءكم وأموالكم حرامٌ عليكم. إلى أن تَلقوْا ربّكم كحرمة يومكم هذا فى شهركم هذا، فى بلدِكم هذا، ألا هل بلغت؟ اللهم اشهد! فمن كانت عنده أمانةٌ فليؤدّها إلى من ائتمنه عليها وإن رِبا الجاهلية موضوعٌ وإن أول رِبًا أبدأ به ربا عمى العباس بن عبد المطلب وإن دماء الجاهلية موضوعةٌ، وإن أول دمٍ نبدأ به – دم عامر بن ربيعة بن الحارث بن عبد المطلب، وإن مآثرَ الجاهلية موضوعة غير السِّدانةِ والسقايةِ والعمْدَ قوَد وشِبه العَمْد ما قتل بالعصا والحجر وفيه مائةُ بعير فمن زاد فهو من أهل الجاهلية. أيها الناسُ إن الشيطانَ قد يئس أن يُعبدَ فى أرضكم هذه ولكنه قد رضى أن يطاعَ فيما سوى ذلك مما تحقرون من أعمالكم. أيها الناسُ «إنَّما النسىءُ زيادةٌ فى الكُفْرِ يُضَلُّ بِهِ الذينَ كَفَروا يُحلُّونَهُ عامًا ويُحرِّمونهُ عامًا لِيُواطِئوا عِدَّة ما حَرَّم اللهُ» ، وأن الزمانَ قد استدار كهيئته يوم خلق اللهُ السمواتِ والأرضِ و «أنَّ عِدَّة الشُهُور عِندَ اللهِ اثْنا عَشَرَ شَهرًا فى كِتَابِ اللهِ يَومَ خَلَقَ السَّمَواتِ و الأَرْضَ»، منها إربعةٌ حرم ثلاثة متوالياتٌ و واحد فرد. ذو القعدة و ذو الحجة والمحرمُ و رجبُ الذى بين جُمادى و شعبانَ، ألا هل بلغت؟ اللهم اشهد! أيها الناسُ إن لنسائكم عليكم حقًا، و لكم عليهن حقٌ. لكم عليهن أن لا يُوطئنَ فرْشكم غيرَكم ولا يُدخلن أحدا تكرهونه بيوتكم إلا بإذنكم و لا يأتين بفاحشة، فإن فعلن فإنَّ الله قد أذن لكم أن تعضلوهن و تهجروهن فى المضاجع و تضربوهن ضربا غير مُبرِّح، فإن انتهْين و أطعنكم فعليكم رزقهُن و كسوتهن بالمعروف وإنما النساءُ عندكم عوان، لا يملكن لأنفسهن شيئا. أخذتموهن بأمانةِ الله، و استحللتم فروجَهن بكلمة الله، فاتقوا الله فى النساء، و استوصوا بهنَّ خيرا. ألا هل بلغت؟ اللهم اشهد! أيها

الناس «إنما المؤْمِنُونَ إخوَةٌ»، و لا يحل لامرىء مالُ أخيه إلا عن طيب نفس منه ألا هل بلغت؟ اللهم اشهد! فلا ترجعُنَّ بعدى كفارا يضربُ بعضُكم رقاب بعض فإنى قد تركتُ فيكم ما إن تمسكتم بهما لن تضلوا بعدي أبدا، كتاب الله و سنتى[1]، ألا هل بلغت؟ اللهم اشهد! أيها الناس إن ربكم واحد و إن أباكم واحد كلُّكم لآدم و آدم من تراب، أكرمُكم عند الله أتقاكم، و ليس لعربى على عجمى فضلٌ إلا بالتقوى - ألا هل بلغت؟ اللهم اشهد! قالوا: نعم. قال فليبلغ الشاهدُ الغائب. أيها الناس إن الله قد قسم لكل وارثٍ نصيبه من الميراث، ولا يجوز لوارث وصية؛ ولا يجوزُ وصية فى أكثر من الثلث، و الولدُ للفراشِ وللعاهر الحجر، من ادعى إلى غير أبيه أو تولى غيرَ واليه، فعليه لعنةُ الله و الملائكةِ و الناسِ أجمعين، لا يُقبل منه صَرف و لا عدل والسلام عليكم و رحمة الله.»

ولما أتم النبى صلوات الله عليه خطبة الوداع، وبعد أن صلى الظهر والعصر، اتجه إلى الصخرات. وهناك تلا قول الله سبحانه وتعالى: «اليوم أكْملت لكم دينكم و أتممت عليكم نعمتى و رضيت لكم الإسلام دينا» (المائدة /٣)

[1] ورد فى كتاب كنز العمال ح. ٨٧٩٢٣ بلفظ "كتاب الله و عترتى"

**Vullnet Merja**

# Feja e vërtetë tek Allahu është vetëm Islami

## Abstrakt

*Emri mysliman u bë i njohur për ata që e pasonin profetin Muhamed* (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) *dhe fenë islame. Në Kur'an ka disa ajete që dëshmojnë se feja e pranuar tek Allahu është Islami:* ***"Atë që do Allahu ta udhëzojë ia hap zemrën për (të pranuar) Islamin..."*** ("En'am", 125) *Dhe:* ***"O ju që keni besuar! Jini të devotshëm ndaj Allahut ashtu siç i takon Atij dhe vdisni vetëm duke qenë myslimanë!"*** ("Ali Imran", 102) *Dhe:* ***"Feja e vërtetë tek Allahu është vetëm Islami."***

Allahu i Madhëruar thotë: **"Feja e vërtetë tek Allahu është vetëm Islami."**

Nga ana gjuhësore fjala *islam* ka dy kuptime:

Kuptimi i parë: Dorëzim dhe përulje.

Kuptimi i dytë: Adhurim i sinqertë i Allahut.

Për kuptimin e parë, në Kur'an, lexojmë:

**"A mos kërkojnë ata diçka tjetër përveç fesë së Allahut, ndërkohë që Atij i përulen të gjithë ata që gjenden në qiej dhe në Tokë, me hir a me pahir dhe tek Ai do të kthehen të gjithë?!"** ("Ali Imran", ajeti 83)

Dhe: **"Pasi iu nënshtruan që të dy urdhrit, (Ibrahimi) e vuri (Ismailin) me ballë përtokë."**

Për kuptimin e dytë, në Kur'an lexojmë:

**"Kush i dorëzohet Allahut, me tërë qenien e tij, duke qenë punëmirë, ai është kapur për vegën më të fortë. Tek Allahu do të kthehet çdo gjë."** ("Lukman", 22)

Dhe: **"Kur Zoti i tij i tha: "Përulu!" - ai u përgjigj: "Iu përula Zotit të Gjithësisë!"**

## Islami, fe e të gjithë profetëve paraardhës

### Islami, feja e profetit Nuh

Ai i thoshte popullit të tij: "Por, nëse ktheni shpinën, (dijeni se) unë prej jush nuk kërkoj kurrfarë shpërblimi. Shpërblimi im është vetëm tek Allahu. Mua më është urdhëruar të jem prej atyre që i nështrohen (Atij)." ("Junus",72)

### Islami, feja e profetit Ibrahim

Kur'ani thotë: "Ibrahimi nuk ka qenë as hebre, as i krishterë, por ka qenë besimtar i vërtetë (monoteist) i përulur ndaj Allahut dhe nuk ka qenë nga politeistët."

**Islami, feja e pasardhësve të Ibrahimit**: **Kur Zoti i tij i tha: "Përulu!" - ai u përgjigj: "Iu përula Zotit të Gjithësisë!"** Ibrahimi ua dha këtë porosi fëmijëve të tij; po ashtu edhe Jakubi: **"O bijtë e mi! Pa dyshim, Allahu ka zgjedhur për ju fenë e vërtetë, prandaj mos vdisni ndryshe, veçse duke qenë myslimanë të nënshtruar ndaj Atij!"** ("Bekare", 131-132)

### Islami, feja e profetit Ja'kub

Në Kur'an thuhet: **"A ishit ju të pranishëm kur Jakubit iu afrua vdekja dhe i pyeti të bijtë: 'Çfarë do të adhuroni pas meje?' - Ata u përgjigjën: 'Ne do të adhurojmë Zotin tënd, që është edhe Zoti i etërve të tu: Ibrahimit, Ismailit dhe Is'hakut, një Zot të vetëm. Ne Atij i nënshtrohemi!'"** ("Bekare", 133)

## Islami, feja e profetit Musa

Kur'ani thotë: **"Musai tha: 'O populli im! Nëse besoni Allahun, mbështetuni tek Ai, nëse jeni myslimanë!'"**

## Islami, feja e profetit Jusuf

Ai lutej duke thënë: **"Bëj që të vdes si mysliman dhe më shoqëro me punëmirët (në Botën Tjetër)!"** ("Jusuf", 101)

## Islami, feja e profetit Lut:

**"Ne i nxorëm të gjithë besimtarët që ishin në atë qytet, ndonëse aty gjetëm vetëm një shtëpi myslimane."** ("Dharijat", 35-36)

## Islami, feja e profetit Isa

Në Kur'an thuhet: **"Kur Isai vuri re mosbesimin e tyre, tha: 'Kush janë ndihmuesit e mi në rrugën e Allahut?' Nxënësit (e tij) u përgjigjën: 'Ne jemi ndihmuesit e (fesë së) Allahut. Ne e besojmë Allahun e ti (Isa) dëshmo se ne (i) jemi nënshtruar (Atij).'"** ("Ali Imran", 52)

## Islami, feja e profetit Sulejman

Në Kur'an lexojmë: **"'Sulejmani tha: 'Para saj na është dhënë dituria dhe para saj i jemi nënshtruar Allahut.'"** ("Neml", 42)

### Islami, feja që përqafoi mbretëresha e Sebes

**"Ajo tha: 'O Zoti im, me të vërtetë unë e paskam dëmtuar veten dhe tani, bashkë me Sulejmanin i dorëzohem Allahut - Zotit të botëve!"** ("Neml", 44)

**Islami, feja në të cilën hynë magjistarët e Faraonit, kur Allahu ua udhëzoi zemrat dhe ata i bënë sexhde Atij duke thënë: "O Zoti ynë, na jep durim të madh dhe na bëj të vdesim myslimanë!"** ("A'raf", 126)

## Islami është feja e besimtarëve prej xhindeve.

Kur'ani thotë: **"Ka prej nesh që janë myslimanë, por ka edhe të atillë që janë jobesimtarë. Kush ka përqafuar Islamin, ka zgjedhur rrugën e drejtë."** ("Xhin", 14)

**Islami është feja e zgjedhur nga Allahu për njerëzit: "Sot jua përsosa fenë tuaj, e plotësova dhuntinë Time ndaj jush dhe zgjodha që Islami të jetë feja juaj."** ("Maide", 3)

**Islami është feja ku jobesimtarët në Ditën e Kiametit do të dëshironin të kishin qenë prej ndjekësve të tij.** Në Kur'an thuhet: **"Do të vijë dita (e Kiametit), kur mohuesit do të dëshironin që të ishin myslimanë."** ("Hixhr", 2)

Në ditën e Kiametit nuk ka siguri nga frika e tmerri e as nuk hyhet në Xhenet, vetëm se duke qenë mysliman. Kur'ani thotë: **"(Allahu do t'u thotë): 'O robtë e Mi, për ju sot nuk ka frikë dhe as që do të pikëlloheni. Ju që keni besuar shpalljet Tona dhe keni qenë myslimanë, hyni në Xhenet të gëzuar, ju dhe bashkëshortet tuaja, ku do t'ju shërbehet me pjata dhe gota prej ari. Aty do të ketë çfarë t'ju dojë shpirti dhe gjithçka që ta kënaq syrin dhe atje do të qëndroni përgjithmonë. Ja, ky është Xheneti që ju është dhënë në trashëgim për atë që keni bërë. Aty do të keni fruta të shumëllojshme, prej të cilave do të hani."** (Sure "Zuhruf", ajetet 68-73)

## Në terminologji, *Islami* ka kuptimin e zbatimit të urdhave të Allahut.

Më pas, Islami u bë fe e njohur, e cila iu shpall profetit Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!).

Emri *mysliman* u bë i njohur për ata që e pasojnë profetin Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) dhe fenë islame. Në Kur'an lexojmë ajete nga Kur'ani që dëshmojnë se feja e pranuar tek Allahu është Islami:

**"Atë që do Allahu ta udhëzojë ia hap zemrën për (të pranuar) Islamin..."** ("En'am", 125)

**"O ju që keni besuar! Jini të devotshëm ndaj Allahut ashtu siç i takon Atij dhe vdisni vetëm duke qenë myslimanë!"** ("Ali Imran", 102)

**"Thuaj: 'Në të vërtetë, namazi im, kurbani im, jeta ime dhe vdekja ime, i përkasin vetëm Allahut, Zotit të botëve. Ai nuk ka asnjë ortak. Kështu jam urdhëruar dhe unë jam i pari mysliman."** ("En'am", 162-163)

Islami është feja e vetme që e pranon Allahu. Kur'ani thotë: **"Kush kërkon tjetër fe përveç Islamit, nuk do t'i pranohet dhe ai në Botën Tjetër do të jetë i humbur."** ("Ali Imran", 85)

**Sejjid Ebul A'la Maududi**

# Besimi në Librat e Allahut


## Abstrakt

*Kushti i tretë i besimit, të cilin Muhamedi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) na e ka urdhëruar, është besimi në Librat e Allahut. Janë Librat, të cilët Allahu ia ka zbritur njerëzimit nëpërmjet Profetëve të Tij para Muhamedit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). Këta Libra janë zbritur nga Allahu në të njëjtën mënyrë, ashtu siç i është zbritur Kur'ani Muhamedit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). Ne i dimë emrat e disa prej këtyre Librave. Ata janë: Fletët (që i zbritën Ibrahimit), Teurati (Musait), Zeburi /Psalmet (Daudit) dhe Ungjilli (Isait). Ne jemi urdhëruar të besojmë në Librat e zbritur më parë vetëm në kuptimin që ne pranojmë se përpara Kur'anit, Allahu ka zbritur, gjithashtu, Libra nëpërmjet Profetëve të Tij, se ata të gjithë kanë qenë nga i njëjti Zot. Është i njëjti Zot, i Cili dërgoi Kur'anin. Dërgimi i Kur'anit si Libër i Zotit nuk është ngjarje e re dhe e habitshme, por vetëm për të vërtetësuar, për të rishpallur dhe për të plotësuar ato udhëzime të Allahut, të cilat njerëzit i patën shtrembëruar ose i patën humbur në lashtësi.*


Kushti i tretë i besimit, të cilin Muhamedi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) na e ka urdhëruar, është besimi në Librat e Allahut. Janë Librat, të cilët Allahu ia ka zbritur njerëzimit nëpërmjet Profetëve të Tij para Muhamedit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). Këta Libra janë zbritur nga Allahu në të njëjtën mënyrë, ashtu siç i është zbritur Kur'ani Muhamedit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). Ne i dimë emrat e disa prej këtyre Librave.

Ata janë: Fletët që i zbritën Ibrahimit, Teurati (Musait), Zeburi/Psalmet (Daudit) dhe Ungjilli (Isait). Ne nuk kemi dijeni për emrat e Librave, që u janë zbritur Profetëve të tjerë. Prandaj, për libra të tjerë fetarë ne nuk jemi në gjendje të themi me siguri nëse ata ishin origjinalë, të zbritur apo jo. Por ne heshturazi besojmë se çfarëdo libri që të ketë zbritur Allahu, ai është i vërtetë.

Nga librat për të cilët kemi dijeni, Fletët e Ibrahimit janë zhdukur dhe nuk gjenden në literaturën ek-zistuese botërore. Zeburi (Psalmet) i Daudit, Teurati dhe Ungjilli janë te hebrenjtë dhe tek të krishterët, por Kur'ani na thotë se njerëzit i kanë ndryshuar këta Libra e kanë bërë shtesa në ta dhe fjalët e Allahut janë përzier me tekste që i kanë bërë vetë ata[1]. Ky shtrembërim ka qenë kaq i madh e kaq i dukshëm dhe kjo përdhosje e Librave ka qenë kaq e madhe e kaq e dukshme, sa madje, vetë hebrenjtë dhe të krishterët e kanë pranuar se nuk i kanë tekstet e tyre origjinale dhe kanë vetëm përkthimet e tyre dhe ku për shumë shekuj janë bërë shumë ndryshime e vijojnë ende të bëhen. Po t'i shqyrtosh këta Libra, gjen shumë pasazhe dhe të dhëna, të cilat dukshëm nuk mund të jenë nga Allahu.

1. Edhe një studim i përciptë i librave të parë të Dhiatës së vjetër dhe të katër Ungjijve të Dhiatës së re zbulon se ata janë pro
dhime të penës së njerëzve dhe se në këto shkrime janë përfshirë disa pjesë të Psalmeve origjinale të Daudit dhe të Ungjijve origjinalë të Krishtit. Pesë librat e parë të Dhiatës së vjetër nuk përbëjnë Teuratin origjinal, por pjesë të Teuratit janë përzier me tregime të tjera të shkruara nga njeriu dhe udhëheqësia origjinale e Allahut ka humbur në atë kënetishtë. Po kështu, edhe katër Ungjijtë e Krishtit nuk janë Ungjijtë origjinalë, siç u përcollën ata nga profeti Isa (paqja qoftë mbi të!). Në fakt, ata janë histori të jetës së Krishtit, të hartuara nga katër persona të ndryshëm në bazë të dijes e ç'është dëgjuar andej-këtej dhe pjesë të caktuara të Ungjillit origjinal. Por origjinalja dhe e trilluara, ajo që ka zbritur nga Allahu dhe njerëzorja janë përzier aq shumë, sa nuk mund të ndahet gruri nga egjra. Fakt është se Fjala origjinale e Allahut nuk është ruajtur as te hebrenjtë, as tek të krishterët. Kurse Kur'ani, nga ana tjetër është ruajtur plotësisht dhe as edhe një shkronjë nuk është ndryshuar e as edhe një shkronjë nuk është lënë jashtë.

Fjalët e Allahut dhe fjalët e njeriut janë përzier në këta Libra dhe nuk kemi asnjë mundësi të dimë se cila pjesë është nga Allahu dhe cila pjesë është nga njeriu. Ne jemi urdhëruar të besojmë në Librat e zbritur më parë vetëm në kuptimin që ne pranojmë se përpara Kur'anit, Allahu ka zbritur, gjithashtu, Libra nëpërmjet profetëve të Tij, se ata të gjithë kanë qenë nga i njëjti Zot. Është i njëjti Zot, i Cili dërgoi Kur'anin dhe dërgimi i Kur'anit si Libër i Zotit nuk është ngjarje e re dhe e habitshme, por vetëm për të vërtetësuar, për të rishpallur dhe për të plotësuar ato udhëzime të Allahut, të cilat njerëzit i patën shtrembëruar ose i patën humbur në lashtësi. Kur'ani është Libri i fundit që është zbritur nga Allahu. Midis tij dhe Librave të mëparshëm ka dallime thelbësore. Këto dallime janë shkurtimisht si më poshtë:

1. Tekstet origjinale të pjesës më të madhe të Librave të mëparshëm të Allahut kanë humbur krejtësisht dhe sot ekzistojnë vetëm përkthimet e tyre. Kurse Kur'ani ekziston ekzaktësisht siç i është zbritur Profetit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!); as edhe një fjalë - jo, as edhe një pikë e tij - nuk ka ndryshuar. Ai është si libër (mus'haf) sipas tekstit të tij origjinal dhe Fjala e Allahut është tashmë e ruajtur për të gjitha kohët që do të vijnë.

2. Në Librat e mëparshëm të Allahut njeriu i ka përzier fjalët e tij me fjalët e Allahut. Kurse në Kur'an gjejmë vetëm fjalët e Allahut - dhe, me pastërtinë e tyre të pacenuar. Kjo pranohet, madje edhe nga kundërshtarët e Islamit.

3. Ndryshe nga çdo Libër tjetër i shenjtë, kur për ndonjë prej tyre nuk dihet se në ç'kohë ka zbritur dhe cilit Profet i është zbuluar, për Kur'anin dihet se kur ka zbritur dhe kujt i ka zbritur. Për Kur'anin të dhënat se i është zbritur Muhamedit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) janë kaq vëllimore, kaq bindëse, kaq të fuqishme dhe kaq imponuese, sa, madje kritika më e ashpër për Islamin nuk mund të hedhë asnjë dyshim mbi të. Këto të dhëna janë

kaq të gjera dhe kaq të hollësishme, sa dihet me siguri edhe rasti dhe vendi i zbritjes së shumë ajeteve dhe urdhrave të Kur'anit.

4. Librat e mëparshëm të Allahut kanë zbritur në gjuhë, të cilat kanë vdekur shumë kohë më parë. Në kohën e sotme, asnjë komb e asnjë bashkësi nuk i flet ato gjuhë dhe ka vetëm pak njerëz që mëtojnë se i kuptojnë ato. Kështu, edhe sikur këta Libra të kishin ekzistuar sot në formën e tyre origjinale dhe të paprekur, do të kishte qenë virtualisht e pamundur në kohën e sotme për t'i kuptuar e për t'i interpretuar saktë urdhrat e tyre dhe për t'i zbatuar ata në praktikë siç duhet. Kurse gjuha e Kur'anit është gjuhë e gjallë; miliona njerëz e flasin atë dhe miliona të tjerë e dinë dhe e kuptojnë atë. Ajo mësohet pothuajse në çdo universitet të botës. Çdo njeri mund ta mësojë atë. Ai që nuk ka kohë për ta mësuar atë, mund të gjejë njerëz kudo, të cilët e dinë këtë gjuhë dhe mund t'ia shpjegojnë atij kuptimet e Kur'anit.

5. Secili nga Librat e shenjtë ekzistues që gjendet ndër kombe të ndryshme të botës, i është drejtuar një populli të veçantë. Secili prej tyre përmban një numër urdhrash, të cilët janë synuar për një periudhë të veçantë të historisë dhe që plotësonin vetëm nevojat e asaj kohe. Për ata as ka nevojë sot, as nuk mund të vihen në jetë tani. Është e qartë, atëherë se këta Libra kanë qenë synuar veçanërisht pikërisht për ata njerëz dhe asnjëri nga ata nuk ka qenë synuar për të gjithë botën. Për më tepër, ata nuk qenë dërguar për t'u pasuar përgjithmonë, madje as edhe nga njerëzit, për të cilët qenë synuar; ata qenë synuar për t'u zbatuar vetëm për një periudhë të caktuar. Në dallim nga ata, Kur'ani ka zbritur për t'iu drejtuar të gjithë njerëzimit; as edhe një urdhër i vetëm i tij nuk mund të dyshohet se i është drejtuar një populli të veçantë. Po kështu, të gjithë urdhrat në Kur'an janë të tillë që mund të zbatohen në çdo vend dhe në çdo kohë. Ky fakt provon se Kur'ani është për të gjithë botën dhe është një kod i përjetshëm për jetën e njeriut.

6. Nuk mund të mohohet fakti se edhe Librat e mëparshëm të Allahut urdhëronin mirësinë dhe virtytin; edhe ata i mësonin njeriut parimet e moralit dhe të së vërtetës dhe i tregonin mënyrën e jetesës që e kënaqte Allahun; por asnjëri prej tyre nuk ishte gjithëpërfshirës, që të rrokte gjithçka që është e nevojshme për një jetë njerëzore të virtytshme, ku asgjë të mos jetë e tepërt dhe asgjë të mos mungojë. Disa prej tyre dalloheshin në një drejtim; të tjerët dalloheshin në një drejtim tjetër.

Por është Kur'ani dhe vetëm Kur'ani ai, i cili urdhëron jo vetëm atë që ka qenë e mirë në Librat e mëparshëm, por që e përsos, gjithashtu, rrugën e Allahut në tërë plotësinë e saj dhe që paraqit atë kod të jetës që përfshin gjithçka që është e nevojshme për njeriun në këtë Tokë.

7. Si rrjedhojë e ndërhyrjes dhe e ndërfutjes së njeriut, shumë gjëra që janë kundër realitetit, që i kundërvihen arsyes dhe që fyejnë çdo instinkt të drejtësisë, janë shtuar në ata Libra. Ka gjëra që janë të padrejta e barbare dhe që shkatërrojnë besimet dhe veprimet e njeriut. Fatkeqësisht, janë futur gjëra që janë të turpshme, të pandershme dhe dukshëm të pamoralshme.

Kur'ani nuk ka asgjë nga të tilla gjepura. Ai nuk përmban asgjë kundër arsyes dhe asgjë të gabuar. Asnjë nga urdhrat e tij nuk është i padrejtë. Asgjë në Kur'an nuk të çon në rrugë të gabuar. As edhe një gjurmë pandershmërie dhe imoraliteti nuk mund të gjendet në të. Që nga fillimi e deri në fund, i gjithë Libri është plot urtësi dhe të vërteta. Ai përmban filozofinë më të mirë dhe Sheriatin (ligjin) më të zgjedhur për qytetërimin njerëzor. Ai i tregon njeriut rrugën e drejtë dhe e udhëheq njeriun drejt suksesit dhe shpëtimit.

Janë këto tipare të veçanta të Kur'anit që i kanë bërë të gjithë popujt e botës për të besuar në të, për t'i braktisur të gjithë Librat e tjerë dhe për të ndjekur vetëm atë. Ai përmban gjithçka që është themelore për jetën, siç do

Allahu dhe prandaj pas tij nuk ka absolutisht asnjë nevojë për asnjë Libër tjetër të Allahut.

Dallimi ndërmjet Kur'anit dhe Librave të tjerë të Allahut e bën njeriun ta kuptojë me lehtësi se besimi në Kur'an dhe besimi në Librat e mëparshëm nuk është njëlloj. Besimi në Librat e mëparshëm të Allahut duhet të kufizohet te pohimi se ata ishin të gjithë nga Allahu, ishin të vërtetë dhe janë dërguar për të përmbushur, për kohën e tyre të njëjtin qëllim, për të cilin është dërguar Kur'ani. Kurse, besimi në Kur'an është se *ai* është *krejtësisht dhe absolutisht vetë fjala e Allahut*, se *ai është përsosurisht i vërtetë*, se *çdo fjalë e tij ruhet*, se *gjithçka që përmendet aty është e drejtë*, se *është detyrë e urdhëruar për njeriun që të zbatojë në jetën e tij çdo urdhër të tij* dhe se *çfarëdo që është kundër tij, duhet të mos pranohet*.

# Karakteri i Profetit

## *(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)*[1]


## Abstrakt

*I ndihmuar nga Zoti i Gjithëfuqishëm, Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) e përcaktoi rrugën që në fillim, qortoi sjelljen e gabuar të njerëzve të tij pa asnjë ngurrim e pa asnjë frikë dhe vijoi t'i qortonte këto veprime e besime të gabuara*[2]*. Ai jo vetëm nuk e kaloi për asnjë çast jetën e tij të bekuar në idhujtari, por siç e përmendëm, ai urrente të dëgjonte emrat e idhujve*[3]*. Ndershmëria dhe pastërtia e tij njiheshin nga të gjithë. Ndershmëria e tij e jashtëzakonshme i bëri njerëzit ta mbiquanin 'i Besueshmi'. Virtytet e tij të larta e bënë Hatixhen t'i besonte atij pasurinë tregtare. Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) kishte sjellje tjetër e jo si njerëzit e tjerë dhe në asnjë mënyrë nuk i pranonte zakonet dhe sjelljet e këqija fisnore. Për të gjitha këto arsye njerëzit e respektonin shumë atë dhe mbështeteshin fort në mendimet e tij për të zgjidhur problemet e tyre.*


## Parimi i harmonisë

Psikologët mendojnë se mjedisi vë bazat e karakterit të njerëzve dhe të mënyrës së tyre të të menduarit dhe se parimi i harmonisë i bën njerëzit të ndjekin modelet mbizotëruese

1. Marrë nga: Dar Rah Hakk's Board of Writters, *A Glance at the Life of the Holy Prophet of Islam* (Një vështrim në jetën e Profetit të Shenjtë të Islamit), kreu 6. Botuar nga "Mostazafan Foundation of New York. 500 Fifth Avenue, New York, NY 10110".
2. *Ibid*, f. 227 - 281; *Nahj ul - Balaghah of Fiydul - Islam*, f. 802.
3. *A'lam Alwari*, f. 17 - 18; *Bihar ul - Anwar*, vëll. 15, f. 410.

të mendimit dhe të sjelljes së shoqërisë.[4] Megjithatë, disa nga këta psikologë kanë shkuar deri në ekstrem në këtë çështje. Ata e kanë parë këtë teori si një parim të përgjithshëm dhe gjithëpërfshirës, sipas së cilës të gjitha dukuritë shoqërore, pa përjashtim mund të analizohen dhe parimi i ndikimit të shoqërisë në moralin e njeriut është i pamohueshëm.

Prandaj, një mjedis i virtytshëm dhe i shëndetshëm prodhon pasardhës normalë dhe të devotshëm, kurse një mjedis i korruptuar, i devijuar natyrisht, do t'i çojë njerëzit në humnerën e korrupsionit dhe të degradimit. Atëherë, ata që mbeten të paprekur nga faktorët degradues të shoqërisë duhet të jenë njerëz të pazakontë.

## Mjedisi i Arabisë para ardhjes së Islamit

Para ardhjes së Islamit, e gjithë bota, veçanërisht Arabia ishte zhytur në injorancë, korrupsion dhe trazira. Arabët ishin mbërthyer nga besëtytnitë dhe imoraliteti. Injoranca kishte errësuar jetët e arabëve. Ata bënin jetë gjithë vuajtje. Plaçkitjet dhe vrasjet ishin krejt të zakonshme. Plaçkiteshin pasuritë e njerëzve të varfër dhe vriteshin njerëz të pafajshëm. Më e turpshmja e të gjithave ishte adhurimi i idhujve[5]. Besimet e gënjeshtërta dhe dallimet klasore ishin të shumta. Ajo që mungonte ishte ligji dhe drejtësia.

Të pasurit e sundonin klasën e varfër dhe e shfrytëzonin atë. Ata grumbullonin pasuri duke shfrytëzuar të dobëtit, jetimët dhe të vejat. Biznesi ishte kaq i palogjikshëm dhe kaq i padrejtë, sa do ta kërkonin borxhin e burrave nga gratë dhe do t'i mbanin peng burrat për mospagimin e borxhit nga gratë e tyre të varfra[6]. Në vend që arabët të kërkonin dituri dhe virtyt, ata mburreshin me gjyshërit dhe stërgjyshërit e tyre dhe me numrin e madh të farefisit të tyre.

4. *Rahbarani Buzurg va Masuliathayih Buzurgtar*, botimi i dytë, f. 37.
5. Will Durant, *A! - Durrat u! - biyda fi Sharhi Khutbati Fatimati 'l - Zahra* ( përkthim në gjuhën perse ), f. 27, 54, vëll. 11, f. 1 - 10.
6. Farid Vajdi, *Da'irat ul - Ma'arif,* vëll. 6, f. 250.

Madje, nganjëherë, ata shkonin edhe te varrezat[7] dhe numëronin të afërmit e tyre të vdekur, për të provuar se kishte më shumë njerëz në aksh fis sesa në fiset e tjera. Vrasjet, gjakderdhja, pija dhe marrëdhëniet e paligjshme seksuale ishin krejt të zakonshme[8]. Amr ul - Kejs, poeti i famshëm arab shkruante për marrëdhëniet e tij seksuale satanike me kushëririën e tij, Anisa. Të tilla poema renditeshin ndër veprat më të mëdha letrare dhe vareshin në Qabe për t'i lexuar njerëzit [9]. E tillë ishte gjendja dhe morali në një shoqëri të mjerë, nga horizontet e errëta të së cilës erdhi drita e Islamit.

Është e qartë si kristali se një person, që jo vetëm nuk ndikohet nga një shoqëri e tillë e kalbur, por që edhe brengoset për të e përpiqet të luftojë kundër të këqijave të saj, ka karakterin e madh të dhënë nga Zoti dhe është i përshtatshëm dhe i aftë për t'i drejtuar dhe për t'i udhëhequr njerëzit në rrugën e shpëtimit.

## Profetët nuk kanë qenë produkt i mjediseve të tyre: Ata i kanë krijuar mjediset

Të gjithë shkuan tek tempujt e idhujve përveç Profetit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), i cili, pa qenë i mësuar nga askush, u nis për te mali Hira. Ishte mali ku ai adhuronte Krijuesin e universit me devotshmëri dhe lavdëronte Madhështinë dhe Fuqinë e Tij[10]. Allahu thotë në Kur'an: "**Dhe ti** (o Muhamed) **nuk lexove ndonjë libër para tij e as nuk shkrove ndonjë (**libër**) me dorën tënde të djathtë, sepse atëherë, ata që thonë gjëra të pavërteta, do të kishin dyshuar**". (Surja "Ankebut", ajeti 48)

I ndihmuar nga Zoti i Gjithëfuqishëm, Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) e përcaktoi rrugën

7. *Majma'ul - Bayan*, vëll. 10, f. 534 (botim i ri).
8. Dr. Sufi Diyf , *Al - 'Asrul - Jahili* (botimi i pestë në Egjipt), f. 70.
9. Alz - Zuzani, *Sharh ul - Mu'allaqat ul - Saba'a,* f. 3.
10. *Bihar ul - Amrar*, vëll. 18, f. 280.

që në fillim, qortoi sjelljen e gabuar të njerëzve të tij pa asnjë ngurrim e pa asnjë frikë dhe vijoi t'i qortonte këto veprime e besime të gabuara[11]. Ai jo vetëm nuk e kaloi për asnjë çast jetën e tij të bekuar në idhujtari, por siç e përmendëm, ai urrente të dëgjonte emrat e idhujve[12]. Ndershmëria dhe pastërtia e tij njiheshin nga të gjithë. Ndershmëria e tij e jashtëzakonshme i bëri njerëzit ta mbiquanin 'i Besueshmi'.

Virtytet e tij të larta e bënë Hatixhen t'i besonte atij pasurinë tregtare. Sjellja e Profetit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ndaj njerëzve ishte aq e këndshme, sa ai i bënte për vete të gjithë njerëzit. Sjellja e tij ishte, vërtet e shkëlqyer.

Amari thotë: "*Profeti dhe unë ishim pajtuar si barinj përpara se atij t'i zbriste misioni profetik. Një ditë, i thashë të shkonim te kullota Fakh. Ai pranoi. Ditën tjetër unë shkova atje, por pashë se ai kishte shkuar përpara meje. Megjithatë, ai nuk i kishte lënë delet e tij të kullosnin atje. E pyeta përse nuk i kishte çuar delet në Fakh. Ai m'u përgjigj: 'Unë nuk doja që delet e mia të kullosnin këtu përpara deleve të tua sepse ne e kishim lënë me fjalë bashkë t'i çonim njëherësh në kullotë*[13]'".

Pra, Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) kishte sjellje tjetër e jo si njerëzit e tjerë dhe në asnjë mënyrë nuk i pranonte zakonet dhe sjelljet e këqija fisnore. Për të gjitha këto arsye njerëzit e respektonin shumë atë dhe mbështeteshin fort në mendimet e tij për të zgjidhur problemet e tyre.

## Vendosja e Gurit të Zi

Kur Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ishte 30 vjeç, kurejshët vendosën të riparonin Shtëpinë e Zotit, Qaben.

11. *Ibid*, f. 227 - 281; *Nahj ul - Balaghah of Fiydul - Islam*, f. 802.
12. *A'lam Alwari*, f. 17 - 18; *Bihar ul - Anëar*, vëll. 15, f. 410.
13. *Bihar ul - Amrar*, vëll. 16, f. 224.

Meqë të gjitha fiset e kurejshëve donin të kishin nderin e kësaj pune të madhe, secili mori detyrën për të riparuar një pjesë të caktuar të Shtëpisë së Zotit.

Ualidi nisi ta shembte Shtëpinë. Pastaj, të tjerët e ndihmuan, derisa u dukën kolonat që pati vendosur Profeti Ibrahim (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). Tani ishte koha për rindërtimin e Shtëpisë së Shenjtë. Edhe për këtë punë secili fis mori pjesën që i takonte. Kur rindërtimi mbërriti aty ku do të vendosej Guri i Shenjtë, lindën diskutime të ashpra ndërmjet fiveve kurejshe. Secili prej tyre donte të kishte nderin ta vendoste vetë i pari Gurin e Zi. Ca nga ca polemika u kthye në armiqësi të rreptë dhe fiset u bënë gati për luftë të përgjakshme. Djemtë e Abdul Darit mbushën një poçe të madhe me gjak dhe i zhytën duart në të, çka do të thoshte se zotoheshin të vdisnin në fushën e betejës.

Mosmarrëveshja e tmerrshme vazhdoi për katër a pesë ditë derisa Ebu Ameje, i cili ishte më i vjetri i kurejshëve tha: "*Propozimi im është që të zgjedhim si arbitër njeriun e parë që do të hyjë në xhami dhe të gjithë ne ta pranojmë mendimin e tij për këtë problem*". Kurejshët e pranuan propozimin e tij dhe pritën të shihnin kush do të ishte ai që do të hynte i pari në xhami. Papritur, i pari në xhami hyri Profeti i Islamit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). Sapo ua zuri syri Profetin (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), ata thanë: "*Ky është i Besueshmi. Ky është Muhamedi. Ne do ta pranojmë vendimin e tij*".

Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) nuk dinte gjë për këtë çështje. Kur ia shpjeguan problemin, ai tha: "*Më sillni një copë pëlhurë*". Megjithëse kurejshët nuk dinin se ç'kishte ndër mend të bënte ai me këtë urdhër, ata ia prunë pëlhurën menjëherë. Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) e hapi pëlhurën, vuri Gurin e Zi në mes të saj dhe tha: "Çdo fis ta kapë në një cep pëlhurën e kështu, të gjithë mund të marrin pjesë në këtë nderim".

Kurejshët bënë siç tha ai dhe e ngritën Gurin e Zi dhe e çuan atje ku do të vihej. Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) vuri re se po ta lejonte ndonjërin prej tyre ta vinte Gurin e Zi në vend, konflikti dhe polemikat do të ndizeshin përsëri. Për këtë arsye e ngriti vetë Gurin e Zi dhe e vuri në vend. Me këtë zgjidhje të shkëlqyer ai u dha fund armiqësisë dhe konflikteve të tmershme[14]. Kjo ndodhí shpërfaq qartë karakterin e lartë të Profetit të Islamit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) dhe mendjen e inteligjencën e tij të shkëlqyer, që e mbylli një polemikë të ashpër pa gjakderdhje.



14. *Sirihi ibn Hisham*, vëll. 1, f. 192 - 197; *Bihar ul - Anwar*, vëll. 15, f. 337, 412.

**Ali Kaja**

# Zgjerimi i universit dhe shpërthimi i madh (big bengu) Vështrim kur'anor[1]

## Abstrakt

*Një numër gjithnjë në rritje i kërkimeve shkencore mbështetnin zbulimet e Habëllit, i cili i shpalli rezultatet e tij përfundimtare të vëzhgimeve në vitin 1929. Ideja e një universi që zgjerohet u bë një realitet i pamohueshëm. Nëse universi zgjerohej, atëherë, ai duhet të ketë qenë më i vogël në të kaluarën dhe madje, mund të ketë qenë një çast kur i gjithë universi të jetë dukur si një masë e vockël. Modeli Big Beng është natyrisht brenda teorisë së përgjithshme të relativitetit. Sipas modelit të Big Bengut, universi është zgjeruar vazhdimisht qëkur ai ka lindur. Sipas këtij modeli, universi lindi në një formë shumë të nxehtë dhe shumë të dendur rreth 13.7 bilionë vjet më parë. Në periudha të hershme nxehtësia ka qenë aq e lartë, sa që në plazmë u krijua lëndë - nga përbërësit më të vegjël të saj (materies). Ndërkohë që nxehtësia pakësohej, edhe plazma ndryshonte strukturë dhe ndodhnin faza të ndryshme kozmike. Kur'ani i referohet hapur zgjerimit të universit. Ajeti 47 i sures 51 (Dharijat) thotë si më poshtë: **"Dhe Ne, me Fuqinë Tonë e ngritëm qiellin dhe Ne e zgjerojmë atë."*** (51:47)

Pasi Habëlli (Hubble) shpalli rezultatet e tij përfundimtare të vëzhgimeve në vitin 1929, mendimi i fizikanëve për universin filloi të ndryshonte plotësisht.

1. Marrë nga "THE FOUNTAIN" (ISSUE 88), 2012, 345 Clifton Ave., Clifton, NJ, 07011, USA. A MAGAZINE OF SCIENTIFIC AND SPIRITUAL THOUGHT.

Në fakt, para se Habëlli të publikonte zbulimet e tij, Fridmani (Friedmann), i cili pati përdorur ekuacionet e paraqitura nga Ajnshtajni (Einstein) më 1916, deklaroi në vitin 1922 me studimin e tij se universi duhet të jetë në zgjerim e sipër. Sidoqoftë, në ato kohë - kryesisht për arsye filozofike - njerëzit e përfytyronin universin të palëvizshëm (statik). Prandaj, Ajnshtajni, i cili ishte shqetësuar për faktin që ekuacionet e tij të para kishin sjellë idenë e një universi në lëvizje (dinamik), bëri një ndryshim në ekuacionet e tij, që të kishte një model të universit të palëvizshëm. Pas vëzhgimeve të Habëllit, Ajnshtajni deklaroi se ndryshimin që bëri, e konsideronte gabimin më të madh të karrierës së tij. Kështu, të dhënat e zbuluara pas vëzhgimeve të Habëllit sollën habi të madhe dhe emocion të madh. Ndërkohë, meqë një numër gjithnjë në rritje i kërkimeve shkencore mbështetnin zbulimet e Habëllit, ideja e një universi që zgjerohet u bë një realitet i pamohueshëm.

Nëse universi zgjerohej, atëherë, ai duhet të ketë qenë më i vogël në të kaluarën dhe madje, mund të ketë qenë një çast kur i gjithë universi të jetë dukur si një masë e vockël. Një grup fizikanësh që i mori seriozisht këto zbulime, nisi kërkimet teorike në lidhje me lindjen e universit (domethënë, hapësirën dhe kohën dhe të gjithë materien brenda tij) dhe evolucionin e tij. Një grup tjetër fizikanësh ende mendonte se universi nuk duhej të kishte asnjë fillim dhe ngulmonte në konceptin e tij për një univers të palëvizshëm. Një nga këta fizikanë, Hojli (Hoyle) bëri një deklaratë gjatë një programi në radion BBC (Bibisi), ku kritikoi idenë e një universi që zgjerohej dhe përdori për herë të parë frazën «big bang». Më pas, fraza, e cila u përdor në fillim me sarkazëm, nisi të përdorej si emërtimi i modelit të universit që zgjerohet. Ai ishte një model tërësisht i ri, të cilin asnjë shkencëtar as nuk e kishte imagjinuar më parë. Atëherë, duhej të kishte rrezatim elektromagnetik (rrezatim të sfondit të mikrovalëve kozmike), i cili do të

shfaqej pas shpërthimit - kjo mund të krahasohet me tymin e një arme fill pas shkrehjes. Pasi Penziësi (Penzias) dhe Uillsoni (Wilson) e vrojtuan këtë rrezatim elektromagnetik në vitin 1964, dyshimet për modelin u zhdukën pothuajse plotësisht. Ndërkohë që teknologjia u zhvillua, u bënë kaq shumë vrojtime të ndryshme dhe u morën kaq shumë masa të ndryshme në mbështetje të kësaj teorie. Meqë nuk ka model tjetër kozmik për të shpjeguar të dhënat e tanishme, Big Bengu është pranuar nga të gjithë fizikanët sot. Ne do të donim të sillnin disa fakte për universin, që mbështeten në vrojtime dhe teori bashkëkohore përpara se të shpalosim diskutimin tonë.

## Çfarë dimë për universin

Galaktikat janë formacione tipike në të gjithë universin. Galaktika e Rrugës së Qumështit, e cila mban sistemin tonë diellor, është në trajtë disku. Matjet kanë zbuluar se diametri i këtij "disku" është 100.000 vjet-dritë dhe trashësia e tij është 1000 vjet-dritë (një vit-dritë është afërsisht dhjetë trilionë kilometra). Ka afro 100 bilionë yje të tjera në galaktikën e Rrugës së Qumështit që janë të ngjashme me Diellin tonë.

Në saje të tëheqjes së rëndesës (gravitacionale), denduria e numrit të yjeve pranë qendrës së galaktikës është më e lartë - për të njëjtën arsye, vrimat e zeza mendohet se ekzistojnë në qendrat e galaktikave. Yjet që duken me sy të lirë natën janë brenda galaktikës së Rrugës së Qumështit. Kur vrojtohen largësi të mëtejme me anë të teleskopëve, fillojnë të shihen galaktika të tjera si njolla të ndritshme.

Galaktikat formojnë tufa galaktikash. Këto tufa galaktikash formojnë tufa mbigalaktike. Edhe viti-dritë del se është një njësi e parëndësishme matjeje për të shprehur këto largësi të mëdha marramendëse. Modeli më i suksesshëm që njohim ne, i cili e përshkruan universin, është teoria e relativitetit të Ajnshtajnit.

Sipas kësaj teorie, hapësirë - koha është objekt dinamik dhe ai mund të jetë i lakuar. Sa për forcën, që ne e konsiderojmë si forca e rëndesës, ajo është rezultat i natyrës së lakuar të hapësirë - kohës. Modeli Big Beng është natyrisht brenda teorisë së përgjithshme të relativitetit. Të dhënat thelbësore që do të paraqitim këtu për universin, mbeshteten më së shumti në vrojtime dhe në teorinë e përgjithshme të relativitetit.

Sipas modelit Big Beng, universi lindi në një formë shumë të nxehtë dhe shumë të dendur rreth 13.7 bilionë vjet më parë. Këtu, na duhet të kujtojmë se konceptet "kohë" dhe "hapësirë", siç dihet, kanë ardhur bashkë me Big Bengun. Prandaj, të pyesësh se çfarë ka qenë përpara Big Bengut, është e pakuptimtë për këtë model. Po kështu, nocioni i përgjithshëm i zgjerimit na sjell në mendje diçka që zgjerohet brenda diçkaje tjetër. Sidoqoftë, është e mundur të përshkruhet universi pa nocionet e zgjerimit të brendshëm ose të jashtëm. Kjo do të thotë se ne nuk duhet të supozojmë një mjedis tjetër, brenda të cilit universi zgjerohet. Një nga mendimet e rëndësishme të modelit Big Beng është fakti se universi ka qenë në ekuilibër termal në të kaluarën. Ka të dhëna të rëndësishme që bazohen në vrojtime, të cilat e mbështesin këtë mendim. Prandaj, madje, edhe termi Big Beng të sjell në mendje një ndodhi kaotike: Ka qenë një ekuilibër shumë i rëndësishëm kur është krijuar universi. Dhe, shumë fizikanë kanë nënvizuar faktin se ky ekuilibër nuk mund të ndodhte vetvetiu. Universi ynë ka lindur nga një gjendje shumë e nxehtë dhe shumë e dendur ekuilibri dhe pastaj ka filluar të ftohej, ndërkohë që zgjerohej.

Në periudha të hershme nxehtësia ka qenë aq e lartë, sa që në plazmë u krijua lëndë - nga përbërsit më të vegjël të saj (materies). Ndërkohë që nxehtësia pakësohej, edhe plazma ndryshonte strukturë dhe ndodhnin faza të ndryshme kozmike. Për shembull, kur nxehtësia ra deri në $10^{10}$ gradë C, bërthama atomike filloi të formohej nga

neutronet dhe protonet. Kur nxehtësia ra deri në 3000 gradë C, u formuan atomet. Ka shumë vrojtime që i mbështesin këto faza të ndryshme. Për shembull, rrezatimi i fushës elektromagnetike, i vrojtuar nga Penziwsi dhe Uillsoni më 1964, është formuar nga fotonet (domethënë, drita), të çliruara pas fazës, në të cilën u formuan atomet e para.

Modeli i Big Bengut ka kaq shumë detaje më të rëndësishme dhe përllogaritjet e bëra sipas këtij modeli kanë qenë në pajtim me këto vëzhgime. Bashkë me të duhet të shënohet se ndërkohë që fizika e njohur i afrohet çastit të Bengut (kohës zero), ajo e humbet vlefshmërinë dhe prandaj, nevojiten teori të reja.

## Zgjerimi i universit në Kur'an

Kur'ani i referohet hapur zgjerimit të universit. Ajeti 47 i sures 51 (Dharijat) thotë si më poshtë: "**Dhe Ne, me Fuqinë Tonë e ngritëm qiellin dhe Ne e zgjerojmë atë**." (51 : 47)

Fjala origjinale arabe, që i referohet zgjerimit është "*musiun*". Interesante është se kemi të bëjmë me një fjali emërore, e cila në gramatikën arabe tregon një cilësi të qëndrueshme dhe të vazhdueshme. Prandaj, kuptimi mund të jetë: "Ne jemi duke e zgjeruar atë vazhdimisht." Sipas modelit të Big Bengut, universi është zgjeruar vazhdimisht qëkur ai ka lindur. Duke e shprehur këtë fakt me thënien "Ne jemi duke e zgjeruar atë", Kur'ani na udhëzon, gjithashtu që të pranojmë se zgjerimi nuk ndodh vetvetiu, por me Fuqinë e Zotit.

## Ajete të tjera që lidhen me Big Bengun

Ajeti 30 i sures 21 (Enbija) thotë si më poshtë: "**A nuk besojnë ata se qiejt dhe Toka ishin ngjitur dhe Ne i ndamë dhe ujin e bëmë bazë të jetës së çdo gjallese? A ende nuk besojnë ata**?"(Enbija 30)

Sipas disa dijetarëve të komentimit të Kur'anit, fjala *ratk* (ngjitur, njësh) dhe *fataknahuma* (Ne i ndamë ) mund të aludohen për çastin e Big Bengut. Siç jemi përpjekur ta shpjegojmë shkurtimisht më sipër, i gjithë universi ishte një dhe masë e vetme e shumë e vogël dhe pastaj filloi të zgjerohet dhe të rritet. Meqë u zgjerua universi, edhe materia që përmbante ai, filloi të zgjerohet dhe të zërë një vëllim të madh. Meqë universi u zgjerua, edhe përmbajtjet e tij filluan të ndahen nga njëra - tjetra.

Kështu, fjalët e mësipërme arabe mund të aludojnë për këtë zinxhir ngjarjesh. Bashkë me të, disa dijetarë janë të mendimit se ky ajet aludon për formimin e sistemit diellor, të Tokës dhe të atmosferës së saj. Arsyeja është se ajeti vazhdon të përmendë krijimin e qenieve të gjalla. Sipas kësaj, *ratk* mund t'i referohet fazës kur sistemi diellor ka qenë një masë e vetme dhe *fataknahuma* mund t'u referohet planetëve dhe Tokës që shkëputen nga Dielli dhe formimit të atmosferës. Duhet theksuar se sistemet që formohen brenda galaktikave hyjnë, gjithashtu, në modelin e Big Bengut, i cili përdoret për t'iu referuar të gjitha fazave, nga koha zero deri në kohën tonë. Prandaj, të dyja shpjegimet e mundshme mund të lidhen me këtë model.

Një fjalë tjetër që mund të lidhet me Big Bengun është "Krijuesi (*Fatir*) i qiejve dhe i Tokës", që përdoret në shumë ajete (p.sh., Jusuf 101). Është edhe një ajet tjetër që e shpreh këtë realitet me një folje nga e njëjta rrënjë (*fatarahunna*): "… **Zoti juaj është Zoti i qiejve dhe i Tokës, është Ai i Cili i ka krijuar qiejt dhe Tokën**." (Enbija : 56). Normalisht, fjala "fatara" përkthehet "krijoi". Në studimin e tij për komentimin e Kur'anit, Hamdi Jazir (1877 - 1942) thekson faktin se rrënja "fatara" do të thotë "ndaj" ose "ndaj për së gjati" dhe "e krijoj diçka për herë të parë, pa një model të mëparshëm".

Po të merren në konsideratë këto kuptime të "fatara", atëherë "Krijimi i qiejve dhe i Tokës" mund të jetë një

aluzion për Big Bengun. Le të kujtojmë faktin se Big Bengu i referohet veçanërisht pikërisht çastit të krijimit të parë. Prandaj, kuptimi "krijoj diçka për herë të parë, pa një model të mëparshëm" mund t'i referohet kësaj gjendjeje dhe kësaj cilësie të Big Bengut. Përveç kësaj, fjala "fatara" (ndaj) e shënon çastin e këtij shpërthimi të madh më mirë se fjala "beng". Dhe kështu, fillimi i kohë - hapësirës mund të krahasohet me ndarjen e një fare dhe mbirjen e saj.

Një nga kuptimet alternative të "fatara", që përmendet nga Jaziri, "ndaj për së gjati" është shumë interesant. Një nga keqkonceptimet e mëdha për Big Bengun është ta imagjinosh se universi ka lindur në një vend të caktuar dhe ka filluar të zgjerohet brenda hapësirës tjetër. Jo. Big Bengu nuk ka ndodhur në një vend të vetëm. Sot, sipas konceptimit tonë teorik, e gjithë hapësira është krijuar e tëra në një çast të vetëm. Me fjalë të tjera, Big Bengu ka ndodhur kudo. Kuptimi "ndaj për së gjati" mund të jetë një aludim për faktin se Big Bengu nuk ka ndodhur në një pikë të vetme.

## Përfundim

Ajetet kur'anore që kanë të bëjnë me krijimin e universit janë, vërtet një mrekulli. Sigurisht, tema mund të shqyrtohet në aspekte të ndryshme. Për shembull, mund të mendohet për një lidhje ndërmjet frazës "shtatë qiejt", që përdoret në shumë ajete në Kur'an dhe fazave të ndryshme pas Big Bengut (megjithëse është e pamundur të gjendet numri i saktë i këtyre fazave, ngaqë shifrat, si shtatë ose shtatëdhjetë përdoren në mënyrë metaforike në arabisht për t'iu referuar diçkaje që është në numër të madh ose në sasi të madhe). Ato mund t'u referohen edhe përmasave plotësuese, që sugjerohen nga teori të caktuara. Për shembull, Teoria e Zinxhirit (The String Theory), një nga teoritë më të studiuara në vitet e fundit, flet për ekzistencën e shtatë përmasave plotësuese.

Së fundi, do të donim të nënvizonim se ky artikull është një përpjekje fillestare. Ajo që duhet të bëhet më seriozisht është të formohet një këshill dijetarësh, veçanërisht nga fushat e kozmologjisë dhe të komentimit të Kur›anit dhe të vlerësohen sistematikisht të gjitha ajetet që lidhen me temën dhe pastaj, të përpiqemi t›i analizojmë dhe t›i kuptojmë ato pa opinione të njëanshme. Një studim i tillë mund të na ndihmojë të depërtojmë më thellë në mesazhin e Kur›anit.

**Xhemal Abdel Naser**

# Ylli që shpon errësirën dhe vrimat e zeza

## Abstrakt

*Në fillim të sures "Tarik", i Gjithëfuqishmi thotë:* ***"Pafsha qiellin dhe për vizitorin e natës! E kush mund të ta shpjegojë ty se ç'është vizitori i natës? Ai është ylli që shpon terrin."*** (86: 1-3) *Një nga argumentet shkencore që përmenden në Kur'an është ylli që shpon errësirën. Është ylli, i cili ka dy karakteristika të rëndësishme: është një yll i mprehtë shpues dhe troket aq fort, sa krijon tingullin. Ajeti i mësipërm e përshkruan këtë dukuri si ylli shpues i errësirës dhe ky është përshkrim më i saktë, sepse* ***ylli vetë qëndron pa lëvizur, i kondensuar, çka sjell ekzistencën e kësaj hapësire të zbrazët, të quajtur vrimë e zezë.***

Kur'ani është fjala e Zotit. I Plotfuqishmi ia shpalli atë Profetit të Tij të fundit për njerëzimin. Kur profetët ishin duke ftuar popullin e tyre drejt së Vërtetës, Allahu i pajisi ato me mrekulli për të bindur njerëzit e tyre. Moisiu dallohej për prishjen e magjive të magjistarëve të kohës së Faraonit. Ai i habiti magjistarët në Egjiptin e lashtë. Isait iu dha një mrekulli për mjekësinë. Ai i kuroi njerëzit nga sëmundje të pashërueshme. Të vetmit njerëz të cilët mund t'i shihnin këto mrekulli, ishin ata që ishin të pranishëm atje. Profeti Muhamed ishte profeti i fundit, mrekullia e të cilit duhej të ishte e vazhdueshme dhe e pavdekshme. Kjo mrekulli e pavdekshme është vetë Kur'ani.

Në kohën e zbulimit të Kur'anit, arabët ishin të shquar në poezi dhe në prozë, kështu që Kur'ani i sfidoi ata me elokuencën e tij. Tashmë, mrekullitë e Kur'anit u shfaqën në dëshmitë shkencore të përmendura në shumë ajete. Këto

ajete dëshmojnë për faktet shkencore që kanë qenë zbuluar vetëm para pak dekadave, kështu pra, njerëzimi duhet ta dijë se Kur'ani është fjala e Allahut.

Një nga dëshmitë shkencore të përmendura në Kur'an është ylli që shpon errësirën.[1]

I Gjithëfuqishmi, në fillim të sures "Tarik", thotë: ***"Pafsha qiellin dhe për vizitorin e natës! E kush mund të ta shpjegojë ty se ç'është vizitori i natës? Ai është ylli që shpon terrin." (***86: 1-3)

Këto ajete flasin rreth një ylli, i cili ka dy karakteristika të rëndësishme. E para, është se ai është një yll i mprehtë shpues dhe tjetra është se ai troket aq fort, sa krijon një tingull. Allahu në këto ajete e shoqëroi betimin e Tij nga qielli duke marrë parasysh madhështinë e saj me yllin shpues të territ, që do të thotë se ekziston një lidhje mes tyre. Çështja tani është se çfarë tregojnë këto ajete për vrimat e zeza?

Vrimat e zeza janë dukuria më e dhunshme dhe më misterioze në qiell. Vrimat e zeza janë pikat fundore të një procesi zhvillues të yjeve të paktën 10 deri 15 herë më masive se Dielli.

Nëse një yll kaq i madh pëson një shpërthim "Supernova", ai mund të lërë prapa një mbetje yjore të djegur mjaft masive. Duke mos patur forca të jashtme për t'u kundërvënë me forcat gravitacionale, mbetja e tij do të shkatërrohet në vetvete. Ylli përfundimisht bie në pikën e vëllimit zero dhe me densitet infinit, duke krijuar atë që është njohur si një "tipar i veçantë". Fusha e rëndesës është aq e fuqishme, sa që asgjë, duke përfshirë edhe dritën, nuk mund t›i shpëtojë tërheqjes së saj. Vrima e zezë ka një sipërfaqe të njëanshme, që quhet *ngjarje horizonti* (kufiri i një vrime të zezë), ku mund të bien objekte, por që asgjë nuk mund të dalë jashtë. Me anë të kësaj ne mund të sqarojmë një çështje shumë të rëndësishme, **e cila shkakton pështjellim te shumë njerëz**, sepse duhet dalluar kufiri i

1. Dr. Zagloul El-Naggar 2001. Al-Ahram 12, 14 (6, 20/8/2001).

ngjarjes së horizontit te vrima e zezë.

Nëse dielli bëhet një vrimë e zezë, ai do të ketë një kufi *ngjarje horizonti* me rreze rreth 3 kilometra, por e gjithë materia e saj do të kondensohet në një pikë në qendër të vrimës së zezë.

(Relativiteti i përgjithshëm përshkruan një vrimë të zezë si një rajon të hapësirës bosh me një pikë si tipar i veçantë në qendër dhe një Event Horizon (***ngjarje horizonti***) në skajin e jashtëm).[2]

Ylli shpues i errësirës përshkruan përmbajtjen lëndore të yllit të kondensuar në veçanti (tipar të veçantë) dhe vrimën e hapësirës boshe të shkaktuar nga ky material lëndor i kondensuar.

## Ajeti tregon për vrimat e zeza

Ajeti e përshkruan këtë dukuri si *ylli shpues i errësirës.* Ky është përshkrim më i saktë, sepse materia e yllit, e cila është kondensuar në tipar të veçantë, është arsyeja e formimit të vrimës së zezë. **Pra, ylli vetë qëndron pa lëvizur, i kondensuar, çka shkakton *vrimën e zezë*.**

Kur ju e përshkruani këtë dukuri si një vrimë të zezë, ju në të vërtetë, jeni duke përshkruar vetëm një hapësirë të zbrazët. Në qoftë se ju e përshkruani atë si yll shpues i errësirës, atëherë ju jeni duke e përshkruar materien lëndore të yllit të kondensuar në veçanti dhe vrimën e hapësirës boshe të shkaktuar nga kjo materie lëndore.

## Llojet e vrimave të zeza

Ka dy lloje kryesore të vrimave të zeza: E para është vrima e zezë yjore dhe e dyta është, në të vërtetë, fenomeni më i gjerë dhe më i madh në qiell, vrima e zezë supermasive.

2. http://www.physics.hku.hk/ ~ nature/CD/regular_e/lectures/chap17.html

Kjo konfirmon për ne se pse betimi i yllit tejshpues të errësirës në Kur'an është mjaft i madh për të shoqëruar betimin e qiejve lidhur me madhështinë e saj.

## Karakteristikat e vrimave të zeza supermasive

Tipari më i rëndësishëm i vrimës së zezë supermasive është masa e saj që i tejkalon të gjitha kufijtë e imagjinatës. Masa e vrimave të zeza yjore mund të arrijë sa 30 herë e masës diellore. Masa e një vrim të zezë supermasive mund të arrijë në 10 miliard herë sa masa diellore. Ajo është formuar gjithashtu, si pasojë e shembjes apo e shkatërrimit të materies lëndore të yllit supermasiv në fillim të formimit të galaktikave, kështu **që ylli shpues i errësirës që është kondensuar në një vëllim të vogël duke shkaktuar këtë vrimë të zezë supermasive është quajtur si ylli më masiv në univers.**[3]

## Historia fillon me kuazarët (quasi-stellar radio source /Quasar/)

Shkencëtarëve u është dashur një kohë e gjatë për të zbuluar vrimat e zeza super të mëdha dhe fillimi qe zbulimi i kuazarëve. Një objekt i ngjashëm me yjet që mund të dërgojë radiovalë dhe forma të tjera energjie është një bërthamë galaktike e fuqishme, aktive e energjetike e largët.

Kuazarët më ndriçues rrezatojnë me një normë që mund ta tejkalojë atë të galaktikave mesatare, e barabartë me një trilion diej. Ndërkohë, shkencëtarët kanë pyetur veten se si një kuazar prodhon shkëlqim drite të tillë, të jashtëzakonshëm, pavarësisht largësisë prej nesh, e cila arrin miliarda vjet-dritë. Përgjigjja erdhi nga gjëja më e dhunshme në qiell, që është vrima e zezë supermasive. Shkëlqimi i jashtëzakonshëm i dritës së kuazarëve vjen nga

3. http://en.wikipedia.org/ëiki/Supermassive_black_hole

disqet në rritje të gropës së zezë supermasive qendrore.

Disqet mund të konvertojnë deri në 10% masën e një objekti në energji, në krahasim me 0.7% për procesin zinxhir bërthamor të bashkimit proton-proton, që mbizotëron prodhimin e energjisë në yjet e ngjashëm me Diellin.[4]

## Përplasjet kozmike vijnë si rezultat i vrimave të zeza supermasive

Ajetet e përmendura: *"**Për qiellin dhe për vizitorin e natës! E kush mund të ta shpjegojë ty se ç'është vizitori i natës? Ai është ylli që shpon terrin.**"* (86: 1-3) deklarojnë se ylli që shpon errësirën, për të cilin kemi shpjeguar lidhjen e tij me vrimat e zeza supermasive, ka një tjetër tipar të rëndësishëm siç e emërtojnë ajetet e sures "Tarik" (trokitësi). Si ndodh që përplasen ylli që shpon errësirën e natës me dritë me vrimën supermasive të zezë?

Pjesa e materies lëndore të diskut supermasiv rrotullues (të vrimës së zezë) është gati të bjerë në vrimën e zezë supermasive. Kjo riemetohet si rrymë jashtëzakonisht e fuqishme relativiste, e cila rrjedh nga objekte masive në qendër të disa galaktikave aktive.

Këto galaktika aktive janë rryma të gazta binjake, jashtëzakonisht të fuqishme të joneve pozitive dhe elektroneve pa ngarkesë. Këto lëshohen përgjatë boshtit të rrotullimit të diskut të vrimës së zezë, me shpejtësi që i afrohet asaj të dritës. Kjo rrymë e furishme përplas dhe godet ashpër gjithçka në rrugën e saj deri në largësi të mëdha.

Për shkak të lëvizjes së kësaj rryme të gaztë me jone pozitive dhe elektrone të lira ajo përplaset me mjediset ndëryjore dhe intergalaktike duke prodhuar valë të vërteta zanore. Një rrymë e vërtetë e gaztë e joneve pozitive

4. http://imagine.gsfc.nasa.gov/docs/science/knoë_l1/active_galaxies.html

dhe elektroneve të lira prodhuar nga një vrimë e zezë supermasive në galaktikë (M87) është regjistruar nga teleskopi hapësinor Hubel. Ajo godet gjithçka në rrugën e saj për një largësi prej 5000 vitesh drite.

Më 9 shtator 2003, astronomët, duke përdorur Observatorin Chandra me rreze X të NASA-s , kanë kapur, për herë të parë, valë zanore nga një vrimë e zezë supermasive.

Kjo vrimë e zezë supermasive qëndron në grumbullin e galaktikave të Perseut, të vendosura 250 milion vjet-dritë larg nga Toka.

### Valët zanore, zbrazëtitë, vrima e zezë[5]

## Valët e vërteta zanore, të cilat rezultojnë nga përplasja e rrymave në mjediset intergalaktike

Tani imagjinoni se sa e madhe është mrekullia në ajete. Ylli shpues i errësirës dhe vrima e zezë supermasive përplasin mjedisin intergalaktik me rryma të fuqishme relativiste dhe si rezultat i kësaj përplasjeje formohet tingulli/zëri i vërtetë.

***"Pafsha qiellin dhe yllin ndriçues (të natës). E ku e di ti se çka është Tariku- trokitësi? Ai është Ylli që shpon (errësirën me dritë)."*** (86:1-3)

## Ylli i mprehtë që shpon errësirën dhe qielli

Allahu në këto ajete shoqëron betimin e Tij nga qiejtë lidhur me madhështinë e Tij për yllin e mprehtë ndriçues, që do të thotë se ka një marrëdhënie themelore mes këtij lloji të yjeve dhe gjithçkaje që ne shohim në qiell nga yjet dhe galaktikat.

5.http://science.nasa.gov/headlines/y2003/09sep_blackholesounds.htm

## Ylli që shpon errësirën është në thelbin e të gjitha galaktikave.

Kuazaret dhe vrimat e zeza supermasive të lidhura kanë qenë të shoqëruara me një lloj të galaktikave, të quajtura *galaktika aktive*, por lloji tjetër i galaktikave, të quajtura *galaktikat joaktive,* ku përfshihet galaktika jonë, *Rruga e Qumështit*, mendohet se nuk kanë vrima të zeza supermasive në bërthamat e tyre. Prej dy dekadash, shkencëtarët kanë gjetur një metodë për të përcaktuar ekzistencën e vrimës së zezë supermasive duke përcaktuar shpejtësitë e yjeve të afërta me bërthamat galaktike. Ata u befasuan kur gjetën një vrimë të zezë supermasive në të gjitha galaktikat.

Çfarë ka mbetur, është që të mësojmë nëse ka një vrimë të zezë supermasive në galaktikën tonë *Rruga e Qumështit* apo jo. Në vitin 2003, astrofizikani amerikan Andrea Ghez dhe puna ekipore e tij (UCLA), duke përdorur teknika të larta të imazheve me rezolucion hapësinor ka konfirmuar ekzistencën e një vrime të zezë supermasive në galaktikën tonë.[6]

Imazhi tani është i plotë dhe çdo galaksi e ka vrimën e saj të zezë supermasive, por pse ka galaktika aktive dhe joaktive? Përgjigja e kësaj pyetje lidhet me zhvillimin e galaktikave.

**Në çdo galaktikë ndodhet një vrimë e zezë supermasive.**

## Vrima e zezë supermasive dhe lindja e galaktikave

Shkencëtarët kanë gjetur një lidhje midis shpejtësisë së yjeve në skajet e galaktikave dhe masës së vrimave të zeza supermasive në qendër të këtyre galaktikave. Distancat në mes tyre janë shumë të mëdha. Kjo lidhje është formuar në

6. http://www.astro.ucla.edu/ ~ ghezgroup / GC / index.shtml Univers By: Chem. Gamal Abdel Nasser-

një kohë të mëparshme, në kohën e lindjes së galaktikës, pasi mendohet se galaktikat janë formuar kur një re e madhe e gaztë është shembur në qendrën e saj duke formuar një vrimë të zezë supermasive, e cila filloi të ushqente gazin në afërsi duke formuar një kuazar.

Ky kuazar shkakton formimin e yjeve të rinj në galaktikën e tërë, kështu që formohet një galaktikë e re aktive, por me kalimin e kohës, gazi fillon të largohet nga vrima e zezë supermasive, kështu që nuk ka asgjë për të ushqyer dhe galaktika aktive shndërrohet në joaktive.

Pra, shkenca sot, bën një lidhje mes yllit të mprehtë që shpon errësirën dhe gjithaçkaje që shohim në qiell që nga yjet deri tek galaktikat. Për këtë arsye Allahu në këto ajete lidh betimin e Tij me qiellin në lidhje me madhështinë e Tij me yllin që shpon errësirën, që do të thotë se ka një marrëdhënie themelore mes këtij lloji të yjeve dhe të gjithçkaje që ne shohim në qiell nga yjet deri tek galaktikat.

**Musavij Lari**

# Besimi në pavdekshmërinë

## Abstrakt

*Islami e vë në lëvizje shpirtin e njeriut drejt së përjetshmes. Besimi në Ringjallje është i vërtetë dhe jetësor. Ai vitalizon aftësitë e njeriut për të përmbushur idealet e tij sublime. Ai nuk e kufizon njeriun te kënaqësia e bujarisë së kësaj bote. Por njeriu e kufizon veten dhe i ndjek kënaqësitë në mënyrë të disiplinuar. Ai kundërshton grykësinë, duke ia nënshtruar atë kontrollit dhe përmbajtjes. Një njeri me besim e di se mirësitë e jetes janë mjete për të arritur qëllime shumë të larta. Nuk është qëllimi i vetë jetës, në kërkim të së cilës njeriu duhet të shpenzojë të gjitha fuqitë e tij dhe për më tepër, të humbasë ekuilibrin e tij shpirtëror.*

Islami vë në lëvizje shpirtin e njeriut drejt së përjetshmes. Megjithëse, besimi në ringjallje është një besim i vërtetë dhe jetësor që e ngre njeriun mbi planin e arsyeshëm dhe vitalizon aftësitë e tij për përmbushjen e idealeve njerëzore sublime, ai nuk e kufizon njeriun nga kënaqësia e bujarisë së botës. Por ai e kufizon veten nga ndjekja e këtyre qejfeve në një mënyrë të disiplinuar, kundërshton grykësinë kokëforte dhe pangopësinë duke ia nënshtruar atë kontrollit dhe përmbajtjes.

Kur një njeri është vërtet i bindur se bota ofron mundësi të kufizuara dhe të pamjaftueshme, se qejfet e saj janë të parëndësishme dhe se ditëve të saj të shkurtra u mungon adhurimi dhe kënaqësia e vërtetë, atëherë shijimi i kësaj bote humbet shkëlqimin dhe joshjen e magjishme të saj në sytë e tij. Kështu atij nuk i vjen keq nëse dështon të marrë më shumë sesa i bie të marrë për pjesën e vet, nuk i nënshtrohet

ankthit, brengës dhe frikës. Qëndrimi i tij ndaj përfitimeve materiale nuk është ashtu si dikush që është në nxitim dhe tundim të përhershëm, si rezultat i frikës se mos vdekja një ditë do t'i jap fund ndjekjes së gëzimeve. Më saktë, ai zotëron një paqe të mendjes dhe një qetësi të vetëdijes. Ky besim dhe kjo gjakftohtësi pa dyshim që i shton kënaqësi që ai i merr nga bujaria dhe dhuratat e jetës, të cilat i përdor me racionalizëm dhe me dinjitet. Prandaj, në përputhje me rrethanat, një njeri me besim e di se këto dhurata dhe kjo bujari janë mjete për të arritur në qëllime më të larta. Nuk është qëllimi i vetë jetës në kërkim të së cilës njeriu duhet të shpenzojë të gjithë fuqitë e tij dhe për më tepër, të humbasë ekuilibrin e tij shpirtëror.

Streset e shkaktuara nga ankthi, gjithashtu çojnë në sëmundje fizike dhe në humbjen e forcës dhe të energjive fizike. Në mënyrë që të mbrojmë shëndetin fizik të njeriut, si dhe mirëqenien dhe të shpëtojmë një njeri nga ndikimi i forcave vetëshkatërruese që ndodhen në brendësi të tij, njeriu nuk duhet ta lejojë ankthin dhe brengën ta pushtojë shpirtin e tij.

Imam Aliu ka thënë:

*"Hidhërimi dhe ankthi apo shqetësimi kanë një efekt shkatërrues mbi trupin e njeriut."*[1]

*"Hidhërimi dhe agonia kanë efekt gërryes te trupi i njeriut."*[2]

*"Mbaroje (jepi fund) hidhërimit dhe mërisë tënde, pasi ajo është pija më e ëmbël dhe më e këndshme nga pikëpamja e rezultatit dhe e përfundimit final."*[3]

Kërkimet shkencore kanë zbuluar se disa sëmundje fizike janë pasoja dhe efekte të anktheve, të çrregullimeve psikike apo të shpërthimeve emocionale.

Psikologu i njohur, Man, shkruan:

*"Disa nga shoqëruesit psikologjikë të emocionit - tronditjes janë evidente në eksperiencat e çdo dite.*

1. Al- Amidi, *Ghurar al-Hikam*, f.23.
2. *Ibid*, f.16
3. *Ibid*, f.351

*Rrahjet e zemrës dhe dridhërimat e saj, frymëmarrje e shpeshtuar, intensive, dridhjet dhe shumë fenomene të tjera të organizmit, janë raportuar si aspekte të zakonshme të emocioneve…. Forma më të buta dhe intensiteti i emocionit jep një sfond të motivueshëm të shumë gjërave që ne bëjmë. Në situata emergjente, më së shumti me anë të sekrecioneve të veshkave, ne posedojmë energji më shumë, se sa janë prezente në gjendjet normale… Një pasojë që duket shpesh nga stresi i zgjatur emocional apo i ndonjë lloji tjetër është ulçera gastrite.*

*Faktet apo treguesit e parë që na treguan qartë se ulçera mund të shkaktohet nga stresi emocional, dolën nga vëzhgimet e bëra te njerëzit, stomaku i të cilëve ishte ekspozuar dhe aktiviteti gastrik i të cilëve ishte i vëzhgueshëm…. Gjatë një periudhe prej dy javësh të ankthit dhe shqetësimeve të tejzgjatura, subjekti zhvilloi hemorragji të vogla në veshjen e brendshme të stomakut dhe gjithashtu, një shtim të aciditetit gastrik. Diçka që ngjasonte me një ulçer të vogël u zhvillua. Kërkuesit u habitën me mundësinë se "zinxhiri i ngjarjeve që fillon me ankthin, konfliktin dhe i shoqëruar me mbiaktivitetin e stomakut dhe përfundon me hemorragji apo shpim është ajo që është përfshirë në histori si ulçera peptike në qeniet njerëzore. Që nga periudha që janë bërë këto vëzhgime, ka patur evidenca shtesë direkte që tregojnë se stresi psikologjik prodhon ulçerat."*[4]

Ajo që dallon botën e njeriut realist nga bota e një të papjekuri është imagjinata. Një njeri sipërfaqësor dhe i cekët që shikon vetëm anën e jashtme të gjërave dhe dukurive është kaq shumë i kënaqur nga aftësia e tij e imagjinatës, saqë zemra përfshihet në çdo moment nga valët e dëshirave të pafundme. Sapo ai e kupton kursin e zhvillimit të ngjarjeve si një pengesë në rrugën e tyre, shpirti i tij përmbytet nga një trishtim i frikshëm dhe ai zhytet në një disfatë të plotë. Në këtë krizë ai shoqërohet me një dobësim të shpirtit që mund ta çojë drejt vetvrasjes.

4. Man, Norman. L. Psikologji: *Themelet e Përshtatjes njerëzore*, botimi i katërt, Boston, Houghton Mifflin Company, 1961,f. 321, 325, 342, 352

Në të kundërt, një person realist është i çliruar nga skllavëria e perceptimeve fëminore të pabaza. Ai i vështron gjërat në perspektivë më të gjerë dhe gjithëpërfshirëse. Ai nuk i shikon gjërat pjesërisht dhe nuk lejon gënjeshtrat dhe mashtrimet të ndikojnë në jetën e tij praktike. Prandaj, ai lufton dhe përpiqet ta përshtasë veten me mjedisin social dhe fizik ku jeton, si dhe me faktet e jetës së tij të brendshme dhe të jashtme.

Një njeri që ka një personalitet vërtet të balancuar dhe një shpirt të ekuilibruar nuk mund të tundet nga çdo shkulm ere. Arsyeja që disa njerëz ndihen të trishtuar dhe jo rehat apo në ankth në kohë të lirë është pamjaftueshmëria e forcës shpirtërore dhe mungesa e terrenit të sigurt. Kështu që, ata kalojnë në gjendje argëtimi të dëmshëm dhe jo të dobishëm thjesht për të vrarë kohën. Por sa më i fortë të jetë njeriu në lidhje me fuqinë e tij të brendshme, aq më pak i nevojitet atij ambienti i jashtëm. Një vend i cili ka nevoja më të pakta për importet, ka themele më të forta ekonomike. Një njeri që ka mjete të përshtatshme të brendshme dhe nuk është në nevojë të vazhdueshme për ndihmë nga jashtë, mund ta shpëtojë veten nga aktivitete të rrezikshme dhe nga mënyra rrënuese të sjelljes. Ai mund të sjellë një gjendje përmbajtjeje dhe gjakftohtësie në cilësitë e tij etike dhe të ndryshojë impaktin e faktorëve të jashtëm në shpirtin e tij.

Zhan Zhak Ruso thotë:

*"Maturi! Maturi që na urdhëron përherë të shikojmë përpara në të ardhmen, një e ardhme të cilën në shumë raste ne kurrë nuk do ta arrijmë. Këtu qëndron burimi i vërtetë i të gjitha problemeve tona! Sa marrëzi është për një krijesë jetëshkurtër siç është njeriu, që të shpresojë në një të ardhme, tek e cila ai rrallë herë arrin, ndërsa ai neglizhon të tashmen që është e tij? Kjo marrëzi është edhe më fatale, pasi ajo rritet me kalimin e viteve dhe të vjetrit, gjithmonë të urtë e të matur, të ndrojtur dhe dorështrënguar, preferojnë t'ia dalin pa gjërat e domosdoshme sot, se sa të kenë me qindra salltanete. Kështu ne mbërthejmë çdo gjë, ne qepemi pas*

*çdo gjëje; ne jemi të shqetësuar për kohën, vendin, njerëzit, gjërat, gjithçka që ndodh dhe do të ndodhë; ne jemi pjesa më e vogël e vetvetes. Ne e shpërndajmë veten tonë, si të thuash, në të gjithë botën dhe i gjithë ky ekspansion i madh bëhet i ndjeshëm. Nuk habitemi kur fatkeqësitë rriten dhe kur ne mund të plagosemi në të gjitha anët. Sa princër e kanë bërë veten të mjerë nga dashuria për pronat që nuk i kanë parë kurrë dhe sa tregtarë dëshpërohen dhe vajtojnë në Paris, mbi disa fatkeqësi në Indi! Ne nuk jetojmë më në vendin tonë, ne jetojmë jashtë tyre. Çfarë përfitimi kemi të jetojmë nën frikën e vdekjes, kur gjithçka që e bën jetën tonë të vlefshme është e jona? O njeri! Jeto jetën tënde dhe nuk do të ndihesh më i mjerë. Çdo gjë që është e tepërt, nuk është tjetër veçse skllavëri, mashtrim dhe dinakëri."*[5]

Imam Sadiku ka thënë:

*"Aktualisht jeta e njeriut në botë është si një orë e shkurtër dhe e shpejtë. Çfarë do që të ketë ndodhur në të deri në momentin e tanishëm, ka kaluar dhe ti nuk ndien as kënaqësinë dhe as dhimbjen që ajo të ka dhënë. Ndërsa, përsa i përket asaj që po vjen, ju nuk e dini se çfarë sjell ajo. Gjithçka që mbetet në dorën e jetës suaj të shtrenjtë janë momentet e tanishme. Prandaj i përdorni ato për qëllimin e marrjes së kontrollit mbi veten dhe përpiquni për vetëdukimin dhe shpëtimin tuaj. Bëhuni të palëkundur në bindjen tuaj ndaj Zotit dhe zbatoni urdhrat e tij duke u shmangur nga gjynahet dhe nga thyerja e urdhëresave dhe dekreteve të Zotit."*[6]

Në qoftë se përfshirja e njeriut në të shkuarën dhe në të ardhmen është për hir të shpëtimit nga problemet e së tashmes, kjo është një sëmundje psikike ose një prelud për një sëmundje të tillë, në opinionin e psikologëve, të cilët thonë:

*"Nëse një njeri do të vendoste për të mos vënë re të tashmen dhe nuk do të përfitonte te mundësitë e ofruara, do t'u thoshte të tjerëve: "Është e vërtetë se unë nuk jam mirë me studimet, por le të presim dhe të shohim se çfarë do të bëj pasi të dal në jetë. Të gjithë ata që kanë dalë keq me studimet e tyre, pavarësisht nga kjo,*

5. Rusoi, *Emile*, f.46-47
6. Al- Kulayni, *Wsul al- Kafi*, vëllimi 2, f.454

*kanë patur sukses në jetën e tyre. Unë kam ide dhe ëndrra të qarta lidhur me të ardhmen time." Kjo mënyrë e të menduarit tregon se njeriu kërkon të shpëtojë nga jeta e vërtetë dhe nga e tashmja e tij. Psikologët tashmë e dinë mirë se këto fantazi nuk përputhen me realitetin dhe s'janë asgjë më shumë, sesa arsyetime zhgënjyese dhe të gabuara. Kjo mënyrë e të menduarit për të ardhmen është e dëmshme dhe ajo që është pothuajse e sigurt është se personi me një mënyrë të tillë të menduari do të dështojë të arrijë suksese në të ardhmen, ashtu si dhe në të tashmen. Në qoftë se të menduarit rreth së ardhmes dhe të shkuarës i merr të gjithë kohën dhe energjitë njeriut dhe bën që ai të neglizhojë problemet e tij të përditshme me të cilat përballet, një person i tillë është pa dyshim shëndetlig dhe i pakorrigjueshëm. Në qoftë se një njeri nuk mund të përballojë problemet e së tashmes dhe vazhdimisht mendon për të ardhmen për të shpëtuar prej tyre, ky mendim për të ardhmen bëhet një zëvendësues i vëmendjes për të tashmen. Një zëvendësim i tillë, që nuk ndihmon në zgjidhjen e problemeve të njeriut është i pavlerë, i dëmshëm dhe i padrejtë."*[7]

Imam Hysejni ka thënë:

*"Kur një njeri i zgjuar goditet nga një e keqe apo nga një pikëllim, ai nuk mbështillet nga hidhërimi. Prandaj, me durim, vetëpërmbajtje dhe largpamësi ai heq ndryshkun e pikëllimit nga zemra e tij dhe përdor inteligjencën e vet për të gjetur zgjidhje."*

Me forcën që kemi në dispozicion, ne mund të luftojmë kundër disfatave dhe fatkeqësive që na mësyjnë nga të gjitha anët dhe sa herë që ka një ndalesë në këtë beteje, energjitë e papërdorura të njeriut, si një ngarkesë e rëndë, e mundojnë atë, i cili është detyruar t'i përdorë për qëllime të kota e sipërfaqësore.

Një nga rrugët e shmangies së ankthit është të përfshihesh në lloje të ndryshme aktivitetesh përfituese. Ata, të cilët gjatë kohës që kanë patur çrregullime dhe shqetësime të brendshme përfshihen në aktivitete përfituese, lehtësohen gjatë kohës që janë të zënë dhe janë të kënaqur

7. Malm & Sorenson, op. cit, f. 238

dhe të gëzuar kur shohin frutet e punës së tyre. Për këtë arsye, edhe pse shumë nga këto aktivitete konsistojnë në një lehtësim relativ, ato përbëjnë një reagim të dobishëm dhe të kënaqshëm dhe mendja, të paktën, merr një çlirim të përkohshëm nga një problem personal, në dukje i pazgjidhshëm. Dhe në veçanti, nëse veprimtaria përfshin një përfitim për të tjerët, kjo do t'i bëjë mirë edhe atij, pasi është e pamundur që një njeri, i cili është i dobishëm për të tjerët, të mos jetë i tillë për veten e tij. Gjithashtu, kjo do ta shpëtojë atë nga shpresa dhe ngushëllimi në mënyra jo të dobishme dhe të dëmshme për ta mbajtur veten të angazhuar me punë.

## Dobia e përfitimi nga lehtësimi i dhimbjeve të njeriut

Lehtësimi i zemrës dhe i shpirtit me shokë besnikë dhe të sinqertë është një nga mënyrat, me të cilën mund të fitohet lehtësim nga vuajtjet dhe tensioni mendor. Personave në gjendje mjerimi u duhet dhënë mundësia për t'u qetësuar nga tensioni shpirtëror i brendshëm, duke biseduar për vuajtjet e tyre me shokët dhe miqtë e ngushtë. Në të njëjtën mënyrë, simpatia dhe bashkimi i interesave për miqtë që vuajnë dhe ndihma e tyre për të lehtësuar vuajtjet e tensionet e tyre të brendshme shpirtërore dhe zgjidhja e vështirësive në masën e mundësive të njeriut është një nga detyrat më të rëndësishme dhe më të vlefshme për çdo qenie njerëzore. Dikush, miqësia e të cilit qëndron në dashurinë e vërtetë, nuk duhet të jetë indiferent apo i pavëmendshëm për shokët në raste krizash. Kësaj çështjeje i është treguar vëmendje e veçantë dhe e plotë në traditat e udhëheqësve fetarë dhe është vënë theksi se njeriu besimtar është burim ngushëllimi për të tjerët.

I Dërguari fisnik *(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e Tij!)* ka thënë:

*"Punët më të mira që mund të bëjmë për Zotin janë: të*

*bëjmë të lumtur një vëlla të besimit duke ia lehtësuar atij urinë, pikëllimin dhe vuajtjet."*[8]

Imami Sadiku ka thënë:

*"Sa herë që një nga ju preket nga stresi dhe trishtimi, ai duhet t'ia bëj të ditur vëllait të tij, kështu që ai të mund ta heqë errësirën e trishtimit dhe të agonisë nga zemra dhe shpirti juaj."*[26]

Shakter, një psikolog i njohur thotë:

Në qoftë se jeni të trishtuar dhe të brengosur nga gjendja dhe sjellja juaj dhe jeni të paaftë të zgjidhni problemin që keni, thuajani në mirëbesim vështirësinë tuaj dikujt, tek i cili ju mbështeteni dhe që është i mençur. Mbajtja përbrenda e një mendimi të dhimbshëm, frike apo ankthi, vetëm sa e bën atë më ngulmuese dhe më të mërzitshme situatën. Shprehjani mendimin tuaj sekret një njeriu të zgjuar dhe kërkoni këshilla prej tij. Frika dhe mendimet e këqija zhduken te njerëzit që ballafaqohen. Mos u tërhiqni nga lehtësimi i vetes përpara një psikiatri apo përballë një shoku të mençur; pasi, mendimet shqetësuese që u janë dorëzuar ndaj dëshirës e vullnetit të pandërgjegjshëm, gjithmonë mbeten pengesa midis nesh dhe paqes shpirtërore e lumturisë. Duhet të dihet se ndrydhja e mendimeve është dy llojesh. Ajo ndodh në mënyrë të natyrshme, pa dijeninë dhe vullnetin tonë, që do të thotë, mendja jonë e mprehtë shtyp çdo mendim shqetësues, madje pa u vënë re edhe prej nesh dhe e fut atë në thellësitë e kujtesës ose ndonjëherë, duke e ditur, ne largojmë nga mendja mendimet e dhimbshme dhe këmbëngulim në mosringjalljen e tyre në kujtesën tonë. Ky veprim është quajtur "represion" në zhargonin e psikologjisë. Sidoqoftë, kjo nuk e dobëson shqetësimin apo ankthin që del nga mendimi dhe sa më tepër përpiqemi ta harrojmë atë, aq më shumë na impresionon, duke na shkaktuar dhimbje më të madhe.

Në secilin rast, një mendim shqetësues dhe stresues që ne shtypim dhe ndrydhim, me dijeninë tonë apo pa dijeni,

8. *Wasa'il al-Shi'ah*, vëllimi 2, f.55

nuk na lë të vetmuar. Në mënyrë të fshehur apo haptazi, ai vazhdon të na mundojë. Nëse nuk ia themi në mirëbesim një njeriu të mençur dhe të kërkojmë ndihmën dhe këshillën e tij, ne nuk mund të shpëtojmë nga vuajtjet dhe torturat.

**Abduldaem Al - Kahiil**

# Argumente shkencore nga Kur'ani

## Abstrakte

*I.Në këtë artikull janë përfshirë disa argumente shkencore nga Kur'ani, tw tillë si: veçantia e moshës dyzet vjeç, optimizmi, jeta e Diellit, vetëtima, lumturia dhe zemra, frekuencat e trurit, zbritja e ujit, fotoja më e bukur për vitin 2013, fundi i pashmangshëm për universin, Trokitësi, Hëna si dritë, kandrra më e vockël, shpërthimi i organizuar, galaktika më e hershme, formimi i yjeve, merimanga është arkitekte, nënat dhe duhani, istikhare (lutja që kërkon udhëheqësínë e Allahut), mrekullia e dorës së njeriut dhe ngritja herët në mëngjes.*

***II. "Kryejeni faljen, jepeni zekatin dhe mbahuni fort tek Allahu! Ai është Mbrojtësi dhe Ndihmëtari juaj. Sa Mbrojtës dhe Ndihmëtar i Shkëlqyer është Ai!"*** ("Haxh", 78)

*Studiuesit pohojnë se njerëzit që i kryejnë faljet rregullisht, janë më të shëndetshëm dhe psikologjikisht më të qëndrueshëm. Kjo ndodh sepse adhurimi dhe meditimi pakësojnë hormonet e stresit dhe ngadalësojnë shpejtësinë e rrahjeve të zemrës, përveç ndikimit të tyre si qetësues. Kur njeriu falet dhe i afrohet Krijuesit të tij me gjithë zemër, ndërsa imagjinon Xhenetin, Xhehenemin dhe ngjarjet e mëdha të Ditës së Gjykimit dhe mendon shumë për kuptimet e ajeteve, që ai këndon e me të cilat jeton - kjo lloj faljeje është edhe adhurim, edhe ilaç, ngaqë truri merr një sasi shumë të madhe informacioni dhe urdhrash kuran'orë. Të tillë urdhra konsiderohen si forma të rimbushjes, të programimit dhe të riformimit të qelizave të dëmtuara.*

# I

## Mosha dyzet vjeç

Kohët e fundit, shkencëtarët kanë zbuluar se rritja e njeriut nuk ndalon në moshën 21 vjeç. Ata kanë zbuluar se truri vazhdon të rritet deri në moshën dyzet vjeç. Kjo do thotë se rritja e njeriut plotësohet vetëm kur ai është dyzet vjeç. Dhe, kjo është ajo, së cilës Kur'ani i Shenjtë i referohet kur Allahu (që qoftë i Madhëruar!) thotë: "**Derisa njeriu të arrijë kulmin e fuqisë së vet dhe kur të mbushë dyzet vjeç, ai thotë: 'Zoti im, më mundëso të të jem mirënjohës për mirësitë që më ke dhuruar Ti!'**" (Surja 46 : 15). I Madhëruar qoftë Allahu! Kush i tha Profetit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) për këtë fakt shkencor?

## Optimizmi

Një kërkim i ri shkencor ka zbuluar se optimizmi ka një ndikim të dobishëm në shëndetin e njeriut. Ai rrit sistemin e tij imunitar. Dhe kjo është arsyeja që ne e shohim ndikimin e mirë të fesë në jetën psikologjike dhe fizike të një besimtari. Sa më shumë që besimtari të besojë tek Allahu, aq më i shëndetshëm do jetë dhe aq më i fuqishëm do të jetë sistemi i tij imunitar. Allahu (që qoftë i Madhëruar!) thotë:

"**Thuaj 'O robtë e Mi, që e keni ngarkuar me shumë mëkate veten tuaj, mos e humbni shpresën ndaj mëshirës së Allahut sepse, vërtet Allahu i fal të gjitha mëkatet, Ai është Falësi dhe më i Mëshirshmi**.'" (Surja 39: 53).

Le t'i vështrojmë këto fjalë dhe të mendojmë për to: *mos e humbni shpresën…* Të gjitha këto fjalë janë urdhra nga Allahu (që qoftë i Madhëruar!) për robtë e tij, për të korrigjuar mënyrën e tyre të të menduarit dhe për të qenë optimistë, për të menduar pozitivisht dhe për të pasur gjithmonë shpresë.

## Jeta e Diellit

Është një mrekulli që në Kur'anin e Shenjtë Dielli përshkruhet si një llambë verbuese, domethënë që ai është në periudhën e tij të mesit. Allahu (që qoftë i Madhëruar!) thotë: "**Dhe ne e bëmë një llambë verbuese.**" (Surja 78 : 13).

Fjala *Verbues* i referohet faktit që Dielli është një yll i nxehtë. Në univers gjenden edhe yje të zbehta dhe yje të mugëta; kurse Dielli nuk është i tillë. Ai është flakërues dhe vebues. Ky karakterizim është një mrekulli e Kur'anit të Shenjtë, sepse askush nuk e dinte këtë fakt në kohën kur u zbrit ai.

## Vetëtima është mëshirë nga Allahu

Shkencëtarët thonë se vetëtima është shumë e nevojshme për sigurinë e atmosferës. Në qoftë se nuk do të kishte vetëtimë, atëherë atmosfera e Tokës do të ishte ngarkuar me elektricitet dhe jeta do të zhdukej e nuk do të kishte shira…

Shkencëtarët na sigurojnë se Toka u ekspozohet më shumë se një qind shkreptimave në çdo sekondë, domethënë, tetë milionë vetëtima çdo ditë. Dhe për arsye të mëshirës që Allahu ka për ne, këto vetëtima bien në vende të pabanuara. I Madhëruar qoftë Allahu, i Cili ka thënë: "Është Ai, i Cili ju shfaq vetëtimën për frikë dhe shpresë." (Surja 13 : 12).

## Lumturia dhe zemra

Një studim i ri amerikan na thotë se edhe një gëzim i vogël reflektohet pozitivisht në sigurinë e zemrës dhe në qëndrueshmërinë e funksioneve të saj. Studiuesit thonë se ne mund ta shpëtojmë veten nga rreziku i sëmundjeve të zemrës po të jemi optimistë, po të mendojmë për mirë,

po të bëjmë pak pushim dhe po të ndryshojmë mendimet e këqija që kemi dhe t'i zëvendësojmë ato me mendime optimiste. Kështu, nëse duam të jetojmë një jetë të gjatë të lumtur, atëherë, duhet të jemi besimtarë: Të besojmë tek Allahu dhe të mbështetemi vetëm tek Ai. Allahu (që qoftë i Madhëruar!) thotë: "**Kushdo që bën vepra të mira, qoftë mashkull ose femër dhe duke qenë besimtar, Ne do t'i japim atij një jetë të mirë dhe do ta shpërblejmë atë me më të mirin shpërblim për veprën e tij.**" (Surja 16 : 97).

## Frekuencat e trurit

Kohët e fundit, shkencëtarët kanë zbuluar se në trurin e njeriut ka frekuenca. Truri i secilit prej nesh prodhon vazhdimisht frekuenca elektromagnetike, të cilat provojnë veprimtarinë e trurit dhe llojin e veprimeve që ai bën. Kur një njeri kujton hollësitë e një situate të caktuar, truri i tij prodhon frekuenca, të cilat ndryshojnë nga frekuencat që prodhon ai kur kujton një situatë tjetër. Po kështu, një njeri prodhon frekuenca që dallojnë nga frekuencat e një njeriu tjetër. Kjo mund të hetohet duke përdorur aparaturë të veçantë. Këto të dhëna dhe fakte mrekullore na bëjnë të vështrojmë veten tonë. Allahu (që qoftë i Madhëruar!) thotë: «**Edhe në veten tuaj (**ka argumente**). A nuk mund t'i shihni**?" (Surja 51 : 21).

## Zbritja e ujit

Në kërkimet më të fundit shkencore është provuar dhe treguar se uji në sipërfaqen e Tokës është formuar gjatë miliona vjetësh dhe ka ardhur nga hapësira kozmike, i mbartur nga biliona meteoritë, që kanë rënë në Tokë. Mrekullia është se Kur›ani i Shenjtë e ka treguar se burimi i ujit është qielli: «**Dhe Ne e kemi zbritur ujin nga qielli me masë dhe e kemi përqendruar atë në Tokë dhe Ne,**

**vërtet mund ta zhdukim atë** (ujin)." (Surja 23 : 18). Ky ajet i nderuar na siguron se burimi i ujit në Tokë është qielli. Kjo është provuar shkencërisht. Ky fakt shkencor nuk dihej në kohën e Shpalljes së Kur'anit të Shenjtë. E, kush ia tha atë Profetit të Nderuar (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)?

## Fotoja më e bukur për vitin 2013



Le të vështrojmë këtë skenë të mrekullueshme, që tregon Madhërinë e Krijuesit të Gjithëfuqishëm - kur shfaqet meteori që depërton në agimin polar me ngjyra mahnitëse. Ky imazh u paraqit në faqen hapësinore të internetit dhe u konsiderua imazhi më i bukur për vitin 2013. Imazhi është fiksuar në veri të Kanadasë. Agimi polar shfaqet në të me ngjyrë të gjelbër dhe me një meteor që depërton në të. Ai flakëron kur hyn në atmosferë si rezultat i djegies.

Dukuria e agimit polar dhe si formohen ngjyrat e tij vijon t'i mahnisë shkencëtarët. Ata e konsiderojnë atë dukurinë më të bukur. Dhe, Allahu i Gjithëfuqishëm betohet për këtë kur thotë:

"**Betohem në kuqëlimin e perëndimit të diellit. Dhe në natën e në çfarë ka ajo në errësirën e saj.**" (Surja 84 : 16).

## Fundi i pashmangshëm për universin

Në një eksperiment të ri, shkencëtarët kanë zbuluar se universi nuk do të vazhdojë përgjithmonë. Ai ka një fund të pashmangshëm. Molekula Higgs provon se universi do t›i nënshtrohet një shkatërrimi të plotë katastrofik pas biliona vjetësh. Yjet, galaktikat, Toka dhe njerëzit…, gjithçka do të zhduket. Ky përfundim është në kundërshtim me atë që pretendojnë ekzistencialistët dhe me të gjitha parashikimet

e mëparshme se universi do të zgjasë përgjithmonë. Kur›ani i Shenjtë e ka shpallur këtë përfundim 1400 vjet më parë. Allahu (që qoftë i Madhëruar!) thotë: «Çfarëdo që është në të (Tokë), **do të shkatërrohet. Dhe do të mbetet përgjithmonë Fytyra e Zotit tënd gjithë Madhështi e Përnderim**." (Surja 55 : 26, 27). I Madhëruar është Allahu.

## Trokitësi



Astronomët kanë zbuluar yje që nxjerrin tinguj, sikur trokitet me çekiçë. Ata thonë se arsyeja që ne i dëgjojmë këto trokitje është shpejtësia e madhe e rrotullimit të këtyre yjeve rreth vetes. Gjatë rrotullimit ylli bën trokitje të rregullta dhe lëshon rrezatime. Rrezatimi mund të shpojë çdo gjë. Prandaj rrotullimi i këtyre yjeve shkakton trokitje dhe shpim.

Allahu i Gjithëfuqishëm thotë për këto lloj yjesh: "**Pafsha qiellin dhe trokitësin** (Tarikun)! **E, ku e di ti se çfarë është Tariku** (trokitësi)? **Ai është ylli që shpon** (errësirën me dritë)." (Surja 86 : 1 - 3). Ia vlen të thuhet se kuptimi i fjalës arabe "at - tarik" është "trokitësi". Allahu i Gjithëfuqishëm i ka përmbledhur karakteristikat e këtyre yjeve vetëm me dy fjalë, të cilat janë: "at - tarik" dhe "shpues". I Madhëruar qoftë Allahu, Krijuesi i gjithçkaje.

## Hëna si dritë



Shkencëtarët e sotëm kanë zbuluar se Hëna është trup i ftohtë, kurse Dielli është trup flakërues. Këtu na duhet të themi se Kur'ani u ka paraprirë të gjithë shkencëtarëve të sotëm, sepse Allahu i Gjithëfuqishëm thotë: "Është Ai, i Cili e bëri Diellin shndritës dhe Hënën dritë dhe asaj (Hënës) **i caktoi fazat, që ju të mund të dini numrin e viteve dhe të**

**bëni përllogaritjet. Allahu nuk e ka krijuar këtë për asgjë tjetër, përveçse për një qëllim të caktuar. Ai i sqaron argumentet me hollësi për njerëzit që kanë dije.**" (Surja 10 : 5)

Kush ia tha Profetit Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) këtë fakt shkencor dhe çfarë e bëri atë t'i dallonte këta dy trupa qiellorë në një kohë, kur askush në këtë botë nuk e kishte bërë këtë dallim? Ai është Allahu i Gjithëfuqishëm, i Cili thotë për Veten e Vet: "**Ky është Allahu, Zoti juaj, Krijuesi i gjithçkaje. Nuk ka zot tjetër përveç Atij. E, si ia ktheni shpinën** (Allahut / duke adhuruar të tjerë përveç Atij)?" (Surja 40 : 62).

## Kandrra më e vockël



Kjo është fotoja e një grerëze që fluturon pa u ndier. Ajo është paraqitur nga "National Geography".Kandrra është vetëm 0.2 mm, çka do të thotë se zor se mund të shihet me sy të lirë. Por, pavarësisht vogëlsisë së saj, ajo ka sistem të plotë që e bën të vijojë jetën. Ajo ka sistemin nervor prej mijëra qelizash, sistemin e frymëmarrjes, sistemin e riprodhimit etj.

Entomolgët (studiuesit që merren me kandrrat) mahniten kur shohin sesi nuk i mungon asgjë kësaj kandrre. Ne u themi këtyre entomologëve pikërisht atë që ka thënë Allahu i Madhëruar në Kur'anin e Shenjtë, kur u drejtohet ateistëve, të cilët besojnë në natyrën dhe në rastësinë: "**I tillë është krijimi i Allahut. Tani, më tregoni Mua çfarë krijuan të tjerët përveç asaj që kam krijuar Unë? Asgjë. Idhujtarët janë në humbje të plotë.**" (Surja 31 : 11).

## Shpërthimi i organizuar



Ky është vizatim që paraqit fazat e fillimit të krijimit të universit. Shkencëtarët thonë se universi ka qenë një masë e vetme, e cila ka shpërthyer më pas në saje të një force shumë të madhe.
Një shpërthim i tillë nuk ka qenë i rastësishëm.

Ai ka qenë shumë i organizuar, i përpiktë dhe i programuar sepse ai solli formimin e atomeve, të cilat u bashkuan për të formuar galaktikat, yjet, Tokën, Diellin dhe Hënën, domethënë, universin. Për t'u habitur: Një fakt i tillë, që thotë se qiejt dhe Toka kanë qenë një masë e bashkuar dhe pastaj janë ndarë e kanë formuar trupat qiellorë, përfshirë Tokën me drurë, ujëra, re, etj. është zbuluar në Kur'anin e Shenjtë. Allahu i Gjithëfuqishëm thotë në Kur'anin e Shenjtë: "**A nuk besojnë ata se qiejt dhe Toka ishin ngjitur dhe Ne i ndamë dhe ujin e bëmë bazë të jetës së çdo gjallese? A ende nuk besojnë ata?!"** (Surja 21 : 30). A nuk është kjo që thotë ajeti i mësipërm e njëjtë me faktet e zbuluara nga shkencëtarët? A nuk provon ky ajet të vërtetën e Kur'anit të Shenjtë, Fjalën e Allahut, të të Gjithëfuqishmit?

## Galaktika më e hershme



Astronomët kanë zbuluar shumë larg planetit tonë një galaktikë. Ata thonë se ajo është formësuar rreth 500 milionë vjet pas krijimit të universit.
Kjo galaktikë është më e vjetra që njihet deri tani. Astronomët vërtetësojnë, gjithashtu se

universi është shumë më i gjerë dhe çfarë është zbuluar deri tani nuk është më shumë se 1 % e madhësisë së tij.

Astronomnët vlerësojnë se Toka është afro 13.7 bilionë vjet, domethënë, dritës së galaktikës i duhen afro 13.2 bilionë vjet për të mbërritur në Tokë, madje edhe më shumë. Allahu i Gjithëfuqishëm thotë në Kur'anin e Shenjtë:

"**Nuk ka dyshim se krijimi i qiejve dhe i Tokës është më i madh se krijimi i njerëzve, por shumica e njerëzve nuk e dinë**." (Surja 40 : 57).

Ka kërkime të reja shkencore që vërtetojnë se universi është më i madh se ç'mendojmë ne, ose se ç'e imagjinojmë ne - një fakt që provon vërtetësinë e Kur'anit të Shenjtë, Fjalën e Allahut.

## Formimi i yjeve



Kjo është një pamje e tymnajës kozmike që ka ekzistuar biliona vjet më parë. Shkencëtarët pohojnë se yjet janë formuar mrekullisht nga atome të tilla tymnaje, për t'u bërë më pas me dritë dhe me ngjyra të ndritshme, sikur të zbukuronin qiellin. Ky fakt shkencor tregon se qielli ka qenë plot me tym në fazat e hershme të krijimit të universit dhe pastaj, janë formuar yjet. Të tilla yje janë si llamba që ndriçojnë gjithçka përreth.

Kur'ani i Shenjtë, mrekullisht dhe saktësisht e ka zbuluar këtë fakt shkencor katërmbëdhjetë shekuj përpara se ta zbulonin shkencëtarët. Allahu, i Madhëruari thotë në Kur'anin e Shenjtë: "**Pastaj iu drejtua qiellit (**krijimit të qiellit**) e ai ishte tymnajë dhe atij e edhe Tokës u tha: 'Bindjuni urdhrit Tim, me dëshirë ose pa dëshirë!' Qielli dhe Toka thanë: 'Po, i bindemi me dëshirë!' Dhe Ai krijoi shtatë qiej brenda dy ditëve dhe secilit qiell i caktoi detyrën dhe urdhrin. Dhe Ne e stolisëm qiellin më të afërt**

(të kësaj bote) **me yje ndriçuese dhe e bëmë të mbrojtur. Ky është urdhri i të Plotfuqishmit, i Gjithëdijësit**.'" (Surja 41 : 11, 12).

Ajetet e mësipërme flasin për krijimin e qiellit në fillim dhe pastaj, për krijimin e yjeve, të cilat përshkruhen si drita (llamba). Ne e madhërojmë Allahun, të Gjithëfuqishmin, i Cili e ka zbuluar këtë fakt të saktë shkencor në Kur'anin e Shenjtë. A nuk janë këto dy ajete të mësipërme një fakt i mjaftueshëm se Kur'ani i Shenjtë është, pa dyshim Fjala e Zotit?

## Merimanga është arkitekte



Shkencëtarët thonë se merimangat janë krijuar me programe të ndërlikuara në qelizat e tyre nervore, që u japin mundësi t'i ndërtojnë rrjetat e tyre me një arkitekturë të mrekullueshme. Programe të tilla nuk mund të bëhen kurrë nga natyra ose si rrjedhojë e evolucionit. Programe të tilla bëhen e organizohen nga Fuqia e Mbinatyrshme.

Ne besojmë se është Allahu i Madhëruar, i Cili i ka krijuar merimangat, ashtu si edhe të gjitha gjallesat e tjera e të gjitha organizmat e tjerë dhe është Allahu Ai, i Cili i drejton. Allahu, i Gjithëfuqishmi thotë në Kur'anin e Shenjtë: "**Ky është Allahu, Zoti juaj. Nuk ka zot tjetër përveç Atij. Ai është Krijuesi i gjithçkaje. Atëherë, adhurojeni Atë. Ai është Mbikëqyrësi i gjithçkaje. Asnjë shikim nuk mund ta rrokë Atë, kurse shikimi i Tij rrok gjithçka. Ai di gjithçka**." (Surja 6 : 102, 103).

## Nënat dhe duhani

Sipas një studimi të kohëve të fundit, shkencëtarët kanë vërtetuar se fetusi i një nëne, që pi duhan ndikohet negativisht. Ky ndikim negativ zgjat derisa fëmija të rritet. Ky fëmijë është i prirur edhe për ta marrë këtë ves - duhanin dhe për të pirë vetë duhan. Nga ana tjetër, siç dihet nga mjekësia, pirja e duhanit nga një grua shtatzanë shkakton një numër dëmtimesh te fetusi. Duhani dëmton edhe fëmijët e tjerë, kur nëna e pi në prani të tyre. Ata mund të ndikohen nga duhani dhe të bëhen edhe vetë duhanpirës kur të rriten.

Sipas një studimi tjetër, që është bërë në Universitetin e Bristolit, është zbuluar se duhani dhe alkooli janë më të këqij se drogat ilegale. Prandaj Profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) na ka mëshiruar, kur na ka mësuar që të mos e dëmtojmë veten: "*Mos i bëni dëm vetes, por mos i bëni dëm as tjetrit*!" Kurse Allahu, i Madhëruari na do ne të bëjmë mirë, kur thotë në Kur'anin e Shenjtë: "**Dhe jepni në rrugën e Allahut e mos i bëni duart tuaja t'ju shkatërrojnë, por bëni mirë sepse Allahu i do ata që bëjnë mirë**." (Surja 2: 195).

## Istikhare (lutja që kërkon udhëheqësínë e Allahut)

Kohët e fundit, studiuesit kanë zbuluar se te balli i njeriut është qendra trunore e marrjes së vendimeve dhe se ajo bëhet aktive gjatë faljes dhe adhurimit të Zotit. Atëherë, në qoftë se doni të merrni një vendim të suksesshëm, ju duhet ta adhuroni Zotin, t'i luteni Zotit me përulësi dhe pastaj të merrni vendimin. Kjo është e thënë shkencore. Profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) u ka paraprirë shkencëtarëve për këtë fakt, sepse ai na ka mësuar të bëjmë istikhare përpara se të marrim çdo vendim.

I Madhëruar qoftë Allahu! Kush i tha Profetit Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) se qendra trunore, që ndodhet në ballë bëhet aktive kur falemi dhe se një aktivizim i tillë i ndihmon njerëzit të marrin vendime të suksesshme? Për mahninë tonë, Kur'ani i Shenjtë e lidh faljen dhe përulësinë, nga njëra anë me suksesin, nga ana tjetër. Allahu i Gjithëfuqishëm thotë në Kur'anin e Shenjtë: **"Është e sigurt se kanë shpëtuar besimtarët, ata që janë të përulur dhe të kujdesshëm gjatë faljes së namazit."** (Surja 23: 1, 2).

## Mrekullia e dorës së njeriut

Sipas një studimi shkencor të bërë në Universitetin e Utahut, shkencëtarët kanë zbuluar se ndërtimi i dorës së njeriut është i ndryshëm nga ai gjymtyrës së përparme të çdo kafshe. Profesor David Kerië (David Carrier) thotë se ka shumë mundësi për zhvillimin e dorës së njeriut (sipas teorisë së zhvillimit). Po të vështrojmë krijesat e tjera, do të shohim se njeriu është e vetmja krijesë që dallohet për nga dora, e cila është e përshtatshme për çdolloj veprimi; kurse majmunët për shembull, mund të bëjnë vetëm veprime të kufizuara.

Njeriu dallohet prej krijesave të tjera edhe nga shumë tipare të tjera. Njeriu është krijuar ndryshe, sepse Allahu, i Gjithëfuqishmi i ka frymuar njeriut shpirtin dhe i ka dhënë atij aftësinë të mësojë dhe të flasë. Për këtë Allahu i Madhëruar thotë në Kur'anin e Shenjtë: "**Vërtet, Ne e krijuam njeriun në formën më të bukur**." (Surja 95 : 4). I Madhëruar qoftë Allahu!

## Ngritja herët në mëngjes

Një studim i kohëve të fundit ka provuar se ngritja herët në mëngjes, përpara lindjes së diellit zgjat jetën,

rrit veprimtarinë e qelizave të trupit dhe përmirëson perceptimin e njeriut e aftësitë e tij mendore.

Shkencëtarët thonë se të flesh 6 orë, nga ora 10 në mbrëmje deri në orën 4 të mëngjesit është e barabartë me 12 orë gjumë ditën.

I Madhëruar qoftë Allahu, i Gjithëfuqishmi, që Profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) na ka urdhëruar të ngrihemi herët e të falim namazin e agimit, për të adhuruar Allahun. Allahu, i Madhëruari flet në Kur'anin e Shenjtë për rëndësinë që ka nata për një gjumë të rehatshëm.

Ai thotë se nata është një lloj petku për njeriun, që e mbron atë nga shqetësimet psikike dhe psikologjike.

Për këtë, Allahu i Madhëruar thotë në Kur'anin e Shenjtë: "**Dhe është Ai, i Cili natën ua bëri petk, gjumin pushim e ditën për gjallërim**." (Surja 25 : 47).

# II

## Studime shkencore për të mirat e faljes

## Falja forcon muskujt e trupit

Falja (namazi) është një nga llojet më të mira të sportit sepse ajo e shoqëron besimtarin gjatë gjithë jetës me një sistem të rreptë rregullash. Dhe kështu, ajo shmang shumë sëmundje, të tilla si porozitetin kockor (osteoporozën) dhe shtrembërimin e shpinës. Është provuar se falja e rigjallëron trupin dhe i rregullon proceset e brendshme të organizmit. Allahu thotë: "**Prandaj, kryejeni faljen, jepeni zekatin dhe mbahuni fort tek Allahu! Ai është Mbrojtësi dhe Ndihmëtari juaj. Sa Mbrojtës i shkëlqyer dhe sa Ndihmëtar i shkëlqyer është**"! ("Haxh", 78) Atëherë, a nuk duhet falur dhe shijuar ëmbëlsia e besimit?

## Rukuja dhe sexhdja

Një studim shkencor thotë se rukuja (përkulja me pëllëmbët e duarve mbi gjunjë) dhe sexhdja (vënia e ballit në tokë) kur falemi, forcon muskujt e barkut, të këmbëve dhe të kofshëve. Lëvizjet gjatë rukusë dhe sexhdes rrisin aktivitetin e zorrëve, kështu që parandalohet kapsllëku. Sexhdja dhe rukuja ulin, gjithashtu, trysninë e gjakut në tru, për të bërë kthimin e rrjedhës së gjakut në të gjitha organet e trupit. Allahu thotë: "**O ju që keni besuar! Bëni ruku dhe sexhde dhe adhurojeni Zotin tuaj dhe bëni vepra të mira, që të mund të gjeni shpëtim**". ("Haxh", 77)

## Falja dhe shërimi i zemrës

Në një artikull, të botuar në "Washington Post", studiuesit pohojnë se njerëzit që i kryejnë faljet rregullisht,

janë më të shëndetshëm dhe psikologjikisht më të qëndrueshëm e nuk vuajnë nga çrregullimet psikologjike. Kjo ndodh sepse adhurimi dhe meditimi pakësojnë hormonet e stresit dhe ngadalësojnë shpejtësinë e rrahjeve të zemrës, përveç ndikimit të tyre si qetësues. Ne e madhërojmë Allahun që na ka falur këtë dhuratë mahnitëse - faljen (namazin). Allahu thotë: "**Zoti yt e di se ti i kalon në adhurim afro dy të tretat e natës ose gjysmën e saj a një të tretën e saj. Kështu bën edhe grupi që është me ty. Por është Allahu Ai që e përcakton siç duhet gjatësinë e natës dhe të ditës. Ai e di që ju nuk mund t'i numëroni orët. Prandaj Ai ju është drejtuar (**me mëshirë**): Këndoni, atëherë Kur'an, aq sa të jetë e lehtë për ju! Ai e di se ndër ju mund të ketë të sëmurë dhe të tjerë që udhëtojnë nëpër tokë, duke kërkuar nga të mirat e Allahut e, edhe të tjerë që luftojnë në Rrugën e Allahut. Pra, këndoni Kur'an, sa të jetë e lehtë për ju dhe kryejeni me rregull faljen e jepni zekatin dhe i jepni hua Allahut - një hua të bukur! Dhe ç'të mirë që ju e dërgoni për shpirtrat tuaj, do ta gjeni në prani të Allahut si shpërblim - po, edhe më të mirë, edhe më të madh dhe kërkojeni hirin e Allahut sepse Allahu është Mëkatfalësi, më Mëshiruesi**!" ("Muzamil", 20)

## Falja dhe durimi

Psikologët mendojnë se falja, veçanërisht falja e natës (*kiami*) është një metodë e frytshme për trajtimin e sëmundjeve psikologjike, meqë ajo u jep besimtarëve qëndrueshmërinë dhe qetësinë dhe i bën ata t'i harrojnë shqetësimet e jetës. Le të lexojmë ajetin e madh të Allahut: "**O ju që keni besuar! Kërkoni ndihmë me ngulmim, me durim dhe faluni sepse Allahu është me durimtarët!**" ("Bekare", 153) Në qoftë se durimi bashkërendohet me faljen, sidomos me faljen kur besimtari e bën atë me përulësi absolute dhe pa menduar për punët e kësaj jete, por për të fituar kënaqësinë e Allahut të Madh, krijohet një ilaç i fuqishëm për çdo sëmundje.

## Falja ul trysninë e gjakut

Studiuesit vërtetësojnë se besimi është jashtëzakonisht i rëndësishëm për vazhdimësinë e racës njerëzore, ngaqë ai i bën ata më të përshtatshëm ndaj mjedisit të tyre dhe u përgjigjet pyetjeve që lindin në trurin e tyre. Studiuesit kanë zbuluar se falja e ul trysninë e gjakut dhe i largon depresionin dhe ankthin. Ajo e ul edhe ritmin e rrahjeve të zemrës. Si rrjedhojë, besimi është më i mirë se ateizmi (mosbesimi) për shëndetin dhe për sigurinë e njeriut. Falja më e mirë është ajo e myslimanëve sepse ata afrohen te Zoti i tyre dhe te Krijuesi i tyre. Allahu thotë: "**Ti lexo atë që po të shpallet nga Libri** (Kur'ani)**, fal namazin, sepse vërtet, namazi të largon nga veprat e shëmtuara dhe të padrejta! Dhe, pa dyshim, përmendja e Allahut është më e madhja** (gjë në jetë). **Dhe Allahu e di ç'bëni ju**." ("Ankebut", 45)

## Falja dhe besimi

Dr. Endru Njubërg (Andrew Newburg), neurolog, thotë se besimi, që ka një Krijues dhe një Zot për universin, është jashtëzakonisht i nevojshëm për të pasur një shëndet më të mirë fizik dhe psikologjik. Në librin e tij, "How God Changes Your Brain" (Si e ndryshon Zoti trurin tuaj), që pati një shitje të madhe në ShBA, Njubërg thotë se sa më i fuqishëm të jetë besimi juaj te Krijuesi, aq më i shëndetshëm është truri juaj.

Për këtë arsye, falja ndihmon për të shëruar sëmundje, veçanërisht, kur ajo bëhet rregullisht dhe në kohën e caktuar. Allahu i Madhëruar thotë: "**Kur të kryeni namazin (**me xhemat, në kushte rreziku të jashtëzakonshëm**), madhërojeni Allahun, kur jeni në këmbë, ulur, ose të mbështetur! E, kur të shmanget rreziku, atëherë, faleni namazin në mënyrë të rregullt, sepse të tilla namaze u janë urdhëruar besimtarëve në kohë të caktuara**"! ("Nisa", 103)

## Falja dhe administrimi i kohës

Ndër të mirat e faljes është se kur besimtari falet rregullisht e në kohët e caktuara, jeta e tij bëhet e organizuar dhe kështu, ndihmohet ora biologjike për të funksionuar me efektshmëri të lartë dhe qëndrueshmëri mahnitëse. Në këtë mënyrë, forcohet sistemi imunitar dhe aftësia e trupit për të luftuar sëmundje të ndryshme organike. Ja përse profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) na ka thënë të jemi të përpiktë në falje dhe ja përse e ka konsideruar faljen ndër veprat më të mira. Ai (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: "*Vepra më e dashur për Allahun është të kryesh faljen në kohën e saj të caktuar*". (Treguar nga imam Bukhariu)

## Falja pengon sëmundjen Alzajmer

Dr. Endru Njubërg (Andrew Newburg), studiues në Universitetin e Pensilvanisë, ShBA, ka botuar një libër të ri. Në këtë libër, Njubërg thotë se ai ka zbuluar se besimi te Zoti është jashtëzakonisht i rëndësishëm për t'u ndier i sigurt dhe për të rritur veprimtarinë e trurit. Ky besim, - thotë ai, - sjell ndryshime të vazhdueshme në mënyrën sesi funksionon truri, duke penguar kështu sëmundjen e Alzajmerit. Besimi i ndihmon, gjithashtu, njerëzit t'i përshtaten mjedisit, çka e bën njeriun të jetojë një jetë më të mirë. Besimi lufton, gjithashtu, degradimin mendor (demencën), i cili vjen nga vdekja e papritur e një numri të madh qelizash nervore.

Përveç kësaj, ai shëron sëmundjen e Parkinsonit. Ne e madhërojmë Allahun që na ka dhënë një ilaç pa pagesë, i cili është falja (namazi).

Allahu thotë: "**Vazhdoni rregullisht faljet (**namazet**), sidomos faljen e mesme dhe qëndroni para Allahut (**në namaze**) me përkushtim**!" ("Bekare", 238)

## Falja aktivizon sistemin imunitar

Një studim i kohëve të fundit ka treguar se koha e shërimit është më e shpejtë tek të sëmurët që e kryejnë faljen rregullisht, sepse zemrat e tyre janë të mbushura me besim, me optimizëm dhe me qetësi psikologjike e shpirtërore - që e forcojnë sistemin imunitar. Biologët mendojnë se faljet (namazet) dhe pozicionet e lëvizjet gjatë faljeve janë trajtim natyror për rastet e plakjes, kur njeriu vuan nga degjenerimi dhe ngurtësimi i kyçeve të trupit dhe kur trajtimi varet kryesisht nga bërja e ushtrimeve. Allahu, i Gjithëfuqishmi thotë: "**Dhe ata që e ruajnë** (shenjtërinë) **e adhurimit të tyre**." ("Mearixh", 34)

## Falja është e dobishme për gratë shtatzana

Studiuesit thonë se pozicionet dhe lëvizjet e trupit, kur falemi janë të dobishme për gratë shtatzana, sepse aktivizohen lëvizjet e muskujve dhe pakësohen presioni dhe pesha në këmbët e tyre, që shkaktohen nga pesha e fetusit. Pozicionet dhe lëvizjet, kur falemi konsiderohen si ushtrime për gratë shtatzana, sidomos gjatë javëve të fundit të shtatzanisë dhe janë shumë të rëndësishme për ta bërë më të lehtë lindjen natyrale.

I Madhëruar qoftë Allahu që na urdhëron të falemi, për të na dhënë rehati dhe lumturi! Allahu thotë: "**Urdhëroji njerëzit e tu të falin namaz dhe jini të ngulmët në të! Ne nuk kërkojmë prej teje ndonjë furnizim, Ne të furnizojmë** (ty dhe ata)**. Por fryti i Jetës së Ardhshme është për të devotshmit**." ("Ta – Ha", 132)

## Falja shëron probleme të shpinës

Problemet e shpinës janë përhapur për shkak të mbipërdorimit të makinave, të mosecjes, të mungesës së

lëvizjeve, të ngrënies shumë dhe të qëndrimit për shumë kohë para kompjuterit etj. Problemet e shpinës sjellin dhembje të mesit, dhembje të qafës, mpirje të gjymtyrëve dhe dhembje të krahëve dhe të këmbëve. Por, cili është ilaçi i ri? Një studim amerikan i kohëve të fundit ka zbuluar se ushtrimet e Jogës i pakësojnë dhembjet kronike të mesit. Të mirat e ushtrimeve të tilla nuk kufizohen vetëm në forcimin e muskujve të shpinës: ato forcojnë, gjithashtu edhe muskujt e barkut dhe pakësojnë shtypjen në shpinë.

Po të vëzhgojmë pozicionet e falësit të namazit, do të shohim se falja është shumë e dobishme për trajtimin e problemeve të shpinës. Prandaj, mjekët këshillojnë kryerjen e faljes dhe zbatim të përpiktë të rregullave të faljes. Allahu i Madhëruar thotë: "**Ata që janë të rregullt në faljen e namazit të tyre**." ("Mearixh", 23)

## Falja dhe qëndrueshmëria psikologjike

Ka ndikime psikologjike mahnitëse, sepse besimtari arrin përulësinë absolute, kur falet. Falja e ndihmon besimtarin të përqendrohet e të meditojë dhe kjo është metoda më e mirë për trajtimin e tensionit dhe të lodhjes nervore.

Falja është, gjithashtu, një ilaç i frytshëm për zemërimin, për nxitimin dhe për veprimet e pamatura, sepse ajo e mëson njeriun të jetë i qetë, i përulur dhe i bindur ndaj Zotit të Gjithëfuqishëm. Falja e mëson njeriun të jetë durimtar.

Ajo ka ndikim pozitiv në sistemin nervor, në funksionimin e zemrës e në organizimin e ritmit të zemrës e, edhe në qarkullimin e gjakut. Allahu i Madhëruar thotë: "**Ata që besojnë në të padukshmen, që janë të ngulmët në falje dhe që shpenzojnë nga ajo që Ne u kemi dhënë**." ("Bekare", 3)

## Falja aktivizon qelizat e trurit

Kur njeriu falet dhe i afrohet Krijuesit të tij me gjithë zemër, ndërsa imagjinon Xhenetin, Xhehenemin dhe ngjarjet e mëdha të Ditës së Gjykimit dhe mendon shumë për kuptimet e ajeteve, që ai këndon e me të cilat jeton, kjo lloj faljeje do të jetë edhe adhurim, edhe ilaç, ngaqë truri merr një sasi shumë të madhe informacioni dhe urdhrash kur'anorë.

Të tillë urdhra konsiderohen si forma të rimbushjes, të programimit dhe të riformimit të qelizave të dëmtuara. Allahu, i Madhëruari thotë: "**Prandaj, kryejeni namazin (**faljen**) rregullisht dhe jepeni zekatin rregullisht dhe bindjuni të Dërguarit, që të mund të mëshiroheni**!" ("Nur", 56)

## Falja dhe lutja

Studiuesit thonë se adhurimi dhe meditimi për një periudhë të shkurtër kohe çdo ditë pengon sëmundjet e pleqërisë dhe pakëson stresin dhe ankthin. Përveç kësaj, falja i jep njeriut siguri dhe më shumë dashuri e mëshirë, kurse ateizmi i sjell njeriut zemërim dhe ankesa për jetën, në njërën anë dhe dëmtim të vazhdueshëm të trurit, në anën tjetër.

Një studim, i bërë nga Rendolf Bërd (Randolph Byrd) në vitin 1988, solli zbulime të paparashikuara sepse tregoi se falja dhe lutja për të sëmurët me zemër përmirësojnë edhe gjendjen e tyre fizike, edhe gjendjen e tyre psikologjike. I Madhëruar është Allahu, i Cili na ka treguar rëndësinë e faljes dhe të lutjes.

Allahu thotë: "**O Zoti im! Më bëj mua nga ata që e falin namazin rregullisht e, edhe prej pasardhësve të mi** (bëji të tillë) **dhe pranoje faljen time o Zoti ynë**!" ("Ibrahim", 40)

## Rëndësia e faljes së agimit

Studimet vërtetojnë se falja e rregullt e namazit të agimit pakëson mundësinë e goditjes iskemike, sepse ngritja në mes të natës aktivizon qarkullimin e gjakut. Mjekët thonë se trupi i njeriut në kohën e agimit është në kulmin e veprimtarisë, kurse fjetja në këtë kohë ndikon negativisht në organizëm dhe mund të shkaktojë shumë probleme, si, p.sh., vdekje të papritur.

Allahu thotë për këtë: "**Fale namazin që nga mesdita e deri në errësirën e natës dhe fale namazin e agimit! Dhe këndo** (Kur'an), **sepse falja dhe këndimi** (i Kur'anit) **në mëngjes herët dëshmohen** (nga melekët)!" ("Isra", 78)

## Sekretet e faljes së namazit të natës (*kiamit*)

Në librin e tyre, "Proven Home Remedies and Natural Healing Secrets" (Ilaçet e provuara të shtëpisë dhe sekretet e shërimit natyror), 1993, një grup autorësh amerikanë pohojnë se kur ngrihesh nga shtrati natën dhe bën ushtrime të thjeshta brenda në shtëpi, bën veprime të lehta fizike, fërkon gjymtyrët me ujë dhe merr frymë thellë – të gjitha këto kanë disa të mira për shëndetin.

Studimet shkencore kanë provuar, gjithashtu se njerëzit që zgjohen për pak kohë natën dhe bëjnë ushtrime, nuk i ekspozohen vdekjes së papritur kur janë në gjumë. I Madhëruar është Allahu që na ka dërguar profetin Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), Profetin e mëshirës, i cili na ka udhëzuar të bëjmë më të mirën edhe për këtë botë, edhe për Botën Tjetër.

Profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) zgjohej natën, merrte abdes, falej dhe meditonte për mrekullitë e krijimit nga Allahu. Po ne, a po i ndjekim hapat e tij dhe a po veprojmë siç na ka udhëzuar ai? Allahu i Madhëruar thotë: "**Fale namazin që nga mesdita e deri në**

**errësirën e natës dhe fale namazin e agimit! Dhe këndo** (Kur'an), **sepse falja dhe këndimi** (i Kur'anit) **në mëngjes herët dëshmohen** (nga melekët)!" ("Isra", 78)

## Kur shkohet më këmbë në xhami

Të gjitha studimet mjekësore të kohëve të fundit theksojnë rëndësinë e ecjes më këmbë për shërimin e shumë sëmundjeve, ku, ndër më kryesoret janë tensioni i gjakut, sëmundjet e zemrës dhe diabeti. Përveç këtyre, ecja më këmbë ditë për ditë, për gjysmë ore ndihmon për të përmirësuar dhe organizuar funksionimin e zemrës, përmirëson gjendjen shpirtërore të njeriut, vë në lëvizje muskujt dhe largon shqetësimet e përditshme të jetës, ankthin dhe depresionin.

Profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) qe kaq mirëdashës: i mësoi dhe i nxiti myslimanët të shkonin më këmbë në xhami. Ky është një veprim për të cilin myslimanët shpërblehen shumë. Imam Myslimi kumton se i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: "*Njeriu që do të marrë shpërblimin më të madh për namazin, është ai, i cili bën rrugën më të largët për t'u falur në xhami*".

## Falja për trajtimin e plakjes së parakohshme

Studiuesit pohojnë se njerëzit duhet të bëjnë më shumë veprimtari fizike. Një studim i bërë nga disa studiues nga "King's College" - universitet britanik prestigjioz, ka zbuluar se mungesa e veprimtarisë fizike mund të çojë në plakje të parakohshme.

Pas testimit të një numri shumë të madh binjakësh, studiuesit zbuluan se ata që bënin rregullisht veprimtari fizike, dukeshin më të rinj se shokët e tyre që nuk bënin veprimtari të tilla. Nga vëzhgimet ka dalë, gjithashtu se

njerëzit që bëjnë veprimtari të rregullta fizike, sidomos ata që e falin namazin fiks në kohën e caktuar, janë më pak të prirur për të shfaqur simptomat e plakjes së parakohshme. Atëherë, ne duhet ta kuptojmë përse Allahu na urdhëron ta falim namazin fiks në kohën e caktuar. Pa dyshim, falja është veprimi më i dashur për Allahun.

# Njeriu dhe përgjegjësia në Kur'an[1]


## Abstrakt

*Allahu e ka caktuar njeriun mëkëmbës në Tokë. Kjo do të thotë që Allahu e ka përveçuar njeriun nga të gjitha krijesat e tjera. Njëherësh kjo tregon nderimin e madh dhe besimin që ka Allahu te njeriu. Atëherë njeriu ka përgjegjësi para Allahut, para shoqërisë dhe para vetes. Islami i organizon përgjegjësitë, duke e bërë çdo njeri përgjegjës, si për vete, ashtu dhe për të tjerët. Jeta nuk mund të organizohet pa përgjegjësi. Islami e edukon njeriun përmes lidhjes së tij me Allahun, Krijuesin e kësaj ekzistence, në mënyrë që ta bëjë atë të ndihet përgjegjës dhe të zhvillojë brenda vetes fuqinë e ndërgjegjes. Allahu i Lartësuar thotë:*

***"Sikur të kishte dashur Allahu, do t'ju kishte bërë një popull të vetëm, por Ai çon në humbje kë të dojë dhe udhëzon në rrugë të drejtë kë të dojë. E ju, gjithësesi, do të përgjigjeni për atë që keni bërë."*** (16: 93)


Allahu i Plotfuqishëm thotë:

**"Në të vërtetë, Ne i kemi nderuar bijtë e Ademit: ua kemi bërë të mundur që të udhëtojnë në tokë dhe në det."** (Isra:70)

Njeriu dallohet nga qeniet e tjera për shkak të diturisë së tij, vullnetit dhe të qënit një mëkëmbës, i cili i mban përgjegjësitë dhe e meriton një dallim të tillë. Për të është shpallur fjala e Allahut, Mëshirëplotit. Vlera dhe respekti i tij, në krahasim me krijesat e tjera, tregon nderimin e madh dhe besimin që i është dhuruar atij. Kjo përgjegjësi tregon që pozita e tij është forcuar dhe është ngritur duke i dhënë atij më shumë rëndësi dhe vlerësim.

1. *Marrë nga "**Balagh Foundation**".*

Në të vërtetë, njeriu nuk konsiderohet as një qenie e neglizhuar, as diçka e pavlerë në jetë për shkak të zotërimit të diturisë, të vullnetit dhe të aftësisë. Ai e përdor vullnetin dhe aftësinë e tij për të bërë një zgjedhje apo për të ndërmarrë një vendim.

Prandaj, ai është i përgjegjshëm për veprat dhe sjelljen e tij në përputhje me rrethanat. Allahu i Lartësuar thotë:

**"Sikur të kishte dashur Allahu, do t'ju kishte bërë një popull të vetëm, por Ai shpie në humbje kë të dojë dhe udhëzon në rrugë të drejtë kë të dojë; e ju, gjithësesi, do të përgjigjeni për atë që keni bërë."** (Nahl: 93)

Islami përcakton dy përgjegjësi për njeriun: përgjegjësitë individuale dhe ato kolektive. Lidhur me përgjegjësitë individuale, ai është shumë përgjegjës për veten e tij. Allahu i Lartësuar i drejtohet atij:

**"Po, vërtet që njeriu do të dëshmojë kundër vetvetes, edhe sikur të paraqesë shfajësimet e veta."** (Kiame:14-15)

Ky ajet i referohet qenies së njeriut të përgjegjshëm para Allahut për fjalën e tij, sjelljet dhe veprat e tij. Ai do të gjykohet nga Allahu në Ditën e Kiametit, Dita e dhënies së drejtësisë dhe e ndëshkimit.

Të gjitha këto ekzistojnë që të kryhet lidhja e tij me Zotin në mënyrë të drejtpërdrejtë e gjithashtu për të gjykuar veten e tij para Zotit. Ai është krijuar në mënyrë që të kuptojë të metat dhe përgjegjësitë e veta. Si të tilla, qëndrimet negative duhet të korrigjohen vetvetiu.

Allahu i Plotfuqishëm thotë:

**"Dhe që, kur japin atë që japin, zemrat e tyre i kanë plot frikë, ngaqë do të kthehen te Zoti i tyre, ata nxitojnë të bëjnë vepra të mira dhe për këto punë janë të parët.**

**Ne nuk ngarkojmë askënd përtej mundësive të tij; te Ne është Libri që flet të vërtetën dhe askujt nuk do t'i bëhet padrejtësi."** (Mu'minunë:60-62)

Imam Kadhimi ka thënë: *"Ai që nuk e gjykon veten e tij/saj përditë, nuk është prej Nesh; nëse dikush bën një vepër të mirë,*

*Allahu do ta shumëfishojë atë, ndërsa në qoftë se ai bën një vepër të keqe, Allahu ia fal atij…"*[2]

Islami synon të edukojë forcën e ndërgjegjes në shpirtin e njeriut dhe të zhvillojë virtytin e përgjegjësinë personale. Kështu, për t'u bërë një mbrojtës për gjykimin e vetes dhe të jetë i vetëdijshëm se njeriu është përgjegjës për Ditën e Ringjalljes që Allahu ka dhënë. Secili është përgjegjës për pronën që ai zotëron, nga e ka prejardhjen kjo pronë dhe si e përdor ai atë.

Njeriu është gjithashtu përgjegjës edhe për dituritë që ai merr dhe aftësitë të cilat përdoren para Allahut. A i përdor njeriu ato për përfitim vetjak apo për përfitimin e përgjithshëm të shoqërisë? A i shfrytëzon ato njeriu për qëllime korruptive, për praktika të dëmshme shkatërruese, për nxitjen e përkrahjen e vetvetes dhe të interesave të tij? Njeriu është përgjegjës për inteligjencën që Allahu i ka dhënë atij. Ai është gjithashtu përgjegjës për forcën që Allahu i ka dhënë atij. A është vënë kjo forcë në shërbim për mirësi duke ndjekur rrugën e drejtë? Njeriu është përgjegjës për fuqinë dhe pozitën shoqërore, të cilat Allahu i ka dhuruar atij. Njeriu do të pyetet për gjuhën, të cilën Allahu i ka dhuruar atij, se si e ka përdorur atë. A e përdori atë për të thënë fjalën e mirë, apo e përdori për të mashtruar, për të përgojuar, për gënjeshtra dhe për fyerjen e të tjerëve?

Në mënyrë të ngjashme, ai do të pyetet për shqisën e të parit, sytë, të cilat Allahu ia ka dhënë atij dhe për çfarë qëllimi i ishin dhuruar ato. A i përdori ato për të lexuar libra dhe për të marrë njohuri duke respektuar madhështinë e Allahut, apo i përdori për të parë atë që Allahu e ka ndaluar?

Njeriu do të merret në pyetje mbi shqisën e dëgjimit. A janë shfrytëzuar veshët për të dëgjuar fjalën e udhërrëfimit, diskutimet edukative dhe frytdhënëse?

Allahu i Plotfuqishëm thotë:

2. Përshkruar nga Imam el - Kadhim, në el- Wasa'il al- Shi'a, Amili , vëll . 11, f.377 3- Bukhari, Sahih el- Muslim, vol. 2, f.6.

**"...Mos shko pas diçkaje për të cilën nuk ke dijeni. Vërtet, dëgjimi, shikimi dhe zemra, të gjithë këta do të merren në përgjegjësi."** (Isra:36)

**"Dhe, për çdo fjalë që ai thotë, ka pranë vetes një mbikëqyrës të gatshëm** (për ta shënuar atë)**."** (Kaf:18)

**"Dhe ndalini ata, sepse do të merren në pyetje."** (Saffatë:24)

**"Ai nuk mund të pyetet lidhur me atë që bën, kurse ata do të merren në pyetje."** (Enbija:23)

Njerëzit do të pyeten për çdo gjë që ata bëjnë, qoftë e vogël apo e madhe.

**"Të mjerët ne! Çfarë është ky libër që nuk paska lënë asnjë vepër të madhe apo të vogël pa e shënuar atë! Aty do të gjejnë të shënuar gjithçka që kanë punuar."** (Kehf:49)

Islami i detyron me ligj përgjegjësitë individuale para Allahut dhe gjithashtu përgjegjësitë individuale para shtetit Islam, drejtuar sipas ligjeve islame. Shpallja e ligjeve islame është për të mbrojtur interesat e komuniteteve myslimane, për të mbrojtur mirëqenien e njerëzimit dhe zhvillimin e saj.

Allahu i Plotfuqishëm thotë:

**"O besimtarë! Bindjuni Allahut, bindjuni të Dërguarit dhe atyre që drejtojnë punët tuaja."** (Nisa:59)

Meqë njeriu është përgjegjës para shtetit legjislativ, i cili ka të drejtën e qeverisjes, ai ka edhe të drejtën e dërgimit të tij para gjykatës dhe të drejtën e ndëshkimit në rast të shkeljes së ligjeve dhe rregullave.

Prandaj, një shtet islamik ka të drejtën për të ndërhyrë në çështjet individuale, sociale dhe ekonomike, në mënyrë që të arrihet një shoqëri e barabartë. Ka të drejtën për të ngarkuar dhe për të kufizuar veprimet e njeriut të cilat bien ndesh me interesin e përgjithshëm.

Në raste të jashtëzakonshme, shteti islamik ka gjithashtu të drejtën për të parandaluar sjellje të ndaluara dhe për të vepruar kundër kujtdo që braktis detyrimet e tij.

Ka të drejtë të imponojë detyra të caktuara mbi njeriun

ose ta detyrojë atë të punojë në një fushë të caktuar, ta ndëshkojë atë në rastin e kryerjes së vrasjes së tjetrit, të pirjes së alkoolit, të mashtrimit etj. Individi nuk ka të drejtë të sillet ose të bëjë diçka pa përgjegjësi. Ai duhet të mendojë dhe ta ndiejë se është përgjegjës si para Allahut, ashtu dhe para shtetit ligjor.

Nëpërmjet mbajtjes së përgjegjësive tona, bazuar mbi ligjet dhe vlerat islame, mund të krijohet një shoqëri, ku siguria, paqja sociale dhe mirëqenia ekonomike do të jenë të qëndrueshme. Pa këto përgjegjësi, jeta kthehet në kaos, roli i drejtësisë dhe i ligjit zhduket dhe shoqëria kthehet në një shoqëri tiranike.

Islami i organizon përgjegjësitë duke e bërë çdo njeri përgjegjës, si për vete, ashtu dhe për të tjerët. Prandaj, një baba është përgjegjës për fëmijët e tij, një bari për kopenë e tij dhe një guvernator për nënshtetasit e tij.

Secili ka përgjegjësitë e tij të vendosura sipas pozitës në shoqëri, siç thotë dhe i Dërguari i Allahut (paqja qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!):

*"Të gjithë janë rojtarë dhe janë përgjegjës për ata që i kanë në kujdestarinë e tyre."*

Imam Aliu e përshkruan këtë përgjegjësi në letrën e tij drejtuar Malik al-Ashtar duke thënë:

*" ... kështu, zgjatni dorën e pajtimit dhe të faljes për ta, në të njëjtën mënyrë siç do të donit që Allahu t'ju ofronte faljen e Tij për ju, sepse ju jeni mbi ta dhe udhëheqësi i juaj përgjegjës (Imami ) është mbi ju, ndërsa Allahu është mbi atë që ju ka emëruar ju. Ai (Allahu) ka kërkuar që ju të administroni dhe të drejtoni punët e tyre dhe ju ka provuar nëpërmjet tyre..."*[3]

Jeta nuk mund të organizohet pa përgjegjësi. Imam Aliu shpjegon se myslimanët në njërën anë janë përgjegjës para atyre të cilët marrin përgjegjësi, ndërsa në anën tjetër, ata (të cilët marrin përgjegjësi) vetë janë përgjegjës edhe para udhëheqësit të tyre (Imamit).

3. Imam Aliu, Nahj al - Balaghah , përpiluar nga Dr Subhi Salih , f.426

Imami vetë është përgjegjës para Allahut, si për myslimanët, ashtu dhe për ata që marrin përgjegjësi. Allahu i Lartësuar thotë:

**"Besimtarët dhe besimtaret janë miq me njëri-tjetrin. Ata urdhërojnë që të bëhen vepra të mira dhe i ndalojnë të këqijat."** (Teube:71)

Të gjitha këto udhëzime janë bërë për të përmbushur përgjegjësitë për të ndërtuar shtetin dhe shoqërinë mbi themele të barabarta të të drejtave dhe të detyrimeve. Islami e konsideron njeriun përgjegjës për veprimet e veta dhe për veprimet e të tjerëve. Ai e shtyn drejt reformimit të shoqërisë duke mbajtur qëndrim kundër të gjitha llojeve të korrupsionit: moral, politik, ekonomik, shoqëror... etj. Islami e krahason shoqërinë me një anije që transporton pasagjerët e saj në mes të detit dhe në të cilën të gjithë janë përgjegjës për ta mbrojtur atë, sepse nëse do t'i ndodhte diçka anijes, të gjithë do të mbyteshin dhe do të shkatërroheshin.

I Dërguari i Allahut (paqja qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) i përshkruan përgjegjësitë e ndërsjellta:

*"Shembulli i atij që përcakton kufijtë e Allahut dhe pastaj i kundërshton ato është si njërëzit të cilët ishin duke udhëtuar së bashku në një anije. Ndodhi që disa prej tyre u vendosën në pjesën e sipërme, ndërsa të tjerët u vendosën në pjesën e poshtme të saj. Ata që ndodheshin në pjesën e poshtme, duke kërkuar ujë, u afruan tek ata që ishin mbi ta. Ata që ndodheshin lart, u thanë: Ne nuk do t'ju lejojmë për të marrë ujë, sepse ju kështu do të na dëmtoni. Në përgjigje të tyre, ata të cilët ndodheshin poshtë thanë: Ne mund të bëjmë një vrimë në pjesën e poshtme të anijes pa i lënduar ata sipër nesh. Në këtë rast, në qoftë se ata i lejonin të bënin atë çka donin, të gjithë do të mbaronin duke u mbytur, ndërsa në qoftë se do t'u jepnin një dorë (do t'i ndihmonin), të gjithë do të shpëtonin."*[4]

Në përmbushjen e detyrimeve, ekziston një detyrim bashkëpunues, për të cilin, njeriu nuk është drejtpërdrejt

4. Sunnan el- Tirmidhi, Kitab al- Fitan, vol. 4, f.470, Haditi nr 2173

përgjegjës për veprimet e kryera nga të tjerët, por që të gjithë kanë disa përgjegjësi dhe do t'u kërkohet llogari për të. Prandaj nuk është e lejuar për individët që të varen nga të tjerët për të kryer detyra dhe veprime të cilat kanë një natyrë bashkëpunuese, si ofrimi i asaj që është e drejtë dhe ndalimi i asaj që është e gabuar.

Për shembull, në qoftë se ndodh që disa të shfajësojnë veten për të qenit të paaftë për të kryer funksione të caktuara kundër korrupsionit dhe krimit, në këtë rast, përgjegjësia do të jetë e drejtuar tek ata që tërhiqen, duke neglizhuar detyrën e tyre bashkëpunuese dhe duke mos marrë pjesë në mbrojtjen e Islamit si një besim dhe si një rrugë e drejtë për jetën.

Islami e edukon njeriun përmes lidhjes së tij me Allahun, Krijuesin e kësaj ekzistence, në mënyrë që ta bëjë atë të ndihet përgjegjës dhe të zhvillojë brenda vetes fuqinë e ndërgjegjes së brendshme dhe të ndjeshmërisë.

Allahu i Lartësuar thotë:

**"Betohem në Ditën e Kiametit! Jo! Betohem në shpirtin qortues!"** (Kiame:1-2)

Profeti Muhamed (paqja qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë:

*"Gjykojeni veten tuaj para se të tjerët t'ju gjykojnë ju."*

*"Asnjë këmbë shërbëtori (i Allahut), (në Ditën e Gjykimit) nuk do të lëvizë përpara se të pyetet për katër gjëra: vitet e tij (mosha) dhe se si i kaloi ato, rininë e tij dhe se si e ka konsumuar atë, pasurinë e tij dhe se si ai e ka fituar atë dhe për çfarë e ka shpenzuar dhe për dashurinë e tij ndaj nesh, Ehlul - Beit (Familjarët e Profetit)."* [5]



5. Sayuti, ' Ihja al - Mayyit, Haditi nr 44.
51 View | 2011/10/03 | 00:59

# Pozita e prindërve në Kur'an[1]

## Abstrakt

*Qëkur lind, njeriu fillon të bashkëveprojë dhe të krijojë marrëdhënie me njerëzit përreth tij. Të parët janë prindërit. Prindërit luajnë një rol të rëndësishëm për rritjen dhe edukimin shpirtëror dhe mendor të fëmijëve të tyre. Në kulturën islame, prindërit kanë një pozitë shumë të lartë.*

*Allahu thotë:* ***"Thuaju: 'Ejani t'ju lexoj çfarë ju ka urdhëruar Allahu: që të mos i bëni shok Atij askënd e asgjë*** *(në adhurim)* ***dhe të silleni mirë me prindërit.'"*** *Prindërit kanë një ndikim të madh në qenien e fëmijëve të tyre. Kjo është arsyeja pse Allahu na ka urdhëruar vazhdimisht në Kur'an të jemi të mirë e të sjellshëm me prindërit tanë.*

Që kur lind, njeriu fillon të bashkëveprojë dhe të krijojë marrëdhënie me njerëzit përreth tij. Të parët janë prindërit. Prindërit luajnë një rol të rëndësishëm për rritjen dhe edukimin shpirtëror dhe mendor të fëmijëve të tyre. Në kulturën kur'anore të Islamit, prindërit janë të vlerësuar të kenë një pozitë shumë të lartë. Ne duhet t'i trajtojmë prindërit me respekt dhe me nderim.

## Raporti i fëmijëve me prindërit e tyre

Lidhja më e rëndësishme mes njerëzve mund të duket qartë në marrëdhëniet fëmijë-prindër. Ne nuk mund të marrim marrëdhëniet e ndërsjellta si një standard për të vlerësuar një lidhje të tillë.

1. Marrë nga *www.almaaref.org.*

Kjo ndodh pasi fëmijët nuk mund të kenë të njëjtin ndikim mbi prindërit e tyre, ashtu siç kanë prindërit mbi to. Fëmijët u detyrohen prindërve të tyre për qenien dhe ekzistencën e tyre, por prindërit nuk janë borxhli ndaj fëmijëve për qenien e tyre.

Prandaj, marrëdhëniet prindër - fëmijë, nuk mund të maten në bazë të parimit të drejtësisë dhe të barazisë, që nënkupton të drejta reciprokisht të barabarta. Drejtësia apo paanësia mund të jetë e vërtetë vetëm kur dy njerëz kanë të njëjtat marrëdhënie reciproke dhe të drejta të barabarta. Marrëdhëniet e ndërsjellta të barabarta sjellin ose prodhojnë të drejta dhe detyrime të barabarta. Kudo që ka të drejta të njëjta dhe detyrime të ndërsjellta, duhet të ketë ndikime reciproke të njëjta.

Prindërit, megjithatë, kanë një ndikim kaq të madh në qenien e fëmijëve të tyre, saqë nuk mund të kompensohen dhe të vlerësohen nga fëmijët. Kjo është arsyeja pse Allahu na ka urdhëruar vazhdimisht në Kur'an të jemi të mirë e të sjellshëm me prindërit tanë. Ai e ka konsideruar këtë çështje si parim kryesor të vlerësimit të marrëdhënieve fëmijë -prind. Nuk ka asnjë ajet në Kur'an që i urdhëron fëmijët t'i trajtojnë prindërit e tyre me drejtësi dhe barazi, pasi drejtësia dhe barazia në një marrëdhënie të tillë do të ishte jonormale.

Në shumë ajete të Kur'anit, fëmijët janë urdhëruar të jenë të mirë dhe të sjellshëm me prindërit e tyre. Kjo tregon se të drejtat e prindërve mbi fëmijët e tyre janë shumë të mëdha për të qenë të barabarta mes anëtarëve të tjerë të shoqërisë. Prandaj, të drejtat e vërteta të prindërve janë unike në llojin e tyre. Kjo është arsyeja pse detyrimet e fëmijëve ndaj prindërve të tyre nuk kanë asgjë tjetër të barabartë për t'u krahasuar. Prindërit, megjithatë, mund të kenë të drejta të tjera të ndryshme nga amësia dhe atësia mbi fëmijët e tyre të cilat mund të jenë me vlerë të barabartë në lidhje me anëtarë të tjerë të shoqërisë.

Për sa i përket të drejtave të prindërve dhe detyrimeve përkatëse të fëmijëve ndaj tyre, Kur'ani përmban disa thënie të bukura që tregojnë rëndësinë e kësaj çështjeje.

Allahu, në Kur'an, thotë:

**"Adhuroni Allahun dhe mos i shoqëroni Atij asgjë (në adhurim); silluni mirë me prindërit, të afërmit,..."** [1]

Pas urdhërimit për adhurimin e Allahut dhe ndalimin e shirkut (politeizmit), Allahu na ka urdhëruar menjëherë të jemi të mirë dhe të sjellshëm me prindërit tanë. Kjo tregon madhështinë e pafundme të të drejtave të prindërve mbi fëmijët e tyre.

Në një ajet tjetër, Allahu thotë:

**"Thuaju: 'Ejani t'ju lexoj çfarë ju ka urdhëruar Allahu: që të mos i shoqëroni Atij asgjë (në adhurim); që të silleni mirë me prindërit.'"** [2]

**"Zoti yt ka urdhëruar, që të mos adhuroni askënd tjetër përveç Atij dhe të silleni mirë me prindërit."** [3]

Detyra më e lartë, e cila i është adresuar njeriut, është që të adhurojë Allahun. ***"Kada"*** , duke qenë një fjalë e vetme për të cilën nuk ka shprehje, madje asnjë urdhëresë tjetër që mund të jetë e ngjashme, vërteton peshën që ka çështja. Duke përdor fjalën***"Kada"***, Allahu, më tej, vazhdon të thotë: "Mirësia ndaj prindërve", që tregon se mirësia ndaj prindërve, pas adhurimit të Allahut, është urdhëruar në mënyrë të vendosur nga Allahu.

Më lart u paraqit një linjë e përgjithshme e sjelljes sipas Kur'anit. Për këtë arsye, pas adhurimit të Allahut dhe ndalimit të shirkut (politeizmit), mirësia ndaj prindërve konsiderohet si detyra më thelbësore e njerëzimit në Islam. Ajeti i lartpërmendur, megjithatë, ka karakteristika dalluese dhe theks të veçantë mbi këtë çështje.

Me këtë nxitje dhe urdhëresë të shkëlqyer të Kur'anit në lidhje me prindërit, disa mund të mendojnë se fëmijët janë të detyruar që në mënyrë absolute të dorëzohen para prindërve të tyre dhe t'u binden atyre pafundësisht.

Duke korrigjuar një iluzion të tillë, Allahu thotë:

**"Ne e kemi urdhëruar njeriun, që të sillet mirë me prindërit e vet dhe: 'Nëse ata të nxisin ty që të më shoqërosh Mua (në adhurim) atë, për të cilin ti nuk ke asnjë njohuri, atëherë mos i dëgjo dhe mos iu bind atyre.'"** [4]

Shprehja *"Nëse ata të nxisin ty..."* na këshillon se ne jemi të detyruar t'u bindemi prindërve tanë për aq kohë sa ata nuk na drejtojnë drejt kufrit (mosbesimit). Njëkohshmëria e dy çështjeve zbulon se sa larg duhet të shkojë përulja e njeriut dhe nderimi për prindërit.

## Kur'ani dhe përparësia e nënës

Duke miratuar të drejtat e padiskutueshme të prindërve, të cilat duhet të kompensohen nga fëmijët, shumë ajete të Kur'anit vazhdojnë të përmendin punët e vështira dhe serioze të kryera nga nënat. Në suren "Lukman", Allahu thotë:

**"Ne e kemi urdhëruar njeriun që t'i nderojë prindërit e vet. Nëna e ka mbartur atë, duke duruar mundim pas mundimi, e ndarja e tij (nga gjiri) është brenda dy vitesh. Ne i thamë atij: 'Bëhu falënderues ndaj Meje dhe prindërve të tu! Tek Unë do të ktheheni të gjithë.'"**[5]

Ky ajet ka theksuar dhe ka trajtuar thellësisht të drejtat e nënës, që dihet se janë më të shumta dhe më të larta se ato të babait. Ajeti i parë na urdhëron lidhur me prindërit tanë, por të gjitha fjalët e tjera na kujtojnë të drejtat e nënës dhe mundimet e saj të vështira të shtatzanisë, ushqyerjes me gji dhe edukimit e rritjes së fëmijëve. Ajeti ka për qëllim të zbulojë urtësinë se përse prindërit, e veçanërisht nëna, duhen vlerësuar shumë. Pastaj, si një formulim i paimitueshëm dhe i mrekullueshëm i Kur'anit, vjen shprehja ***"Më falënderoni Mua dhe prindërit tuaj."*** Allahu na urdhëron ta falënderojmë së pari Atë dhe pastaj, menjëherë na urdhëron t'i falënderojmë prindërit tanë. E bukura qëndron se është përdorur vetëm një folje, *"Falënderim"*, për të dy – edhe për

Allahun, edhe për prindërit. Kjo tregon se falënderimet e dhëna për Allahun nuk janë të ndara nga ato për prindërit. Si edhe, ajo zbulon të drejtat e mëdha të prindërve në sytë e Kur'anit. Me një ndryshim të vogël në ajetin vijues, më lart është thënë: ***Nëse ata ju nxisin që t'i shoqëroni Allahut shok, atëherë mos e dëgjoni dhe mos iu bindni atyre***.

**"Nëse ata orvaten, që të më shoqërosh Mua (në adhurim) diçka, për të cilën ti nuk ke dijeni, mos i dëgjo, por sillu mirë me ata në këtë jetë dhe ndiq rrugën e atij që drejtohet tek Unë me devotshmëri; pastaj, tek Unë do të ktheheni dhe Unë do t'ju lajmëroj për atë që keni bërë."**[6]

Ata prindër, të cilët, jo vetëm që sugjerojnë, por edhe nxisin dhe u bëjnë thirrje fëmijëve të tyre që t'i shoqërojnë Allahut shok, në mënyrë të natyrshme këmbëngulin në qëndrimin e tyre politeist. Megjithatë, Kur'ani na urdhëron të jemi të mirë dhe të sjellshëm me ta në këtë botë, por të mos i ndjekim ata në thirrjen e tyre politeiste.

Në një ajet tjetër, thuhet: **"Njeriun e kemi porositur të jetë i sjellshëm ndaj prindërve të vet. Nëna e mbart atë me mund dhe me mund e lind. Ai mbartet dhe ushqehet me gji për tridhjetë muaj..."**[7]

Ky ajet përmend vuajtjet që shkaktohen nga sjellja në jetë e fëmijës, pra dhimbjet e lindjes dhe të shtatzënisë për nënat tona, për të na kujtuar se të drejtat e nënës janë më të shumta dhe më të madha se ato të babait. Kështu, ne duhet të vlerësojmë ekzistencën e saj dhe të mos harrojmë të drejtat e saj.

## Këshilla të veçanta lidhur me prindërit

Ajetet e lartpërmendura na urdhërojnë të jemi të mirë dhe të sjellshëm ndaj prindërve në përgjithësi. Megjithatë, ka një tog tjetër me vargje që tregojnë respekt të madh për një person të veçantë a për një grup ose që janë të sjellshëm me prindërit e tyre:

**"Kujtoni kur Ne morëm besën tuaj, o bijtë e Izraelit, se do të adhuroni vetëm Allahun, do të silleni mirë me prindërit, të afërmit, jetimët dhe të varfrit..."** [8]

Për shkak të tipareve të tij të mira, duke përfshirë këtu dhe mirësinë ndaj prindërve, Jahjai është vlerësuar shumë nga Allahu:

"(Pasi lindi djali, iu tha)**: 'O Jahja, rroke fort Librin (Teuratin).' Dhe Ne, kur ende ishte fëmijë, i dhamë mençuri, butësi prej Nesh dhe dëlirësi. Ai ishte besimtar i përkushtuar dhe i sjellshëm ndaj prindërve të vet, nuk ishte i ashpër dhe i padëgjueshëm. Paqja qoftë mbi të ditën kur ka lindur, ditën kur të vdesë dhe në ditën kur do të ringjallet."** [9]

Mirësia ndaj prindërve është një nga karakteristikat e lavdërueshme të Jahjasë që përmendet në Kur'an. Allahu, në Kur'an, thotë se Isai fliste që në djepin e tij dhe parashikoi misionin e tij profetik dhe të ardhmen. Në Kur'an thuhet: **"Dhe më ka bërë të bekuar kudo që të jem. Ai më ka porositur që të falem e të jap zekat sa të jem gjallë dhe që të jem i mirë ndaj nënës sime dhe nuk më ka bërë të ashpër dhe të padëgjueshëm."**[10]

Për shkak se nuk kishte baba, Isai (paqja qoftë mbi të!) foli vetëm për dashamirësinë ndaj nënës së tij.

## Modele të mirësisë ndaj prindërve

**"Ju është urdhëruar që, nëse ndonjërit prej jush i afrohet vdekja dhe ka pasuri për të lënë pas, atëherë të lërë testamentin në mënyrë të drejtë për prindërit dhe farefisin; ky është detyrim për besimtarët e devotshëm."**[11]

Juristët dhe përkthyesit mendojnë se ky ajet është shpallur para ajeteve të trashëgimisë. Përderisa ndonjë pjesë e trashëgimisë për prindërit nuk ka qenë e saktësuar deri në atë kohë, Allahu jep urdhër për fëmijët që të caktojnë një pjesë të pasurisë së tyre për prindërit.

Megjithatë, mund të thuhet se trashëgimia për prindërit ende ishte e dëshirueshme, madje edhe pasi ajetet e trashëgimisë ishin shpallur. Kjo dëshmon se vendimi në lidhje me ajetin e lartpërmendur nuk është shfuqizuar, ose më saktë, është mirë që të lësh trashëgim diçka më tepër si pjesë që i takon prindërve. Një trashëgim i tillë është një akt i mirësisë ndaj prindërve. Prandaj, këshillohet për të gjithë të lënë diçka trashëgimi p.sh., një të tretën e pasurisë për prindërit. Kjo është një dëshmi tjetër që tregon rëndësinë e të drejtës së prindërve.

Në një ajet tjetër, Allahu thotë: **"Të pyesin ty çfarë të japin si lëmoshë. Thuaju: 'Çfarëdo bamirësie që bëni, ajo le t'u takojë prindërve, farefisit, jetimëve, të varfërve…'"**[12]

Prindërit, në këtë ajet, janë përmendur para të gjithë të tjerëve, që do të thotë, se nëse ata janë në nevojë, ata radhiten para të gjithë të tjerëve.

Të gjitha ajetet e mësipërme e kanë vënë theksin në mirësitë financiare, edhe pse ajete të tjera urdhërojnë apo nxisin mirësinë në trajtimin e prindërve:

**"Zoti yt ka urdhëruar, që të mos adhuroni askënd tjetër përveç Atij dhe që të silleni mirë me prindërit. Nëse njëri prej tyre ose të dy arrijnë pleqërinë tek ti, mos u thuaj atyre as 'Uh!', mos i kundërshto, por drejtoju atyre me fjalë respekti. Lësho para tyre krahët e përuljes prej mëshirës dhe thuaj: 'O Zoti im, mëshiroji ata, ashtu siç më kanë rritur, kur unë isha i vogël!'"** [13]

Pleqëria është periudha kur prindërit janë të dobët dhe të paaftë fizikisht dhe kanë nevojë për fëmijët e tyre. Fëmijëve u kërkohet moralisht dhe ligjërisht të kujdesen për ta dhe të respektojnë të drejtat e tyre. Kur ata janë të rinj, prindërit janë të pavarur financiarisht. Ata mund të punojnë më shumë se fëmijët e tyre dhe kështu bëjnë më shumë para se ata. Prindërit mund t'i ndihmojnë fëmijët e tyre. Por kur ata bëhen të moshuar, nuk mund të punojnë si të rinjtë.

Mund të vuajnë nga sëmundje dhe shqetësime të ndryshme të pleqërisë. Në një moshë të tillë, ata natyrshëm kanë nevojë për ndihmën e fëmijëve të tyre, të cilët duhet ta respektojnë dhe ta zbatojnë detyrën e tyre me durim.

Në kujdesjet e tyre për prindërit e moshuar, fëmijët mundet që në shumë raste të grinden ose të humbasin durimin e tyre. Duke iu referuar këtyre rasteve në veçanti, Kur'ani i urdhëron fëmijët që të jenë të durueshëm dhe tolerantë me prindërit e tyre. Asnjëherë të mos u thonë atyre edhe fjalën më të vogël për të shprehur shqetësim, si " uh! ", në mënyrë që prindërit të mos mendojnë se fëmijët janë të lodhur prej tyre.

Pastaj, Kur'ani thotë: **"Lësho para tyre krahët e përuljes prej mëshirës..."** Kur zogjtë duan të jenë të përulur ndaj atij që kujdeset për ta, ata ulin krahët e tyre mbi tokë. Allahu, në këtë ajet, thotë se kur ju jeni me prindërit tuaj, duhet të jeni si zogjtë e përulur, të thjeshtë dhe zemërbutë, por jo arrogantë. Kështu që, mos i ngrini supet e mos i trajtoni ata me ashpërsi.

**Ali Muhamed Ali Duhajjil - Dehili**

# Profeti Sulejman (paqja qoftë mbi të!)

**Abstrakt**

*Në këtë shkrim do të njiheni me historinë e profetit Sulejman* (paqja qoftë mbi të!). *Zoti i Madhëruar i ka sprovuar pejgamberët për t'ua ngritur vlerën e respektin, për t'ua lartësuar autoritetin dhe për t'ua mësuar njerëzve durimin dhe qëndrimin. Allahu thotë në Kur'an:* ***"Ne e sprovuam Sulejmanin." dhe "Rob shumë i mirë dhe shumë i kthyer nga Zoti."***

**1**

1. **"Ndërsa Sulejmanit** (ia nënshtruam) **erën e fortë."** ("El-Enbija", 81)

Sulejmani (paqja qoftë mbi të!) i është lutur Zotit të tij: **"O Zoti im, më fal** (gabimin)**, më dhuro pushtet, që askush pas meje të mos e ketë! Vërtet, Ti je Dhuruesi më i Madh."** ("Sad", 35)

Nuk ka dyshim se qëllimi kryesor i kësaj duaje ishte përhapja e Islamit në mbarë rruzullin tokësor dhe mbizotërimi i drejtësisë. Nga duaja e tij, ai pati mundësi t'i kontrollonte edhe xhindet, t'i përkufizonte veprimet e tyre, t'i përdorte në interes të njerëzve dhe kjo do të mjaftonte për t'u shërbyer njerëzve.

Zoti i Madhëruar ia nënshtroi robit dhe pejgamberit të tij, Sulejmanit (paqja qoftë mbi të!) njerëzit, xhindet dhe djajtë, të gjitha kafshët e pemët në tokë dhe disa fuqi të mëdha mbitokësore, si: **"Sulejmanit ia nënshtruam erën e fortë"** ose "**Sulejmanin e bëmë që ta kontrollonte erën e fuqishme."**

2. **"Edhe disa nga djajtë që zhyteshin** (në thellësi të ujit) (ia nënshtruam)**."** ("El-Enbija", 82)

Bejtul-Makdisi nuk ka qenë ndërtim që është dalluar nga bukuria e konstruksioni dhe gurët e çmueshëm me të cilët ishin zbukuruar muret e ndriçonin dhe nuk kishte nevojë për fenerë. Njerëzit që faleshin brenda kishin dritë prej gurëve të tillë të çmueshëm natën. Pjesa më e madhe e gurëve ishin nxjerrë nga deti, si, p.sh., nga diamantët, margaritarët etj. dhe djajtë ishin ata që i kishin nxjerrë nga uji: **"Dhe bënin edhe punë të tjera",** apo ata nuk e bënin vetëm këtë punë, por bënin edhe punë të tjera. **"I punonin atij çfarë të dëshironte: pallate të fortifikuara, skulptura, pjata** (të drunjta)**, si edhe sikurse rezervuarë, enë** (kazana) të palëvizshme..." ("Sebe", 13) Zoti i Madhëruar ia nënshtroi xhindet "…**dhe i ruante që të mos i iknin e të punonin për të."**

**2**

1. **"Ne u patëm dhënë Daudit dhe Sulejmanit dituri."** ("Neml", 15)

2. **"Ata të dy thanë: "Falënderojmë vetëm Allahun që na dalloi mbi shumë rob besimtarë."**

Dy pejgamberët e mëdhenj (paqja qoftë mbi ta!) falënderojnë vetëm Zotin për dhuntitë që u ka dhënë. Janë dhunti, (profetësia, dituria, mrekullitë dhe falënderimi i tyre) prej të cilave, duhet të marrë shembull çdo mysliman, që ta bëjë falënderimin simbol të tij dhe rrugë të orientimit të tij.

3. "**E, na është dhuruar nga gjithçka."**

4. (Sulejmani) tha: **"Zoti im, më mundëso që të të falënderoj për të mirat e Tua që m'i dhurove mua!"**

Vetëm robi i devotshëm e falënderon Zotin e Madhëruar për begatitë që ia ka dhënë: **"Nëse më falënderoni, do t'ua shtoj."** ("Ibrahim", 7)

6. "**E, me mëshirën Tënde, më fut në mesin e robve të Tu të mirë!".**

Ibn Abasi thotë: "Këtu nënkuptohen Ibrahimi, Ismaili, Is'haku, Jakubi dhe profetët e tjerë e që do të thotë: "Më fut në mesin e tyre, vendose emrin tim me emrat e tyre dhe më ringjall në grupin e tyre!".

Kjo dua duhet të jetë simbol i çdo myslimani besimtar, për të hyrë në mëshirën e Tij në mesin e njerëzve të mëdhenj dhe të ringjallet në grupin e besimtarëve. Nuk ka dua më të mirë e më të rëndësishme se kjo dhe atij që i pranohet kjo dua, përfiton mirësi të mëdha dhe lumturi të përhershme!

**3**

1. **"Edhe Sulejmanit ia nënshtruam erën, sa paraditja ishte sa një muaj** (udhëtim) **dhe pasditja e saj** (në të kthyer) **sa një muaj** (udhëtim)**".** ("Sebe", 12)

Zoti i Madhëruar ia pranon lutjen Sulejmanit (paqja qoftë mbi të!): **"Më dhuro pushtetin që askush pas meje të mos e ketë." (**"Sad", 35) Zoti i Madhëruar ia mundësoi pushtetin në Lindje e në Perëndim të Tokës dhe kur kishte nevojë për të shkuar në viset e largëta të territorit të vet për të parë punët dhe për t'i udhëzuar njerëzit, përdorte erën, që e kishte vënë Zoti i Madhëruar në shërbim të tij. Era i mbante atë dhe ushtarët e tij si anije kozmike dhe për një ditë kalonin largësinë që u duhej dy muaj për ta kaluar. Me ndihmën e erës, udhëtimi sa për një muaj bëhej për një ditë.

2. **"I bëmë që atij t'i rridhte burim i bakrit."**

Kur dëshiron Zoti i Madhëruar t'i japë diçka robit, ia përgatit terrenin dhe ia mundëson gjithçka që të jetë në shërbimin e tij. Zoti i Madhëruar i dha pushtet të madh Sulejmanit (paqja qoftë mbi të!), i nënshtroi erën, që e transportonte ku të dëshironte, që të mos i humbiste kontrolli mbi territorin e tij të gjerë. Ai kishte nevojë për enë për të përgatitur ushqim. Për këtë arsye, iu lut Zotit të Madhëruar që ta ndihmonte. Zoti i dha burimin e bakrit.

3. **"Dhe me urdhrin e Zotit të tij, ia nënshtruam xhindet që punonin sipas dëshirës së tij."**

Xhindet vepronin sipas udhëzimeve të Sulejmanit (paqja qoftë mbi të!) në bazë të këtij dominimi mbi ta.

4. **"I bënin atij çfarë dëshironte: pallate të fortifikuara".**

Pallatet ishin vende ku adhurohej Zoti i Madhëruar dhe quheshin "mihrabe" për shkak se ai që falej aty, ishte në luftë me djallin. Ndër veprimtaritë e tyre për Sulejmanin (paqja qoftë mbi të!) ishin: Bejtul-Makdisi u bë nga bakri, qelqi e mermeri. U bënë edhe pjata si rezervuare për ujë. Meqë kishte ushtri të madhe, Sulejmani kishte nevojë për enë të mëdha që t'u siguronte ushqim e pije në atë thatësirë. Enët ishin të mëdha e të palëvizshme. Vetëm një enë e madhe ushqente një mijë njerëz.

5. **"Veproni duke falënderuar, o familje e Daudit."**

Zoti i Madhëruar kërkon prej robve të Tij që të falënderojnë edhe njëri-tjetrin. **"Më falënderoni Mua! Falënderoni dhe prindërit tuaj!"** ("Llukman", 14) Ai që nuk falënderon krijesën, nuk falënderon as Krijuesin. Falënderimi krijon respekt e nder të ndërsjellë në mes njerëzve, shmangen problemet në mes tyre, mbizotëron paqja. Prandaj kanë ardhur pejgamberët. Nga ajeti nënkuptohet që duhet të jesh mirënjohës ndaj Zotit dhe ndaj prindërve të tu për të mirat që ke.

6. **"E, nga robtë e mi, pak janë mirënjohës."**

Kështu veprojnë njerëzit ngase mendojnë se e mira është prej tyre, ndërsa e keqja prej tjetërkujt. Ata duan që t'i shijojnë të mirat e Zotit, të hanë nga risku i Zotit, e pastaj, i drejtohen tjetërkujt edhe pse për Zotin kanë nevojë dhe prej Tij kërkojnë vetëm të mira.

7. **"E, kur ia caktuam atij vdekjen."**

Sado i fuqishëm dhe i aftë të jetë njeriu, përsëri është krijesë e dobët, madje shumë e dobët. Edhe jeta e Sulejmanit (paqja qoftë mbi të!) është plot çudira e këshilla. Edhe vdekja e tij ishte e tillë.[1]

1. Shiko më gjerë rreth kësaj çështjeje në nëntitullin "S'ka qetësi në të" të po këtij libri.

Urtësia e Zotit vërehet qartë në vdekjen e tij dhe aty ka një mësim: bota metafizike nuk dihet. Pikërisht këtë çështje e thekson edhe ajeti kur'anor vijues: **"Për xhindet u bë e qartë se sikur të ishin ata që e dinin të fshehtën, nuk do të vazhdonin të qëndronin në mundimin e rëndë."** ("Sebe", 14)

Edhe Bejtul-Makdisi ende nuk kishte përfunduar dhe forcë kryesore për ndërtimin e tij ishin xhindet. Sikur ta kishin ditur xhindet për vdekjen e tij, do të kishin ikur dhe nuk do të mund të zëvendësoheshin.

Të gjithë njerëzit duhet të dijnë se kur vjen çasti i vdekjes së njeriut, ai nuk vonohet absolutisht aspak. Sulejmani (paqja qoftë mbi të!) vdes i mbështetur në shkopin e tij dhe meleku i vdekjes nuk ka pritur që ai të shkonte në shtrat. Kjo do të thotë se ne nuk dimë kur na vjen vdekja dhe për këtë arsye, duhet të bëjmë vepra të mira e të jemi të përgatitur për momentin e vdekjes.

**4**

**"Ne i falëm Daudit Sulejmanin." (**"Sad", 30)

Në këtë sure të bekuar ilustrohet rrëfimi mbi profetin e Zotit, Sulejmanin (paqja qoftë mbi të!).

Ajetet fillojnë kështu:

1. "**Rob shumë i mirë dhe shumë i kthyer nga Zoti."**

Zoti i Madhëruar e lavdëron për devotshmërinë e tij, që konsiderohet shkallë e lartë. Ajo u është dhënë vetëm pejgamberëve (paqja qoftë mbi të!). Kjo gradë është shumë e lartë dhe ajo mund të arrihet vetëm me punë të mira, me respektimin e sheriatit dhe me kontrollin e epsheve. **"Shumë i kthyer nga Zoti",** do të thotë se ai është larguar nga të gjitha veprat e veprimet që i urren Zoti i Madhëruar.

2. "**Kur në një mbrëmje iu shfaqën atij kuajt."**

Në një mbrëmje, Sulejmanit iu shfaqën kuajt që i ngrinin tri këmbët e tyre, rrinin gati para tij dhe ishin shumë të shpejtë. Nga ky ajet kuptohet se ai ka qenë i zënë për një kohë duke u marrë me kuajt.

3. **"E ai tha: "Unë i dhashë përparësi dashurisë së kuajve para Zotit tim."**

Për këtë shkak, ai është penduar. Kështu pra, secili besimtar duhet të pendohet nëse i kalon ndonjë kohë pa e adhuruar Zotin e Madhëruar, ngase vetëm adhurimi është në të mirë të tij.

4. **"M'i ktheni ata mua!"**

Ai i urdhëroi njerëzit që ishin aty t'ia kthenin kuajt dhe filloi t'i binte këmbëve e qafave. Nga ky ajet nënkuptohet se ai i ka prerë dhe e ka dhënë sadaka mishin e tyre, ngase ata i morën kohën e adhurimit dhe ngase u dha atyre më shumë përparësi se dashurisë ndaj Zotit. Në këtë kontekst, Zoti i Madhëruar thotë: **"Dhe pasurinë që e do, ua jep të afërmve, jetimëve, të varfërve, udhëtarëve, lypësve dhe për lirimin e robërve**." ("El-Bekare", 177)

Sulejmani (paqja qoftë mbi të!) dha si sadaka mishin e kuajve, që i donte shumë. Ky veprim duhet të jetë shembull për ata që humbin kohën. Ai e bëri atë që t'i afrohet Zotit.

Dije se edhe nëse e ke botën, Lindjen dhe Perendimin, ashtu siç i kishte Sulejmani (paqja qoftë mbi të!), në fund do të përfundosh në qefin dhe ajo që ngel pas teje, do t'u mbetet trashëgimtarëve. Me pasurinë që u lë atyre, ata do të krijojë grindje; ndërsa pasurinë që e ke dhënë për hir të Zotit të Madhëruar dhe çdo vepër të mirë që e ke bërë për nder të Zotit të Madhëruar, do ta gjesh para teje në momentin kur do të kesh nevojë për të.

5. **"Ne e sprovuam Sulejmanin."**

Zoti i Madhëruar i ka sprovuar pejgamberët për t'ua ngritur vlerën e respektin, për t'ua lartësuar autoritetin dhe për t'ua mësuar njerëzve durimin dhe qëndrimin. **"Dhe e mbajtëm në fronin e tij si një trup."** Allahu e kishte venduar Sulejmanin në fron të lartë për ta mbrojtur; por ai kishte rënë i vdekur në karrige. Kjo ngjarje jep një shembull se kujdesi nuk mund të të mbrojë nga vdekja. Njeriu duhet ta lusë Zotin e Madhëruar që t'ia ruajë veprat

e mira. Nëse njerëzit dëshirojnë të dëmtojnë ndonjë rob, por Zoti i Madhëruar dëshiron ta mbrojë atë, asnjëherë nuk do të kenë mundësi ta dëmtojnë. Kjo vërtetohet kur hebrenjtë u tubuan për ta vrarë Isanë (paqja qoftë mbi të!) dhe kur kurejshët planifikuan vrasjen e Muhamedit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) e kur u tubuan para derës së tij natën kur shkoi në Medine. Kjo vërtetohet edhe me shumë raste të tjera.

6. **“Pastaj u rikthye në gjendjen e parë.”**

Pastaj u rikthye në gjendjen e parë, gjegjësisht iu kthye Zotit pas pendimit (teubes). Ky është një mësim i rëndësishëm që duhet ta mësojë myslimani nga Sulejmani (paqja qoftë mbi të!). Ndoshta njeriu hutohet në ndonjë vepër apo bën diçka që nuk i lypet. Në raste të tilla, njeriu duhet me të shpejtë t’i rikthehet Zotit të Madhëruar me teube, të kërkojë falje dhe të mbështetet në Të në çështjet që kanë të bëjnë me fenë dhe me botën e tij. Njeriu duhet të jetë shumë i kujdesshëm që të mos e bindë djalli e t’ia zbukurojë gabimin apo ta bindë se rruga e Zotit është mbyllur para tij.

7. **“Tha: ‘Zoti im, më fal!’”**

Pas asaj që i ndodhi, Sulejmani (paqja qoftë mbi të!) iu drejtua Zotit të Madhëruar dhe kërkoi prej Tij që ta falte.

Nuk është e mundur që pejgamberët e Zotit të largohen nga adhurimi apo të bëjnë ndonjë gjynah ngase ata janë të mbrojtur nga veprat e këqija.

8. **“Më dhuro atë pushtet që askush pas meje të mos e ketë!”**

Ne të gjithë e lusim Zotin e Madhëruar që të na japë pasuri për t’u kënaqur dhe për t’u bërë të lumtur; ndërsa pejgamberi i Zotit e luti Zotin që t’i jepte pushtet për ta përhapur drejtësinë, për të përhapur monoteizmin dhe për t’i shkatërruar idhujtarët. Kjo vërehet në ajetin kur’anor që flet për Belkisen dhe për popullin e saj: **“E gjeta atë dhe popullin e saj duke adhuruar diellin.”** Dhe menjëherë shpejtoi që t’i shpëtonte nga humbja dhe vërtet, ndodhi ajo që duhej të ndodhte në mënyrën më të mirë.

9. **“Ne ia nënshtruam atij erën, që sipas urdhrit të tij, ajo të ecë lehtë dhe nga të dëshirojë ai.”**

10. **“Ndërsa djajtë** (ia nënshtruam) për çdo ndërtim dhe zhytje në ujë.” (“Sad”, 37)

11. **“Ky është shpërblimi Ynë!”**

12. **“Ai vërtetë ka vend të lartë te Ne dhe të ardhme të mirë.”**

Krahas pushtetit të gjerë të Sulejmanit (paqja qoftë mbi të!), gjëja më e mirë që kishte ishte pozita e lartë te Zoti i Madhëruar dhe autoriteti i madh. Pushteti dhe sundimi i tij u zhdukën me vdekjen e tij. Por vazhduan të mbeten vetëm veprat e mira që pati bërë.

## Allahu është i pastër

Sulejmani (paqja qoftë mbi të!) sundoi botën nga të gjitha anët dhe komandoi xhindet, njerëzit, shpendët dhe egërsirat. Zoti i Madhëruar ia nënshtroi edhe erën që të frynte sipas urdhrit të tij. Ushtria e Sulejmanit (paqja qoftë mbi të!) ishte shumë e madhe. Xhindet i kishin bërë një shkop prej ari dhe ai mbështetej në të. Xhindet kishin bërë edhe gjashtëqind mijë karrige ari dhe argjendi. Pejgamberët dhe dijetarët uleshin në karrige. Rreth tyre qëndronin njerëzit, ndërsa rreth njerëzve qëndronin xhindet e djajtë. Shpendët u bënin hije. Në bazë të urdhrit të tij, erërat e bartnin në vende të ndryshme.

Një bujk kishte thënë se Ibn Daudit i ishte dhënë pushtet i madh dhe kur dëgjoi për këtë, Sulejmani (paqja qoftë mbi të!) shkoi tek ai dhe i tha: *“Erdha tek ti që të të them: ‘Mos dëshiro diçka të pamundur për ty!’”*. Pastaj i thotë: *“Një tesbih (lartësim) që e pranon Zoti i Madhëruar është më i mirë se ajo që i është dhënë familjes së Daudit, ngase shpërblimi nga tesbihi jeton, ndërsa pushteti i Sulejmanit zhduket.”*[2] Këtë e vërteton ajo që transmetohet për shpërblimin nga tesbihi:

2. Raudatul-ua’idhin, 1/58.

Ibrahimi (paqja qoftë mbi të!) i ka thënë pejgamberit tonë, Muhamedit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) në Mi'raxh: *"O Muhamed, përshëndete ymetin tënd prej meje dhe informoje se uji i Xhenetit është i kënaqshëm, burimet janë të bardha, Zoti është i Pastër nga mangësitë dhe falënderimi i takon vetëm Zotit. S'ka zot tjetër, përveç Allahut dhe Zoti është më i Madhi! S'ka fuqi e as forcë askush tjetër, përveç Zotit të Madhëruar! "*

Pejgamberi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: *"Allahu është i Pastër dhe falënderimi i takon vetëm Atij." Zoti i shkruan mijëra e mijëra të mira dhe i fal mijëra e mijëra gjynahe, i dhuron mijëra e mijëra gradë atij që e thotë shumë herë. Zoti e shpërblen atë dhe kush kërkon falje, Zoti e fal."*[3]

Pejgamberi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: *"Kush thotë: 'Zoti është i Pastër nga të metat!', Zoti ia mbjell një pemë në Xhenet."*[4]

## I butë dhe i mëshirshëm

Zoti i Madhëruar është i Mëshirshëm, si me njerëzit, ashtu edhe me kafshët. Kjo vërehet në shiun, ngase sikur të mos ekzistonte shiu, do të shkatërrohej shumica e kafshëve, madje mund të thuhet se kjo mirësi që zbret nga qielli, zbret për shkak të kafshëve. Në një hadith thuhet: *"Sikur të mos ishin pleqtë e shtyrë në moshë, fëmijët e vegjël dhe kafshët e ndryshme, do të përjetonit dënim të tmerrshëm!"*

Të kthehemi e të theksojmë një ngjarje që pati ndodhur në kohën e pejgamberit të Zotit, Sulejmanit (paqja qoftë mbi të!). Imam Musa ibn Xha'feri thotë: *"Njerëzit i kishte kapluar thatësi e madhe në kohën e Sulejman ibn Daudit (paqja qoftë mbi të!).*

*Ata iu ankuan atij dhe kërkuan prej tij që të bënte lutjen e shiut, e ai u tha: "Pas namazit të drekës!"* Kur e falën drekën,

3. Me'ani El-Ahbar, 390.
4. Rebiul-ebrar, 1/254.

shkuan bashkërisht dhe duke ecur nëpër rrugë, panë një buburrec me duar të kthyera kah qielli dhe me këmbë në tokë që lutej: *"O Zoti ynë, unë jam krijesë prej krijesave të tua, nuk mund të rrimë pa furnizimin Tënd dhe mos na shkatërro për shkak të bijve të Ademit!"* Sulejmani (paqja qoftë mbi të!) u tha: "*Kthehuni se tjetërkush e ka bërë lutjen.*" Atë vit ra shi si asnjëherë më parë.[5]

## Hyni në shtëpitë tuaja vetëm me mirësi

Nëse e dëgjon dhe nëse e zbaton fjalën e Pejgamberit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), do të shpëtosh nga shumë lodhje, do të pasurohesh përgjithmonë dhe nuk do ta shijosh asnjëherë varfërinë.

Thuhet: "Shumë fjalë e ngjallin të vdekurin". Këtu është edhe porosia e pejgamberit të Zotit, Sulejmanit (paqja qoftë mbi të!) për Beni Israilët: *"O Beni Israilë, hyni në shtëpitë tuaja me mirësi dhe dilni nga shtëpitë tuaja vetëm me mirësi."*[6]

Nëse i analizon banorët e zjarrit, do të kuptosh se pjesa dërrmuese e tyre nuk kanë qenë të kujdesshëm ndaj këtyre dy çështjeve. Ne nuk jemi të kujdesshëm ndaj të drejtave të njeriut dhe ndaj pasurive të tyre, flasim gjithçka, gënjejmë, flasim fjalë të padenja, përgojojmë dhe trillojmë. Pas të gjitha këtyre gjërave, përfitojmë zjarrin.

5. Raudatul-kafi, 8/198.
6. El-Keshkul lish-Shejh El-Beha'ij, 1/169.

**Ajetullah Xhafer Subhani**

# Shqyrtimi i kontekstit të ajeteve të Kur'anit

## Abstrakt

*Kur'ani flet për çështje të ndryshme dhe paraqit shumë ajete në lidhje me një temë të caktuar. Në një rast të tillë, t'i referohesh vetëm një ajeti dhe të shpërfillësh ajete të tjera, nuk do të sillte asgjë tjetër përveçse pasaktësi dhe një shkëputje nga qëllimi i vërtetë i Kur'anit. Shqyrtimi i asaj që vjen para ose pas një ajeti të caktuar është një nga çelësat e komentimit të drejtë dhe të saktë të Kur'anit. Megjithatë, konteksti është i vlefshëm vetëm kur ajeti që komentohet, nuk është i pavarur nga ajetet që vijnë para ose pas tij. Kur provohet se ajeti është i pavarur nga ajetet përreth tij, atëherë ne nuk mund t'i referohemi kontekstit të ajeteve për ta shpjeguar dhe për ta komentuar atë. Një studim i ajeteve të Kur'anit vërtetëson faktin se nganjëherë (dhe ne po e theksojmë fjalën nganjëherë), para se Kur'ani të mbarojë së foluri për një çështje të caktuar, ai mund të paraqesë një çëshhtje të re. Pastaj, kur e mbaron atë çështje, i kthehet asaj së mëparshmes. Kjo është një ndër të veçantat e Kur'anit.*

T'i kushtosh vëmendje kontekstit të ajeteve, domethënë, të shikosh ajetin që vjen para dhe pas një ajeti të veçantë (të cilin ne duam ta komentojmë), është në njëfarë mënyre një pjesë e kërkesës së gjashtë të Tefsirit - pra, të shikosh harmoninë që ekziston në të gjitha ajetet e Kur'anit. P.sh., dimë se Kur'ani flet për çështje të ndryshme dhe paraqit shumë ajete në lidhje me një temë të caktuar.

Në një rast të tillë, t'i referohesh vetëm një ajeti dhe të shpërfillësh ajete të tjera, nuk do të sillte asgjë tjetër përveçse pasaktësi dhe një shkëputje nga qëllimi i vërtetë i Kur'anit.

Sidoqoftë, nuk është vetëm Kur'ani, i cili, kur përpiqesh të kuptosh fjalitë e tij, që duhet t'i analizosh dhe t'i shpjegosh, duhet parë çfarë vjen para dhe pas një ajeti të caktuar. Edhe kur shpjegon fjalët e një njeriu të urtë, duhet të përdoret kjo metodë.

Që diskutimi ynë të jetë i qartë, po paraqitim shembullin e mëposhtëm nga surja «Araf», ajeti 35, kur Allahu thotë: «**O bijtë e Ademit! Nëse ju vijnë të dërguar nga mesi juaj që ju sjellin kumtimet e mia,** (shkoni pas tyre). **E, kush ruhet** (nga e keqja) **dhe vepron drejt, për të nuk ka as frikë e as nuk ka përse të brengoset"**[1].

Kur shpjegojmë këtë ajet të Kur'anit, në qoftë se nuk i referohemi asaj që vjen përpara tij dhe pas tij dhe shohim, thjesht vetëm ajetin, atëherë, kuptimi do të ishte: Kur'ani e ka mbajtur derën hapur për të ardhur profetë të tjerë pas Profetit Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) dhe nuk e ka mbyllur derën e profetësisë. Mirëpo ne dimë se në një ajet tjetër të Kur'anit thuhet se Profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) është Profeti i fundit dhe vula e të gjithë profetëve (dhe nuk vjen asnjë pas tij), ashtu siç lexojmë: "**Muhamedi nuk është babai i asnjëri prej njerëzve tuaj, por është i Dërguari i Allahut dhe i fundit** (dhe vula) **e profetëve. Dhe Allahu di gjithçka**". (Surja "Ahzab", ajeti 40)[2]

Baza e këtyre dy konkluzioneve të kundërta është: në komentimin e ajetit të parë, që u përmend më sipër, nuk

1. Fjala arabe, *ima,* që u përmend në këtë ajet, ka qenë në fillim dy fjalë - *in* dhe *ma*. Por, meqë vendi i shqiptimit të këtyre dy fjalëve është i ngjashëm në gjuhën arabe, shkronja 'n' u bashkua me shkronjën 'm'. Në të vërtetë, fjala *ima* është aktualisht në kuptimin e 'kushtit' dhe kështu, kuptimi i ajetit është: "**Sigurisht, NË QOFTË SE të dërguarit vijnë nga mesi juaj"**…

2. Surja "Ahzab", ajeti 40.

i kushtohej vëmendje kontekstit të ajetit dhe nuk kihej parasysh komentimi i ajeteve që vinin para ose pas tij. Sidoqoftë, nëse dikush do t'i referohej vetë Kur'anit, ai do të shihte se ky ajet është vetëm një pjesë e një grupi ajetesh - njëzet e gjashtë ajete / ajetet 11 - 36 të sures "Araf", e cila hedh dritë mbi një ngjarje që ka ndodhur në fillimin e krijimit të njerëzimit. Kështu që, shihet se këto ajete lidhen me kohën e krijimit të Ademit (paqja qoftë mbi të!), kur u nxor nga Xheneti dhe u urdhërua të jetonte në Tokë bashkë me të shoqen dhe fëmijët. Në këtë rast kohor Allahu iu drejtua bijve të Ademit (paqja qoftë mbi të!) dhe u tha: "**O bijtë e Ademit! Nëse ju vjen ndonjë profet, atëherë kush e adhuron Allahun me devotshmëri** (takua) **dhe zgjedh rrugën e drejtë, nuk ka për të as frikë, as brengë**". (Surja "Araf", ajeti 35)

Nuk ka dyshim se pasi Ademi u vendos në Tokë, erdhën profetë të panumërt nga Allahu për ta udhëzuar njerëzimin dhe të gjitha misionet e tyre ishin të njëjta: "… **Dhe, kushdo që ruhet** (nga e keqja) **dhe vepron drejt, nuk do të ketë as frikë, dhe as brengë**". (surja… ajeti…) Kjo fjalë e Allahut në fillim të Krijimit nuk na pengon të pranojmë faktin se Profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) është Profeti i fundit dhe është pikërisht nëpërmjet tij që dera e profetësisë, që kishte qenë e hapur për kaq shumë vjet (derisa të vinte ai), u mbyll për njerëzimin për arsye të ndryshme.

Ky realitet bëhet i qartë vetëm kur shikojmë se njëzet e gjashtë ajetet (ajetet 11 - 36) të Kur'anit në suren "Araf"u drejtohen drejtpërdrejt pasardhësve (aktualë) të Ademit (paqja qoftë mbi të!): Allahu u drejtohet atyre drejtpërdrejt tri herë me frazën: "**O 'Bijtë e Ademit!'**"siç mund të shihet në ajetet më poshtë:

**"O Bijtë e Ademit! Sigurisht, ne krijuam për ju rroba…"**[3]

3. Surja "A'raf", ajeti 26.

**"O Bijtë e Ademit! Të mos ju mashtrojë kurrësesi shejtani, siç bëri me prindërit tuaj që i nxori nga Xheneti."**[4]

**"O Bijtë e Ademit! Nëse ju vijnë të dërguar nga mesi juaj..."**[5]

Në një rast tjetër, kur Kur›ani flet për fillimin e Krijimit, shohim se përdoret e njëjta frazë:

**" A nuk ma dhatë fjalën, o bijtë e Ademit që nuk do ta dëgjonit shejtanin?"**[6]

Kjo formë e adresimit lidhet me periudhën e fillimit të Krijimit dhe është në përputhje me atë periudhë e nuk ka të bëjë me kohën e Profetit të Shenjtë të Islamit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!).

## Shqyrtimi i kontekstit të ajeteve dhe i haditheve që lidhen me ajetet

Siç u argumentua më lart, shqyrtimi i asaj që vjen para ose pas një ajeti të caktuar është një nga çelësat e komentimit të drejtë dhe të saktë të Kur'anit. Megjithatë, konteksti është i vlefshëm vetëm kur ajeti që komentohet, nuk është i pavarur nga ajetet që vijnë para ose pas tij. Kur provohet se ajeti është i pavarur nga ajetet përreth tij, atëherë ne nuk mund t'i referohemi kontekstit të ajeteve për ta shpjeguar dhe për ta komentuar atë. Një studim i ajeteve të Kur'anit vërtetëson faktin se nganjëherë (dhe ne po e theksojmë fjalën *nganjëherë*), para se Kur'ani të mbarojë së foluri për një çështje të caktuar, ai mund të paraqesë një çëshhtje të re. Pastaj, kur e mbaron atë çështje, i kthehet asaj së mëparshmes. Kjo është një ndër të veçantat e Kur'anit. Kjo është pak a shumë po ajo që shihet në fjalët e folësve elokuentë.

Natyrisht, qëllimi ynë kur e themi këtë, nuk është të pohojmë se në Kur'an, brenda kufijve të një teme të caktuar

4. *Ibid.*, ajeti 27.
5. *Ibid.*, ajeti 35.
6. Surja "Jasin", ajeti 60.

vjen një temë tjetër, e cila nuk ka aspak asnjë lidhje me temën parësore. Po të flasim teknikisht, ne nuk themi se një ajet që është i ndërtuar për një temë ose për një çështje specifike, përzihet me ajete të tjera që kanë të bëjnë me tema ose me çështje të tjera e kështu, ta ndërpresë rrjedhën e ajeteve ose të ndërhyjë në rrjedhën e ajeteve. Përkundrazi, mendimi ynë këtu është se në të njëjtën kohë që ruhet perspektiva e ajeteve, përpara përfundimit të një teme a të një çështjeje të mëparshme, hyn një temë e re a një çështje e re, që e plotëson çështjen a temën e parë të ajeteve (të tjera).

## Shembuj për këtë problem

Në suren «Bekare», në ajetet 221 - 240, Kur›ani flet për çështje që kanë të bëjnë me bashkëshortin, bashkëshorten, fëmijët, divorcin dhe vdekjen e bashkëshortit. Në të gjithë këtë grup ajetesh, ka unitet dhe harmoni të plotë midis tyre. Megjithatë, pas ajetit 237, në ajetet 238 dhe 239 shohim se përmendet çështja e faljes (namazit), sidomos falja e mesme dhe kryerja e faljes në kushte rreziku. Pas kësaj shohim se ajetet i kthehen temës fillimtare (martesës dhe jetës familjare). Atëherë, cila është përshtatshmëria e këtyre dy ajeteve që vijnë në mes të temës për çështjet familjare? Tani për tani, ky nuk është diskutimi ynë. Megjithatë, kjo është diçka që mund ta rrokim duke shqyrtuar këto ajete. Që të jemi të kuptueshëm nga lexuesi për këtë çështje, po sjellim këto ajete nga Kur›ani:

"**Dhe, nëse i dirvoconi ato** (gratë) **para se të keni pasur kontakt martesor me to** (para se të keni bërë marrëdhënie seksuale me to)**, por u keni pasë caktuar atyre një pjesë** (të prikës)**, atëherë, duhet t'u jepni gjysmën e asaj që e keni caktuar, përveçse kur ato ju falin ose kur ju fal ai, në duart e të cilit është lidhja e kurorës. Dhe, të falni** (burra ose gra) **është më afër devotshmërisë dhe mos e harroni mirëbërësinë midis jush. Vërtet, Allahu shikon atë që veproni.** (ajeti 237)

**Dhe, nëse keni frikë (**nga armiku**), atëherë, falni namaz në ecje e sipër ose kalëruar; por, kur të jeni të siguruar, kujtojeni Allahun (**me namaz**), siç ju ka mësuar Ai për atë që ju nuk e dinit".(**ajeti 239**)**

**Ata që vdesin ndër ju, le të lënë testament për bashkëshortet e tyre, furnizim për një vit e pa i nxjerrë nga shtëpia. Por, nëse ato dalin me dëshirën e vet, nuk është mëkat për ju për atë veprim të lejueshëm që ato e bëjnë për vetveten. Allahu është më i Fuqishmi, më i Dituri**[7]".

Siç mund të shihet, në këto ajete, pjesa e parë dhe e fundit janë për çështjen e martesës dhe marrëdhëniet bashkëshortore, ndërsa ajetet në mes janë për faljen (namazin) - me theksim të veçantë në faljen e mesit dhe faljen në kohë rreziku (në luftë etj.).

Prandaj, kur prova të qarta dhe të padykuptimshme (si, hadith i treguar me zinxhir të plotë treguesish / *mutauatir,* ose hadith që ka nevojë për dije të përmbajtjes së tij) janë në kundërshtim me kontekstin e ajeteve, atëherë duhet të veprojmë sipas konkluzionit që kemi nxjerrë nga hadithi. Në këtë rast ne nuk duhet ta shqyrtojmë kontekstin e ajeteve të Kur'anit, por ta përqendrojmë vëmendjen tonë te hadithi i saktë. Ja dy shembuj për ta shkoqitur më tej këtë çështje:

a) Në suren "Ahzab", ajeti 28 - 35, Kur'ani merret me bashkëshortet e Profetit të Shenjtë të Islamit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!).

Në ajetin 33 thuhet: "**Dhe rrini në shtëpitë tuaja e mos shfaqni bukurinë tuaj, sic shfaqej në injorancën e hershme, falni namazin, jepni zekatin dhe bindjuni Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe Allahu dëshiron vetëm të largojë nga ju o Pjesëtarë të Familjes gjithë papastërtinë dhe t'ju pastrojë e t'ju bëjë të panjollë."**[8]

Konteksti i ajeteve para dhe pas do të na thoshte se ky ajet ka të bëjë drejtpërdrejt me bashkëshortet e Profetit

7. Surja "Bekare", ajeti 237 deri 240.
8. Surja "Ahzab", ajeti 33.

të Shenjtë të Islamit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). Sidoqoftë, hadithi i treguar me zinxhir të plotë na tregon se ky ajet ka zbritur në lidhje me një grup të veçantë njerëzish, të cilët ishin zbukuruar me një zbukurim të pagabuar. Në këtë rast, hadithi i saktë merr përparësi mbi kontekstin e ajetit.

Më tej se kaq, ka edhe një provë të qartë në vetë ajetin që provon se kjo pjesë e tij nuk është në lidhje me bashkëshortet e Profetit të Islamit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). Këto dy prova janë përemri në gjininë mashkullore në bashkëlidhjen "*nga ju*" dhe folja "*pastroj*", që na thonë se nuk ka lidhje midis kësaj pjese të ajetit dhe asaj që vjen përpara në lidhje me bashkëshortet e Profetit Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!).

b) Në suren "Maide", ajeti 1 - 5, Kur'ani flet në mënyrë të veçantë për mishin dhe çështje të tjera që kanë të bëjnë me ushqimin. Mirëpo në mes të ajetit të tretë lexojmë: "**Sot e përsosa për ju fenë tuaj, plotësova ndaj jush dhuntinë Time e zgjodha për ju Islamin si fe**".

Rregulli i shqyrtimit të kontekstit të ajeteve të Kur'anit na urdhëron të pranojmë se kjo pjesë e Kur'anit, e cituar më lart është në lidhje me ditën kur gjëra të ndryshme u ndaluan për t'i ngrënë, të tilla si, kafsha e ngordhur, gjaku, mishi i derrit etj. Kështu, kuptimi i "*sot*" që u përmend në këtë pjesë të ajetit është dita kur këto gjëra u ndaluan për konsumim nga njeriu.

Mirëpo prova të qarta dhe të padykuptimshme dhe ajeti i treguar me zinxhir të plotë na thonë se kjo pjesë e ajetit nuk ka zbritur për ndalimin e llojeve të mishit. Përkundrazi, ne na thuhet se kjo pjesë e ajetit ka zbritur në lidhje me Ditën e Ghadirit (18 dhul hixhe) - dita kur besimi dhe mësimet e Islamit u përsosën dhe u plotësuan kur u caktua udhëheqësi i bashkësisë (pas Profetit të Islamit / paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). Dhe ai ishte imam Ali bin Ebi Talib (paqja qoftë mbi të).

**Muhsin Keraeti**

# Mësime kur'anore nga surja "Bekare"


## Abstrakte

*"Bekare" është surja e dytë e Kur'anit. Në ajetet kur'anore ka shumë mësime. Në këtë artikull ka disa mësime nga surja "Bekare", si: besimi nuk ndahet nga veprimi dhe besimtarët duhet të veprojnë sipas udhëzimeve të Zotit, namazi është themeli i veprave të besimtarëve, gjithçka e kemi nga Zoti, prandaj, një pjesë të asaj që kemi, duhet t'ua falim të tjerëve, që Zoti të na shpërblejë në këtë dhe në Botën Tjetër etj.*


## Ajetet 1- 6 te surja "Bekare" (ose siç njihet ndryshe surja *elif lam mijm*)

**"Elif, Lâm, Mîm."**

**"Ky është Libri në të cilin nuk ka dyshim. Ai është udhërrëfyes për të devotshmit."**

**"të cilët besojnë në të fshehtën, falin namazin dhe japin nga ajo që u kemi dhënë Ne;"**

**"dhe për ata që besojnë në atë që të është shpallur ty** (o Muhamed)**, në atë që është shpallur përpara teje dhe që me bindje i besojnë Jetës Tjetër."**

**"Ata janë udhëzuar në rrugë të drejtë nga Zoti i tyre dhe pikërisht ata janë të shpëtuarit."**

***Nga këto ajete mësojmë se:***

1- Shokët e Profetit i kushtonin rëndësi shumë të madhe shkrimit dhe mësimit përmendsh të ajeteve dhe si rrjedhim, ato u përmblodhën në formën e librit dhe ne duhet të ruajmë vlerat dhe shenjtërinë e këtij Libri të Zotit.

2- Përmbajtja e këtij Libri është e qëndrueshme dhe e

fuqishme, sepse ai është zbritur nga Zoti i Plotfuqishëm.

3- Kur'ani është Libri udhërrëfyes për njerëzimin dhe jo për një grup të caktuar njerëzish. Si rrjedhim, nuk duhet të presim që ky Libër të trajtojë probleme të ndryshme të fizikës, të kimisë apo të matematikës.

4- Ne mund ta ndiejmë dritën e Kur'anit në zemrat tona, vetëm nëse e kemi përgatitur shpirtin për ta pranuar këtë dritë. Pa dyshim, drita depërton në xhamin e pastër dhe jo në baltën e errët.

5- Gjithësia nuk kufizohet me botën e materies, por është shumë më e gjerë sesa konceptimi dhe shikimi ynë, por zemrat tona dëshmojnë për ekzistencën e botës së padukshme, prandaj duhet të besojmë në këtë ekzistencë.

6- Besimi nuk ndahet nga veprimi dhe besimtarët duhet të veprojnë në bazë të udhëzimeve të Zotit.

7- Namazi është boshti i veprave të besimtarëve.

8- Gjithçka që kemi, e kemi nga Zoti prandaj një pjesë të asaj që kemi duhet t'ua falim të tjerëve, në mënyrë që Zoti të na shpërblejë në këtë dhe në atë botë.

9- Islami është fe gjithëpërfshirëse që synon udhëzimin e shoqërisë në rrugë të drejtë. Kjo fe porosit për marrëdhëniet me Zotin dhe për marrëdhëniet me njerëzit, duke patur parasysh nevojat e shoqërisë.

10- Të gjithë profetët kishin të njëjtin qëllim, prandaj është e nevojshme të besohen të gjithë të dërguarit e Allahut.

11- Ymeti islam është trashëgimtar i shpalljeve të mëparshme të Zotit dhe duhet të përpiqet për ruajtjen dhe respektimin e tyre.

12- Besimi në ditën e Kiametit ka ndikime të shumta: e zvogëlon botën në sytë e njerëzve, e mbron njeriun nga gjynahet dhe drejton veprat e njeriut.

13- Rruga për arritjen e lumturisë është pranimi i udhëzimeve të Allahut.

14- Udhëzimi dhe shpëtimi nuk vjen pa përpjekje, sepse ka nevojë për besim, dituri, punë dhe përpjekje.

## Ajetet 6 – 12 te surja “Bekare”

6. Sa për ata që mohojnë, njësoj është, i paralajmërove apo nuk i paralajmërove - ata nuk besojnë.

7. Allahu i ka vulosur zemrat e tyre, ndërsa në veshët dhe sytë e tyre kanë mbulesë; ata i pret një dënim i madh.

8. Ka disa njerëz që thonë: “Besojmë në Allahun dhe në Ditën e Gjykimit!”, por në të vërtetë, ata nuk janë besimtarë.

9. Ata përpiqen të mashtrojnë Allahun dhe besimtarët, por në të vërtetë mashtrojnë vetëm vetveten, megjithëse nuk e ndiejnë.

10. Në zemrat e tyre ka një sëmundje, të cilën Allahu ua shton. Ata i pret një dënim i dhimbshëm, për shkak të hipokrizisë së tyre.

11. Kur u thuhet: “Mos bëni çrregullime në tokë!” - ata thonë: “Ne bëjmë vetëm përmirësime në tokë!”

12. Por jo! Në të vërtetë, pikërisht ata janë shkaktarët e çrregullimeve, ndonëse nuk e ndiejnë.

***Nga këto ajete mësojmë se:***

1- Mosbesimi e bën njeriun të mohojë të vërtetën dhe të drejtën dhe ai qëndron indiferent ndaj çdo gjëje, ashtu si guri dhe druri.

2- Nëse njerëzit nuk e pranojnë të vërtetën nuk e pranojnë as ftesën e profetëve. Ftesa e profetëve është si shiu, i cili, nëse bie në një tokë të mire, çel lule dhe nëse bie në një tokë të shkretë, çelin gjemba.

3- Megjithëse e dimë se qafirët nuk bëhen besimtarë, ne duhet të zbatojmë detyrën tonë dhe t’i ftojmë ata në rrugën e drejtë.

4- Ai që e kupton të drejtën por e mohon atë, edhe Zoti mbulon syrin e zemrës së tij dhe ky është një dënim prej Zotit.

5- Përparësia e njeriut ndaj kafshës është logjika dhe botëkuptimi i drejtë i gjërave, por duke qenë jobesimtar njeriu e humb këtë përparësi.

6- Besimi është vetëm me zemër e jo me gojë. Pra, për të

njohur njerëzit, nuk duhet të kënaqemi vetëm me pamjen e tyre të jashtme.
7- Hipokriti është mashtrues. Të kemi kujdes që të mos biem pre e pamjes së jashtme të njerëzve.
8- Asnjëherë të mos përpiqemi që të mashtrojmë të tjerët, sepse mashtrimi i kthehet vetë mashtruesit.
9- Sjellja e Islamit me hipokritët është po ajo sjellje e hipokritëve me Islamin. Ata e pranojnë Islamin sa për sy e faqe dhe Islami sa për sy e faqe i njeh ata si myslimanë. Ata në zemër nuk kanë besim dhe për këtë, në Ditën e Gjykimit Zoti do t'i dënojë ata bashkë me jobesimtarët.
10- Hipokrizia është sëmundje shpirtërore, kurse hipokriti, ashtu si njerëzit e sëmurë, as është i shëndoshë e as i vdekur, as besimtar e as jobesimtar.
11- Hipokrizia zhvillohet ashtu si kanceri dhe përfshin gjithçka dhe nëse nuk shërohet, shpërndahet në të gjitha pjesët e trupit.
12- Zanafilla e hipokrizisë është gënjeshtra, kurse gënjeshtrat janë stili i përhershëm i hipokritëve.
13- Pasojat e hipokrizisë nuk janë vetëm individuale, por ato përfshijnë edhe shoqërinë.
14- Mendjemadhësia dhe kryelartësia janë shenja të hipokrizisë. Ata thonë: vetëm ne jemi pro reformave dhe përmirësimit dhe askush tjetër.
15- Nëse hipokrizia lëshon rrënjë në zemrën e njeriut, ai njeri e humb ndjenjën për të kuptuar të vërtetën.
16- Besimtarët duhet të jenë të njohur më sloganet boshe të hipokritëve dhe nuk duhet të bien pre e mashtrimeve të tyre.
17- Mençuria dhe shkathtësia, e cila nuk është në rrugën e drejtë dhe në të mirë të shoqërisë, është e pavlefshme.

## Ajetet 13 – 17 te surja "Bekare"

13. Kur atyre u thuhet: "Besoni edhe ju ashtu siç kanë besuar njerëzit e tjerë!" - ata thonë: "Vallë, a të besojmë edhe ne

ashtu siç besojnë mendjelehtët?!" Por jo! Në të vërtetë, pikërisht ata janë mendjelehtët, por nuk e dinë këtë.
14. Kur takohen me besimtarët, ata thonë "Besojmë" – por, kur mbesin vetëm me djajtë e tyre, thonë: "Në të vërtetë, ne jemi me ju; ne vetëm po talleshim".
15. Allahu do të tallet me ata dhe do t'i lërë një kohë të gjatë që të bredhin verbërisht në mendjemadhësinë e tyre.
16. Pikërisht këta janë ata që kanë këmbyer udhëzimin me humbjen, kështu që tregtia atyre nuk u solli kurrfarë dobie dhe as nuk ishin të udhëzuar në rrugën e drejtë.
17. Rasti i tyre shëmbëllen me rastin e atyre që ndezin një zjarr dhe, kur ai ua ndriçon ç'kanë rreth vetes, Allahu ua merr dritën, i lë në errësirë dhe ata nuk shohin asgjë!

***Nga këto ajete mësojmë se:***

1- Fyerja dhe nënçmimi i myslimanëve është stil i hipokritëve të cilët veten e cilësojnë më të mirë se të tjerët.
2- Me mendjemëdhenjtë duhet të sillemi sipas sjelljes së tyre. Ai që fyen popullin duhet të fyhet në shoqëri në mënyrë që t'i ulet mendjemadhësia.
3- Fyerja dhe nënçmimi është punë e shpifur dhe mendjelehtë. Njeriu i mençur flet me logjikë, kurse mendjelehti flet me fyerje dhe nënçmim.
4- Zoti i turpëron hipokritët që në këtë botë, duke shpalosur fytyrën e tyre të shpifur.
5- Djalli nuk është vetëm ai djalli nga xhindet, por dhe ata njerëz të cilët bëhen shkak për devijimin e të tjerëve janë djaj dhe duhet të largohemi prej tyre.
6- Aktivitetet sekrete dhe takimet e fshehta kundër sistemit të drejtë janë shenja të mungesës së guximit për shprehjen e bindjeve. Hipokritët që tallin dhe fyejnë besimtarët, vetë janë frikacakë.
7- Hipokritët janë krah i armiqve në shoqëri dhe lëvizin bashkë me dëshirat e tyre dhe përpara tyre thonë: Ne jemi me ju e jo me besimtarët.

8- Dënimet e Zotit janë në përputhje me gjynahet e njerëzve. Për fyerje dhe tallje, dënimi është vetë tallje.
9- Nuk duhet të krenohemi me afatet që na i jep Zoti, sepse këto afate mund të mos jenë të dobishme për ne.
10- Zoti është mbështetës i besimtarëve. Nëse hipokritët tallen me besimtarët, Zoti gjithashtu tallet me hipokritët dhe i dënon ata.
11- Në shitjen e gjërave tona nuk duhet të mendojmë vetëm për të fituar, por duhet ta shikojmë se për ç'ka e shesim zemrën dhe shpirtin dhe ç'ka fitojmë?! Dhe, rezultat i kësaj tregtie, është lumturia dhe udhëzimi apo devijimi dhe shkatërrimi?!
*12*- Udhëzimi dhe humbja janë rezultat i veprave tona e jo detyrim apo vullnet e as caktim i Zotit.
*13*- Hipokrizia përfundon me humbje dhe dëm, kurse besimi njeriut i sjell lumturi dhe kënaqësi.
14- Drita e hipokritit është si drita e dobët dhe e paqëndrueshme e zjarrit.
15- Hipokritët krijojnë përçarje dhe urrejtje.
16- Hipokriti, për të krijuar dritë, përdor zjarrin që ka hi, tym dhe djegie.
17- Më në fund, Zoti i demaskon hipokritët dhe ua merr atyre edhe atë pak dritë sipërfaqësore.
18- E ardhmja e hipokritit është e errët, e paqartë dhe për të nuk ka shpresë për shpëtim.
19- Shtirja dhe hipokrizia përballë Zotit nuk është shenjë e inteligjencës dhe e zgjuarsisë, por dëshmi e ligësisë dhe burim shkatërrimi.

**Ajetet 18 – 22 te surja "Bekare"**

18. Ata janë të shurdhër, memecë e të verbër, prandaj nuk kthehen në rrugë të drejtë.
19. Ose shëmbëllen me ata që, gjatë shtrëngatës nga qielli, shoqëruar me errësirë, bubullimë dhe shkreptimë, i mbyllin

veshët me gishtat e tyre, për të mos dëgjuar ushtimën nga frika e vdekjes. Kështu, Allahu i ka nën kontroll mohuesit.
20. Shkreptima, pothuaj, ua merr shikimin. Sa herë që ajo ua ndriçon rrugën, ata ecin dhe, kur i kaplon errësira, ndalen. Sikur të donte Allahu, do t'ua merrte dëgjimin dhe shikimin. Pa dyshim, Allahu është i Fuqishëm për çdo gjë.
21. O njerëz! Adhurojeni Zotin Tuaj, i Cili ju ka krijuar ju dhe ata që ishin para jush, që të mund të ruheni (nga të këqijat);
22. i Cili e ka bërë për ju tokën shtresë dhe qiellin ndërtesë; i Cili prej së larti zbret ujë dhe nëpërmjet tij bën që të rriten fruta si ushqim për ju. Prandaj mos sajoni me vetëdije zota të barabartë me Allahun.

***Nga këto ajete mësojmë se:***

1-Hipokritët janë të mbytur në probleme dhe shqetësime të cilat nuk i lenë të qetë as në këtë botë.
2-Hipokritëve vazhdimisht u përmendet në vesh frika nga vdekja dhe kjo i privon ata nga qetësia shpirtërore.
3-Zoti është në dijeni të punëve të hipokritëve dhe zbulon komplotet e tyre.
4-Hipokrizia sjell mosbesim, prandaj në ajetin 19 të kësaj sureje hipokritët janë quajtur jobesimtarë.
5-Nga shiu, hipokritët marrin vetëm tmerrin vrasës të bubullimave dhe vetëtimave të tmerrshme. Kur'ani është mëshira e Allahut për njerëzimin, por për hipokritët është kambanë alarmi dhe mjet demaskimi.
6-Hipokriti nuk ka forcën për të parë dritën e Zotit dhe fjala e Tij ashtu si vetëtima e qiellit ia merr atij shikimin.
7-Hipokriti nuk ka dritë dhe përpiqet të ecë nën rrezen e dritës së besimtarëve.
8-Megjithëse nganjëherë hipokriti i hedh hapat përpara, ai nuk përparon.
9-Për shkak të veprave të shëmtuara, hipokriti në çdo çast mund të dënohet nga zemërimi i Zoti.

10-Hipokriti nuk mund të mashtrojë Zotin dhe t'i shpëtojë dënimit të Tij, sepse Zoti është i Gjithëditur dhe i Plotfuqishëm.
11-Ftesa e profetëve është për të gjithë njerëzit dhe jo vetëm për grupe dhe popuj të caktuar, prandaj dhe në Kur'an shpeshherë përmendet fjala: ***O njerëz***.
12-Një nga arsyet e adhurimit të Zotit është falënderimi për mirësitë e Tij të pafundme për ne dhe të parët tanë.
13-Krijimi është mirësia e parë dhe më e madhe e Zotit, prandaj është e hijshme që t'u bindemi me devotshmëri urdhrave të Tij.
14-Adhurimi është faktor i rëndësishëm i besimit dhe i pastërtisë. Nëse adhurimi nuk zgjeron tek ne frymën e besimit, ai nuk është adhurim.
